

Z. dhe Znj. Bae,
siç iu tregua të Përndershmit Erik Folei

KËTA JANË BREZAT

Historia sesi një familje në Korenë e Veriut e jetoi Porosinë e Madhe për më shumë se pesëdhjetë vjet në kombin më armiqësor ndaj krishterimit në historinë njerëzore.

KËTA JANË BREZAT

**Historia sesi një familje në Korenë
e Veriut e jetoi Porosinë e Madhe për
më shumë se pesëdhjetë vjet në kombin
më armiqësor ndaj krishterimit
në historinë njerëzore**

Z. dhe Znj. Bae,
siç iu tregua të Përndershmit Erik Folei



Këta janë brezat

© 2024 Erik Folei (Eric Foley)

Originally published in English under the title:

These are the Generations

by W Publishing, Colorado Springs, CO

© 2012 Eric Foley.

All Rights Reserved.

ISBN për versionin e librit në shqip:

Nëse jeni të interesuar të mësoni më shumë rreth dishepullimit të krishterë, përndjekjes së të krishterëve ose nëse dëshironi ta përdorni materialin e këtij libri për kishën ose shërbesën tuaj, ju lutemi kontaktoni:

<https://vomkorea.com/en/about/history/>.

Përktheu nga anglishtja: Edlira Roberts

Redaktoi: Albert Hysa

Citimet e Shkrimit të Shenjtë në shqip janë përkthim i vargjeve të zgjedhur nga autori i librit sipas versionit të Biblës së përdorur nga ai në anglisht: English Standard Version (ESV), New International Version (NIV), The New American Standard Bible (NASB), ose New King James Version (NKJV). Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Përmbajtja

| | |
|---|-----|
| Parathënia | 5 |
| Kapitulli Një. Gjyshi: Fanatiku origjinal për Jezusin në Korenë e Veriut. | 13 |
| Kapitulli Dy. Djali: I krishteri që vodhi patate për të mbijetuar. | 29 |
| Kapitulli Tre. Nëna: Shitësja e bukës së jetës. | 59 |
| Kapitulli Katër. Gruaja: Një lloj krejt tjetër i parashutistëve. | 70 |
| Kapitulli Pesë. Familja: Emanueli. | 94 |
| Pasthënia | 118 |
| Çfarë është “Zëri i Martirëve” | 121 |
| Shënimet | 122 |

Parathënia

Kur gruaja ime dhe unë flasim rreth Koresë së Veriut në aktivite të ndryshme në vendet perëndimore, njerëzit gjithnjë na pyesin: “Si mund të lutemi për të krishterët në Korenë e Veriut?” Kështu që ne ua bëmë atë pyetje një grupi të krishterësh të fshehtë koreanoveriorë. Ata u përgjigjën: “Të luteni për ne? Ne lutemi për ju!”

Kur ne i pyetëm përse u përgjigjën ashtu, ata thanë: “Ngaqë të krishterët në vendet perëndimore kanë akoma ca pasuri, liri e pushtet. Shumica prej tyre ende nuk e kanë përjetuar sesi është kur gjithçka që ke në jetë është Perëndia.”

Historia e Z. dhe Znj. Bae është një testament i së vërtetës se të krishterët koreanoveriorë nuk kërkojnë mëshirë e nuk janë të etur kryesisht për liri. Në vend të tyre, duke qenë vazhdimisht nën rrezikun e vdekjes në të vetmen shoqëri në historinë njerëzore e cila është ndërtuar si një shfytyrim i qëllimshëm i krishterimit, ata kërkojnë dhe kanë etje për më tepër nga Perëndia.

Mund të na duket e çuditshme që Koreja e Veriut përpigjet kaq fort për t'i hequr qafe të krishterët. Në fund të fundit, Koreja e Veriut nuk duket sikur i trembet ndonjë gjëje tjetër. Ata kanë ushtrinë e katërt aktive më të madhe në planet, me më shumë se 1.1 milionë ushtarë.ⁱ Dhe ata kanë kontingjentin më të madh të forcave speciale në botëⁱⁱ—më shumë madje se Shtetet e Bashkuara ose Kina. Sanksionet ekonomike në të vërtetë nuk i ngadalësojnë ata—80 përqind e ekonomisë së tyre është e fshehtë.ⁱⁱⁱ Ata fitojnë një miliard dollarë në vit prej pastrimit të parave dhe trafikimit të drogave ilegale.^{iv} Shitjet e armëve as nuk janë llogaritur në atë fitim të papritur. Pse atëherë punojnë aq fort ata për t'i vrarë të krishterët?

Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje, ne duhet të mos e konsiderojmë stereotipin se Koreja e Veriut, një vend komunist, është gjithashtu edhe një vend pa perëndi. E vërteta është se Koreja e Veriut është pothuajse me siguri të plotë vendi më fetar në botë. Dhe, në fakt, feja në Korenë e Veriut duhet t'u duket shumë e njohur të krishterëve.

Feja e Koresë së Veriut (ata parapëlqejnë termin “ideologji”) quhet “Juche”, që do të thotë “mbështetje në forcat e veta.”^v Çdo javë 100 përqind e popullsisë së Koresë së Veriut duhet të mblidhet bashkë, fshat më fshat, në ndërtesa të posaçme për shërbesat e adhurimit të quajtura takimet për autokritikë.^{vi} *Juche* madje ka edhe një trini—Kim Il Sung, bashkëshortja e tij, dhe djali i tij Kim Jong Il^{vii}—dhe nderimi për këtë të fundit nuk është zbehur pas vdekjes së tij dhe ngjitjes në pushtet të djalit të tij Kim Jong Un. Në takimet e përjavshme të autokritikës, koreanoveriorët këndojnë prej një libri himnesh që përmban gjashtëqind këngë adhurimi, të cilat e lartësojnë Kim Il Sungun dhe Kim Jong Il-in.^{viii} Koreja e Veriut u përpoq t'i ndante këto himne me të gjithë botën në vitin 1998, kur ata u përpoqën të lëshonin në orbitë një satelit që do të transmetonte gjithë kohën të gjitha himnet e *Juche*-s; për fatin e tyre të keq, sateliti ra poshtë në tokë.^{ix}

Koreanoveriorët luten duke parë me nderim lart drejt fotografiave të drejtuesve të dinastisë Kim, të cilat duhet të varen në murin më të mirë të çdo shtëpie.^x Kimi fillestar, Kim Il Sung, vdiq në vitin 1994, por koreanoveriorët vazhdojnë ta quajnë atë president të vendit dhe ta konsiderojnë atë të pavdekshëm, perëndinë e Koresë së Veriut.^{xi} Një reporter kinez dikur e pyeti një student të ri koreanoverior: “A ruan një kohë të posaçme në ditë, si për shembull para se të shkosh të flesh, për Kim [Il Sung]? A i flet ti atij? A të flet ai ty?” “Po”, - tha studenti.^{xii}

Sa për Kim Jong Il-in, thonë se u shfaq një yll lart në qiell kur lindi Kim Jong Il në një kabinë të thjeshtë druri në mes të dimrit me borë. Ashtu siç shkroi një reporter: “Gjithçka që mungon janë tre mbretërit dhe devetë e tyre.”^{xiii}

Nëse *Juche* ju duket si një imitim i shtrembëruar i krishterimit, atëherë mund ta kuptoni përse Koreja e Veriut përpiqet aq shumë për ta shkatërruar atë: Vetëm krishterimi ka fuqinë për ta demaskuar *Juche*-n si një besim mashtrues. Dhe kjo është arsyeja përse Koreja e Veriut gjithmonë ka luftuar fort për ta asgjësuar çdo të krishterë përbrenda kufijve të saj.

Krishterimi u prezantua në Korenë e Veriut më përpara sesa në Korenë e Jugut. Deri në vitin 1941, përllogaritet se treqind mijë koreanoveriorë identifikoheshin si të krishterë.^{xiv} Por gjaku i të krishterëve nuk u derdh në tokën koreanoveriore për herë të parë nën urdhrat e Kim Il Sungut. U derdh nën urdhrat e japonezëve, që e pushtuan Korenë nga viti 1910 deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Shumica e të krishterëve koreanë, nën këshillën e pastorëve të tyre, në fakt e përmbushën kërkesën për t'u përlulur me respekt tek faltoret shinto japoneze. Por jo çdo kishë u pajtua me këtë, dhe ato që kundërshtuan u përndoqën pa mëshirë. Disa ikën përtej kufirit për në Kinën verilindore, por përparimi perandorak i Japonisë në atë zonë solli përndjekjen e të krishterëve koreanë edhe atje.

Pas çlirimit të Koresë prej Japonisë, ajo u nda përkohësisht në zonat administrative veriore dhe jugore, me Veriun nën mbikëqyrjen e Bashkimit Sovjetik. Të krishterët në këtë rajon të ri verior e kundërshtuan ndikimin komunist dhe fillimisht, numri i tyre ishte aq i madh, saqë përbënte një rezistencë të frikshme. Kim Il Sungu patjetër që e vuri re: ai e kuptoi se do të duhej të ishte e domosdoshme ta fshinin nga faqja e dheut krishterimin, me qëllim që ta themelonin komunizmin.

Së pari qeveria e sulmoi kishën nga ana financiare, duke i konfiskuar financat e të krishterëve me anë të Aktit të Reformës së Tokës të vitit 1946. Në vitin 1949, teksa Veriu po përgatitej për luftë, Kim Il Sungu urdhëroi arrestimin e gjithkujt që merrte pjesë në aktivitete fetare. Përsëri u derdh gjak i krishterë. Një numër i patreguar i mijëra besimtarëve, me historitë e tyre të humbura në kohë, vuajtën për Krishtin.

Këta janë brezat

Pas luftës, Koreja e Veriut ose i rrënoi ndërtesat e kishave ose i ktheu në qendra kërkimore të Kim Il Sungut. Të krishterët që nuk u arratisën për në Jug gjatë luftës u spastruan si kundërrivolucionarë, u ekzekutuan publikisht ose u burgosën në kampet e përqendrimit ose kampet e punës. Në vitin 1959, qeveria përhapsi literaturë antikrishtere. Një libër i tillë ishte “Pse e mohojmë ne fenë?” Ai shpallte:

Përgjatë tre viteve të fundit, Lufta e Çosunit dhe Lufta e Çosunit Jugor u shkaktuan në emrin e Perëndisë dhe u drejtuan prej amerikanëve, të cilët bënë masakra, vunë zjarre të qëllimshme dhe kryen plaçkitje me anë të veprimeve çnjerëzore. Këto janë prova se feja është shkaku i të gjitha këtyre gjërave.

Të fajësuar për luftën dhe të paditur si bashkëkonspiratorë me amerikanët e urryer, të krishterët koreanoveriorë u ekzekutuan në numra gjithnjë e në rritje përgjatë viteve 1960, dhe kisha formale u shtyp krejtësisht. Të krishterët e paktë që mbetën kërkuan ta mbanin të gjallë besimin përmes një kiske të fshehtë.

E shtytur prej nevojave, kisha e fshehtë nuk u organizua formalisht e as nuk u rrjetëzua. Lidhjet mes besimtarëve gjithmonë rezultuan vdekjeprurëse. Trajnimi dhe mbikëqyrja pastorale ishin të pamundura. Shumica e të krishterëve adhuronin në fshehtësi vetëm në praninë e familjarëve të tyre. Ata që kishin besuar te Krishti përpara fundit të Luftës së Koreve—ata që kishin pasur trajnim të plotë dishepullimi—po plakeshin; moshë mesatare e të krishterëve ishte mbi gjashtëdhjetë vjeç. Kishin mbetur vetëm pak kryqe dhe kapituj të dëmtuar të Biblës. Prindërit nuk mund t’u flisnin dot lirshëm as fëmijëve të tyre për Perëndinë; nëse do t’u flisnin, fëmijët do të mashtroheshin prej mësuesve të shkollave publike për të zbuluar identitetin e krishterë të familjes. Nëse prindërit e një fëmije të krishterë vdisnin përpara se fëmija të bëhej pesëmbëdhjetë vjeç, fëmija nuk do ta dinte kurrë se familja e tij/saj ishte të krishterë.

Në fillim të viteve 1980, Fondacioni i Krishterë Korean i qeverisë së Koresë së Veriut hapi kishën e tij të parë false për t’i

mashtuar vizitorët e huaj që të mendonin se të krishterët ishin në gjendje ta praktikonin lirshëm fenë e tyre. Në shërbesat e inskenuara me kujdes prej Fondacionit, një grup i vogël aktorësh të trajnuar prej shtetit përdornin himnet e krijuara nga Psalmet prej Kishës Presbiteriane të Koresë në mesin e viteve 1930. Në vitin 1984, komunistët e Koresë së Veriut përkthyen dhe shtypën një numër të vogël biblash dhe një libër himnesh. Në vitin 1988, ata ndërtuan një ndërtesë kishe për ta plotësuar fasadën. Në vitin 1989, Koreja e Veriut hapi dy kisha të tjera false—Bongsu dhe Çilgol—dhe inskenoi veprimtari fetare si shërbesat e Krishtlindjes dhe të Pashkës, kur vizitorët ishin të pranishëm.^{xv}

Por gjatë kësaj periudhe nisi edhe një nivel i ri i veprimtarive të singërta fetare—veprimtari të cilat i kapën në befasi koreano-veriorët. Kina u bë një vend më i hapur. Në fillimin e viteve 1990, të nxitur prej misionarëve të Koresë së Jugut, të krishterët etnikë koreanë që jetonin në Kinë shkuan në Korenë e Veriut për të ndarë ungjillin. Pastaj gjatë Marsit të Mundimit—periudha e padëgjuar më parë e urisë në mes të viteve 1990—qindra mijëra koreano-veriorë u arratisën për në Kinë e Rusi, ku misionarët e krishterë i drejtuan ata për tek besimi në Krishtin. Shumë veta u bënë të krishterë besnikë, që u rikthyen në Korenë e Veriut me vizionin për ta rindërtuar kishën e Koresë së Veriut.

Numri i të krishterëve të fshehtë u shumëfishua, e bashkë më të edhe numri i martirëve. Koreja e Veriut i arrestoi këta të krishterë të rinj për spiunazh kur ata u rikthyen në Korenë e Veriut. Së pari, Departamenti i Integritetit i mori nën hetim individët bazuar mbi informacionin e marrë prej qytetarëve koreano-veriorë që i tradhtuan fqinjët e tyre të shtytur nga frika prej qeverisë. Pas hetimit, i krishteri ose ekzekutohej publikisht, ose dërgohej në një kamp përqendrimi.

Sot, ndërsa Kim Jong Uni dërgon jashtë shtetit më shumë se 40,000 punëtorë koreano-veriorë në 40 vende të ndryshme anembanë botës në një përpjekje për të sjellë në Korenë e Veriut valutën

e fortë që nevojitet aq shumë,^{xvi} gjasat që koreanoveriorët të vijnë në kontakt me ungjillin—dhe ta sjellin atë me vete në Korenë e Veriut së bashku me monedhat e huaja—vazhdojnë të rriten. Prapëseprapë, është e pamundur që të krishterët koreanoveriorë ta pranojnë haptas besimin e tyre, përveçse nëse dezertojnë dhe marrin shtetësi diku tjetër; rasti më tipik është në Korenë e Jugut. Tani ka më shumë se njëzetetremijë refugjatë koreanoveriorë në Korenë e Jugut,^{xvii} dhe më pak se 1 përqind e tyre kanë njohuri personale për ekzistencën e të krishterëve në Korenë e Veriut. Shumica e refugjatëve u njohën me Perëndinë në Kinë, dhe shumë prej tyre tani janë përfshirë në ndërmarrjen ose mbështetjen e përpjekjeve për shërbesa që ta arrijnë atdheun e tyre për ungjillin. Sot, vlerësimet më të besueshme tregojnë se ka afro njëqind mijë të krishterë të fshehtë brenda Koresë së Veriut.

Kjo është përmbledhja e historisë së krishterimit në Korenë e Veriut—datat, detajet dhe statistikat. Gjatë dhjetë viteve të fundit, bashkëshortja ime, Hjun Suk (Hyun Sook), dhe unë e vëllai ynë DH, shefi i operacioneve në Seul SHBA, e kemi treguar atë histori në çdo kontinent. Por vitin e kaluar, ndodhi diçka që më mrekulloi, aq sa t’jua tregoj edhe juve tani. Ne takuam një çift—që duhet t’i quajmë Z. dhe Znj. Bae për t’i mbrojtur identitetet e tyre të vërteta—familja e të cilëve e ka jetuar tërë historinë, që nga përndjekja japoneze përmes natës së errët të formimit të shtetit të Koresë së Veriut, përmes viteve të heshtjes absolute dhe izolimit e terrorit, përmes rilidhjes me misionarët në Kinë, dhe tani përmes mbërritjes së tyre në Korenë e Jugut për ta ndarë historinë e tyre me botën. Historia e tyre familjare është ajo e sigurimit të mrekullueshëm dhe e urisë së zgjatur; e çlirimit prej të ligut dhe e dorëzimit në duart e tij; e besimit aq të madh saqë i shkundi fshatrat dhe e besimit aq të qetë, saqë kaloi i pavënë re, por duke mbetur besnik, nën hundën e shtetit që ishte gjithnjë vigjilent.

Është një histori që zbulon për herë të parë përpara botës sesa e ndryshme është kisha e fshehtë koreanoveriore prej çdo kishe

tjetër në botë—dhe sesi është ajo çuditërisht më e çmuar, më e bukur dhe më udhëzuese. Për vite të tëra, ideja jonë (e pasaktë) për kishën e fshehtë koreanoveriore ka qenë ajo e një versioni më ekstrem të kishës së fshehtë kineze, me besimtarët që i mbajnë Biblat dhe shohin fshehurazi nga pas krahëve, teksa mblidhen në grupe nëpër shpella dhe në shtëpitë e besimtarëve nën mbulesën e natës. Por e vërteta për kishën koreanoveriore, që na paraqitet për një periudhë kohore të afro një shekulli në jetën e familjes Bae në këtë libër, është në thelb ndryshe nga kjo. Siç do ta shikoni, të krishterët e fshehtë koreanoveriorë janë si ata njerëzit që kanë trashëguar një grusht me copëza të lojës formuese (puzzle) që janë të zbehta dhe të shformuara keqas. Ata e dinë se gjëja që kanë marrë është tej mase e çmuar, por nuk e kanë parë kurrë kapakun me pamjen e plotë të kutisë së lojës formuese, kështu që ata nuk e dinë sesi do të ishte pamja që do të formonin po t'i kishin të gjitha copëzat e lojës formuese. Ata i ruajnë ato copëza të lojës me jetën e tyre, dhe në fakt e tërë jeta e tyre është e përqendruar për të kuptuar copëzat që kanë dhe për t'u siguruar se do t'i transmetojnë këto copëza, si dhe për të kërkuar për copëzat e tjera dhe për informacion për kapakun e kutisë së formueses.

Pothuajse të gjithë të krishterët koreanoveriorë, historitë e të cilëve i keni lexuar, nuk janë të krishterë të këtij lloji. Ata janë individë që së fundmi mësuuan për Krishtin në Kinë dhe e sollën atë—dhe një sasi të duhur të mësimëve e materialeve sistematike—me vete në Korenë e Veriut. Kurse familja Bae është prej një pjese krejt të ndryshme të vathës së deleve. Ata janë personat që mbetën, të lindur prej martirëve, trashëgimtarë të besimit të guximshëm të paraardhësve të tyre, ruajtës të ungjillit në qoshen më të errët të botës, ndër ata shtatëmjë të Perëndisë, të cilëve ai iu dha detyrën thuajse të pamundur për të mos iu përlulur kurrë baalëve^{xviii} në vendin që mund të quhet më idhujtari në historinë njerëzore.

“Këta janë brezat”, - përsëritet kapitull pas kapitulli në librin e Zanafillës. Në mënyrë të ngjashme, këta janë brezat e kishës në

Këta janë brezat

Korenë e Veriut. Këta janë brezat për të cilët ne nuk kemi ditur pothuajse asgjë, me përjashtim të datave, detajeve dhe statistikave, që ishin gjurmët që ata lanë. Tani ata na shfaqen përpara këtu në Technicolor (film me ngjyra)—jo si shenjtorë të stërveçantë, por si biznesmenë dhe bukëpjekës, të burgosur dhe profetë, ungjilltarë dhe shtylla të padukshme të një mbretërie të patundur.

Z. dhe Znj. Bae janë ende në një mision, edhe pse ai nuk është një mision ose vizion personal që filloi me ta. Është një besim që ata e trashëguan, diçka me të cilën ata janë të lidhur për ta mbështetur dhe për ta përfunduar. Ajo që më mrekullon—dhe më përul—është shkalla deri në të cilën ata e kanë shfaqur një besnikëri të tillë të kushtueshme dhe të plotë, pavarësisht se kishin shumë më pak copëza të lojës formuese se unë, për të mos përmendur se nuk kishin as kapakun me figurën e kutisë përmes së cilës t'i organizonin copëzat.

Unë ende mundem ta dëgjoj përgjigjen e atyre të krishterëve të fshehtë koreanoveriorë ndaj pyetjes sonë disa vjet më parë: “Ju luteni për ne? Ne lutemi për ju!” Ne mund t'i kemi të gjitha copëzat e lojës formuese, dhe madje ta kemi edhe kapakun me figurën e kutisë, kurse ata, duke kapur fort ndonjëherë vetëm një copëz të përthyer të formueses brenda grushtit të tyre që dridhet, por që është i mbyllur fort e me nderim, dhe adhurojnë e i besojnë Bërësit të lojës formuese në mënyra që mua do të më duhet ende t'i mësoj. Me pasurinë, pushtetin dhe lirinë time, në krahasim me ta, unë shpesh jam i rrethuar me tej mase shumë lojëra formuese, e nuk e shoh dot Atë që ka rëndësi me të vërtetë.

*Nga i Përndershmi Erik Folei, Drejtori Ekzekutiv,
Seul SHBA (Seoul USA)*

22 qershor 2012

Seul, Kore

KAPITULLI NJË

Gjyshi: Fanatiku origjinal për Jezusin në Korenë e Veriut

Nga Z. Bae

Disa histori besimi janë kaq befasuese, saqë mezi pret të dëgjosh sesi përfundojnë. Kështu jam ndier gjithmonë për historitë e gjyshit tim. Si një djalosh njëmbëdhjetë vjeçar në Korenë e Veriut, që ishte i pikëlluar për vdekjen e tij, unë i lutesha vazhdimisht gjyshes që të m'i pëshpëriste vazhdimisht historitë e tij në netët e errëta të dimrit, edhe pse që të dy e dinim se ritregimi i këtyre historive ose edhe dëgjimi i tyre ishte një vepër tradhtie që e rrezikonte krejt familjen tonë. Vite më vonë, kur rrija ulur në dyshemenë e ftohtë të një burgu në Korenë e Veriut, në të njëjtin pozicion çdo ditë që nga mëngjesi deri në orën 10 të natës për më tepër se një vit, unë e bluaja në mendje edhe detajin më të vogël të njërës prej atyre ngjarjeve për ditë të tëra. Dhe këto ditë, teksa punoj në një lavazh makinash në Korenë e Jugut, në bindje ndaj thirrjes së Perëndisë që unë duhet ta rris vazhën time si një shëruese për kombin tonë të thyer e të ndarë, janë pikërisht historitë e tij që më vijnë ndërmend, ndërsa mendimet e mia drejtohen drejt qiellit.

Sa do të doja që ta kishit njohur gjyshin tim. Në fakt, kur nis t'ju tregoj historinë për jetën e gjyshit tim—sesi Perëndia do t'i fliste atij me një zë aq të lartë, saqë ai thujse do të shurdhohej... sesi, me hirin e Perëndisë, ai e shpëtoi fshatin e tij herë pas here

Këta janë brezat

duke iu bindur urdhrave të mistershme të Perëndisë (njëri më i misterhëm se tjetri)... dhe sesi ai i ungjillëzoi grabitësit dhe ushtritë pushtuese, teksa sakrifikoi trupin e tij për të mos lejuar që të digjej një ndërtesë kishe (ndërkohë që pastori ishte fshehur dhe ishte i sigurt larg syve të tyre)—mendoj se do të tundoheshit për t'i kaluar këto faqe e për të shkuar deri në fund të kapitullit, që të mund të lexonit sesi përfundoi e gjitha kjo.

Por unë do t'ju kursej atë tundim duke filluar me fundin e historisë së gjyshit tim:

Dhe kështu gjyshi im i dogji të gjitha Biblat, ashtu siç e kishte urdhëruar Perëndia, dhe u tregua më i zgjuar se autoritetet e Koresë së Veriut.

Dhe ungjilli vazhdoi të përhapej.

Ky mund të tingëllojë si një përfundim shumë i pazakontë për një histori rreth besnikërisë së krishterë ndër breza, por Koreja e Veriut është një vend shumë i pazakonshëm për të qenë besnik. Në Korenë e Veriut, besnikëria nuk është diçka me të cilën të krishterët merren ndërkohë që janë të ngarkuar me bërjen e gjërave të tjera të krishtera. Është ajo që ata bëjnë me mendjet, shpirtrat dhe trupat e forcën e tyre, dhe pothuajse gjithmonë ajo u kushton jetën atyre. Pra, është një diçka shumë e çmuar, dhe kjo nënkupton se historitë tona shpesh kanë fillime të pazakonta dhe funde të pazakonta. Si kjo.

Historia e gjyshit tim nuk fillon në Korenë e Veriut. Natyrisht, në ato kohë nuk kishte fare as Kore të Veriut, as Kore të Jugut—vetëm një Kore, nën sundimin brutal të një perandorie japoneze, që në ato kohë, po shtrihej në tërë Kinën si një tajfun. Por ju mund të befasoneni kur të mësoni sesi Perëndia e urdhëroi gjyshin tim për të qëndruar ndërsa tajfuni shfaqte fuqinë e plotë të tij dhe për ta qetësuar atë në emrin e Jezusit.

Por po ec tepër shpejt. Më lejoni ta nis nga fillimi.

Ai do t'ju duket si një personazh legjendash. Por për mua ai ishte thjesht gjyshi—babai i mamasë time dhe një drejtues kishe,

ndonëse para së gjithash ishte shërbëtor i Perëndisë në një vend të keq e kohë të keqe.

Ai ishte njëlloj i dashur e i sinqertë, i zgjuar dhe i mirë. Ai gjithnjë ishte i rrethuar nga njerëz në të gjitha orët e ditës, ndonëse shumë veta thjesht pluskonin afër tij në perimetrin e një rrethi të madh të padukshëm që lëvizte kudo ku shkonte ai. Pamja e fytyrave të njerëzve kur e përshëndesnin atë—unë i mbaj mend ato fytyra pothuajse më tepër se fytyrën e vetë atij. Kur e shihja mënyrën sesi e trajtonin atë njerëzit me autoritet, ndërsa isha djalosh në Korenë e Veriut, unë mbushesha me krenarinë e adoleshentit. Ai vetë kurrë nuk ishte krenar, por gjithnjë ndalonte për t'u ardhur në ndihmë nevojtarëve, gjithnjë ndante një fjalë inkurajimi dhe këshilla e tij e vazhdueshme ishte të kishin besim.

Familja ime do t'i kujtonte ato ditë si një ëndërr fluturake—vërtet vallë të kishte qenë një kohë kur emri i familjes sonë nderohej? Për mishin tonë, ato ishin vite prej ari të kulluar. Por gjyshi na thoshte atëherë dhe shumë më vonë se Perëndia gjithmonë u kujdes për ne, pavarësisht sesa të zymta dukeshin gjërat.

Gjyshi e dëgjoji zërin e Zotit për herë të parë rreth viteve të Luftës së Dytë Botërore. Atij do t'i jetë dashur ta shquante atë zë përmbi zhurmën e tankeve dhe zjarrin e mortajave, ndërkohë që japonezët përparonin në mënyrë të qëndrueshme përmes pjesës së Kinës verilindore ku jetonte familja ime. Kur ma tregonte gjyshja historinë e gjyshit dhe të japonezëve, unë gjithnjë vrisja mendjen se ku e kishte mësuar gjyshi ta fliste aq mirë japonishten, përveç koreanishtes dhe kinezçes. Kontingjenti i ushtrisë japoneze që erdhi për ta shkatërruar ndërtesën e kishës atë ditë duhet ta ketë pyetur veten për të njëjtën gjë.

Japonezët i shtypnin kinezët në Kinë më tepër nga sa shtypnin të ardhurit koreanë që jetonin atje. Në mendjet e tyre, kinezët ishin të paqytetëruar dhe të pistë, kurse koreanët ishin diçka më mirë. Por asgjë nuk i përgatiti ata për takimin me gjyshin tim.

Ai kishte qenë duke agjëruar për ca ditë kur, sipas gjyshes sime, ai e dëgjoi Perëndinë ta thërriste—me emër— me një zë aq të lartë, aq shurdhues, sa të gjithë tingujt e tjerë, përfshirë edhe heshtjen, u shkrumbuan në çast.

“Sung do! Sung do! Sung do!” - gjëmonte zëri. “Japonezët nuk do të të lëndojnë. Afroju atyre.”

T’u afroheshe atyre keqtrajtuesve që ishin duke i ndjekur të krishterët si të ishin gjahu i tyre për t’i vrarë, dhe që ua rrënonin ndërtesat e tyre të kishave? Kur ndodhi për herë të parë, na tregoi gjyshi, ai ishte i sigurt se e kishte dëgjuar gabim. Prandaj ai mbeti atje, i palëvizur, në lutje. Zëri e përsëriti mesazhin në mënyrë identike tri a katër të tjera.

Ai i mbylli lutjet dhe mbaroi agjërimin e tij; arriti në përfundimin se e kishte dëgjuar vërtet zërin e Perëndisë; se duhej t’i bindej atij; se duhej të rrinte dhe të zhvillonte marrëdhëniet me japonezët, në vend që të përpiqej të arratisej.

Çmenduri. Pikërisht këtë gjë duhet të ketë menduar batalioni japonez kur erdhi për ta shkatërruar kishën atë ditë. Ashtu duhet të ketë menduar edhe pastori i kishës—që prej vendit ku rrinte fshehur. Megjithatë, gjyshi im e bllokoi qetësisht hyrjen tek dera me trupin e tij, ndërkohë që u foli atyre në japonisht, duke iu drejtuar sikur të ishin miqtë e tij, teksa u kërkonte me lutje që të mos e shkatërronin ndërtesën.

Ata u shtangën kur panë një mburojë njerëzore, lëre më një që fliste japonisht. “Qenka një burrë që flet mirë japonisht mes pisave!” - u mrekulluan ata. Dhe ata ndaluan e po rrinin në këmbë atje, të palëvizur, me sëpatat dhe varetë në duar, teksa gjyshi im po u shpjegonte këndshëm dhe me një japonishte të përsosur përse mblidheshin njerëzit në kishë, kush ishte Perëndia, dhe pse ata duhej të pendoheshin dhe ta pranonin ftesën e Perëndisë në Krishtin për t’u pajtuar me të përjetë. Gjyshi im raportoi se atë ditë shumë ushtarë japonezë u bënë të krishterë. Dhe kisha vazhdoi të qëndronte në këmbë.

Disa prej të krishterëve tashmë ishin larguar me të katra prej fshatit, kurse të tjerët qëndruan për shkak të gjyshit tim. Ai nuk ishte pastori, por ata e ndiqnin atë. Ata e quanin atë “Fanatiku i Jezusit” (po, ky ishte vërtet llagapi i tij) edhe kur ishte mjaft i thyer në moshë.

Nuk e di nëse gjyshi im në të vërtetë donte ta dëgjonte zërin e Perëndisë, ngaqë zakonisht kur e dëgjonte, kjo ishte një shenjë se po bëhej gati të ndodhte diçka shumë e keqe, dhe gjyshi im do të duhej të sillej në një mënyrë që ishte krejt e kundërta e asaj që do të diktonte logjika dhe veprimet e njerëzve të arsyeshem. Si ajo koha pak pasi Perëndia e përdori atë për ta shpëtuar kishën. Ai ishte i përlur, por e imagjinoj se duhej të kishte qenë të paktën përbrenda i kënaqur që përplasja me japonezët doli për mirë. Prandaj, kur ai zëri që të shponte veshët e thirri sërish emrin e tij, pyes veten nëse ai u zbraps qoftë edhe për pak.

Dhe kur zëri i tha “Nëse nuk do që njerëzit në qytetin tënd të vdesin, largohu nga fshati e shko të punosh”, kjo gjë e la atë në një situatë të vështirë. Të shkoj të punoj? Ai i kërkoi Perëndisë më tepër detaje, ngaqë nuk ishte i sigurt çfarë të bënte. Por sa më tepër detaje që merrte, aq më pak ngushëllohej. Zëri e udhëzoi që të shkonte e t’i kërkonte çdo fshatari, i krishterë ose jo, që t’ia jepte atij gjithçka që zotëronte. Mos e përmend fare Perëndinë gjatë procesit. Merre me vete gjithçka që të jepet në një vend të largët. Investoje. Pastaj kthehu në fshat pas dyzet ditësh.

Duhej të ketë qenë diçka mjaft përlulëse për të që të shkonte derë më derë për ta bërë një kërkesë të tillë. Natyrisht, disa fshatarë e tallnin dhe e përqeshnin atë, por mund të habiteni sa pak ishin ata që e bënë këtë. Në fund të fundit, edhe pse që të gjithë—të krishterë ose jo—e quanin atë “Fanatiku i Jezusit,” ata nuk mund ta vinin në dyshim guximin e tij dhe aftësitë e favorin me Perëndinë përballë pushtuesve japonezë. Dhe jam i sigurt se Perëndia i zbuti zemrat e shumë vetave që ta përcillnin gjyshin tim me një sasi modeste parash. Madje pati disa nga ata, prodhimet e fushave

Këta janë brezat

të të cilëve kishin qenë të dobëta, që i besuan atij gjithçka që u kishte mbetur. Afro dyzet ditë pasi gjyshi im ishte larguar nga qyteti, erdhi Mafia. Ata iu vërsulën fshatit që prej maleve përreth. Erdhën si karkalecat dhe grabitën gjithçka prej gjithsecilit. Ashtu siç tha gjyshja ime (në fund të fundit, ajo dhe pjesa tjetër e familjes ishin akoma atje), ata nuk lanë pas as edhe një gjë të vetme, as edhe një zog pule.

Fshatarët nuk e lanë pa vënë re se dita kur Mafia u largua nga qyteti ishte po ashtu dita kur gjyshi im duhej të kthehej atje. Por ai nuk u kthye.

Kështu që ditën tjetër, një fshatar erdhi tek shtëpia e gjyshes sime dhe nisi ta përndiqte atë me zemërim për tërë situatën. Ai në fakt e kapi atë dhe ia përplasi në mënyrë të përsëritur kokën pas murit.

Fshatarët e tjerë nuk ishin më të mirë. Ata jetonin në kushtet më të varfra. Shumë veta po vuanin urie për shkak të vitit të keq në të korrat, gjëra që kishin ndodhur përpara se të mbërrinin banditët. Meriton të përmendet se gjyshja ime vajti derë më derë dhe ndau ushqimin që i kishte mbetur me secilën familje, duke i nxitur ata që të kishin durim për kthimin e gjyshit tim. Disa u prekën dhe thanë se do të prisnin, edhe sikur kjo të nënkuptonte se ata do të vdisnin përpara kthimit të tij. Kurse të tjerët ankoheshin ende.

Në fund fare, pasi e kishte dhuruar të gjithë ushqimin e saj dhe nuk kishte futur asgjë në gojë për ditë të tëra, ajo u dobësua dhe e humbi shpresën. Dyzetetë ditë pasi gjyshi ishte larguar, gjyshja ime vendosi se, po të mos kthehej ai atë ditë, ajo do t'i jepte fund jetës. Me këtë vendim të fortë në mendje, ajo i shpuri fëmijët poshtë tek doku.

Gjyshi im gjithmonë mbante një shall të bardhë rreth qafës. Në agim, kur gjyshja dhe fëmijët e saj po prisnin, po ngrihej dielli. Po afrohej një varkë, por ajo nuk shihte dot kush ishte atje për shkak të shkëlqimit të diellit. Por pastaj ajo mundi të shihte një person në kuvertë, që kishte veshur diçka të bardhë, dhe ajo u kujtua për

shallin e tij. Pastaj ajo pa se figura po tundte një shall të bardhë drejt saj. Ajo mori një copë nga veshja e saj dhe e tundi për t'i kthyer përshëndetjen. Ishte ai!

Teksa anija po afrohej, ajo dhe fëmijët nisën të kërcenin dhe të qanin. Ajo donte t'i mblidhte fqinjët e saj, por nuk mundi. Ajo po vuante urie dhe nuk ishte në gjendje të ecte më shumë.

Ai ishte larguar për dyzetetë ditë. Atë ditë tek doku ishin mbledhur edhe disa të rinj e të vjetër; gjyshi im ishte shpresa e tyre e vetme. Gjyshja ime thotë se ata kishin ardhur për të parë nëse kishte ndonjë gjë për të ngrënë dhe, nëse jo, ata planifikonin që të vdisnin atje gjithashtu. Ajo tha se deri sa u lidh në dok anija me të cilën erdhi gjyshi im, porti dukej si një plazh me rërë të bardhë, për shkak të numrit të madh të njerëzve që ishin mbledhur atje.

Me një turmë të tillë të pranishme që shtyhej drejt tyre, nuk kishte kohë për përshëndetjet personale ose për ndonjë këmbim informacioni mes tyre. Dikush duhej t'i fliste kësaj turme të paduruar, të uritur, dhe gjyshja ime, e fuqizuar prej kësaj kthese të bekuar e me shumë fat të ngjarjeve, ia caktoi vetes atë detyrë.

Ajo u ngrit në këmbë në majë të anijes dhe u qëndroi përballë fshatarëve, që kohët e fundit kishin qenë aq armiqësorë ndaj saj. Gjëja e parë që tha ishte se ajo nuk do t'u jepte fare asnjë ushqim nga anija, për shkak se ata kishin qenë kaq të ashpër dhe të dhunshëm me të. Ajo i qortoi ata që nuk i kishin zënë besë asaj dhe burrit të saj, ose që nuk kishin menduar se ai kishte hasur në një vonesë të pashmangshme dhe krejtësisht të kuptueshme. Ajo bëri të ditur se anija ishte e tejmbushur me ushqim, por që ai ushqim nuk do të shpërndahej për shkak të zemërgurtësisë së atyre që, për shembull, ia kishin përplasur kokën asaj pas murit. Të gjithë qanin heshtur dhe kërkuan falje. Ajo vazhdoi t'i kujtonte se nuk i kishte mashtruar kurrë fshatarët, por vetëm e kishte sakrifikuar vetveten dhe ushqimin e saj për ta.

Pastaj, gjyshi im e preku atë butësisht tek supi dhe i tha: "Prit. Më lejo t'u flas unë atyre." Ai u kthye nga turma dhe nisi

Këta janë brezat

t'u fliste, duke thënë se kjo ishte puna e shërbesës—t'i drejtonin njerëzit tek Perëndia. Jo që të bënin para, i siguroi ai ata, por të nxisnin bindjen ndaj Perëndisë, për shkak se, në fund të fundit, Perëndia ishte Ai që i kishte kërkuar atij ta shpëtonte fshatin në radhë të parë. Ai u shpjegoi të gjithëve se ishte i krishterë dhe se e dinte se gjërat që po u tregonte do të ishin të vështira për t'u kuptuar prej jo të krishterëve. Kështu që ai ua vuri në dukje atyre se, po të mos ishte larguar për biznes, paratë që i kishin dhënë fshatarët atij do t'u ishin grabitur prej hajdutëve. Kjo i dha atij sigurinë se ishte Perëndia ai që e kishte dërguar larg për t'i shpëtuar fshatarët, dhe prandaj gjëja e dukshme që duhej të bënte gjithsecili ishte të besonin tek Perëndia. Ai u tha atyre se Perëndia e kishte aftësuar atë të fitonte aq shumë para, saqë fshatarët do të kishin mjaftueshëm për të ngrënë për disa vitet e ardhshme. Që të gjithë besimtarët dhe madje edhe jobesimtarët tundën kokat në shenjë miratimi teksa e dëgjonin atë.

Pastaj ai u kërkoi atyre që i kishin besuar atij dhe i kishin dhënë para që të qëndronin në njërën anë. Ai shpalli se secili prej këtyre investitorëve do të merrte njëqindfishin e asaj që i kishte dhënë atij. Njëqind herë më shumë!

Të tjerëve u vinte turp nga vetja dhe nisën t'u luteshin gjyshërve të mi që t'i shpëtonin edhe ata. Ata përsëritnin pa pushim me zë të lartë: “Shpëtona! Shpëtona! Shpëtona!” Gjyshi im tha se ai do t'u zinte besë vetëm atyre që e kishin ndihmuar atë, por theksoi se me siguri ishte Perëndia ai që i kishte kërkuar atij të largohej, me qëllim që ta shpëtonte tërë fshatin. Prandaj ai i pyeti fshatarët e pjesës tjetër: “Po tani, a do t'i besoni Perëndisë?” Ata u përgjigjën: “Po! Po! Ne besojmë në Perëndinë!” Nuk dukeshin si njerëz të vuajtur urie, teksa i tundnin duart dhe brohorisnin me sa fuqi kishin.

Ajo që ndodhi pastaj i befaso i të gjithëve. Gjyshi u dha të gjithëve të njëjtën sasi ushqimi, pavarësisht nëse e kishin mbështetur atë apo jo. Dhe kështu ndodhi që gjithkush në fshat nisi të shkonte në kishë.

Pas gjithë kësaj, ju mund ta përfytyroni se gjyshi po gëzonte një popullaritet të një niveli të padëgjuar më parë. Kështu që, kur ndodhi përsëri, shumë shpejt pas kthimit të tij, që ai zëri shurdhues shpoi heshtjen e lutjeve dhe agjërimit të tij dhe e thirri me emër, ai duhet të ketë dashur të fshihet. Dhe kur ai zëri e urdhëroi që të largohej menjëherë nga fshati dhe ta merrte familjen me vete, unë mund ta kuptoj përse rezistoi ai në fillim. Në fund të fundit, ai kishte ndërtuar një reputacion të patëmetë mes fshatarëve. Mbrojtësi i kishës! Biznesmeni ekselent! Ungjilltari i pashoq!

Por zëri këmbënguli, duke thënë se ishte koha për ta shpëtuar fshatin edhe një herë tjetër—kësaj radhe duke u larguar prej tij. Gjyshi im dhe familja e tij dolën këmbëzvarrë nga qyteza, ndërkohë që fshatarët mëdyshas i vëzhgonin me habi. “Sa njeri i çuditshëm!” - menduan ata. “Pikërisht sapo arrin diçka, ai lë pas gjithçka, pa marrë gjë mbrapsht.”

Ndoshta ata menduan shumë për atë burrë të çuditshëm dhe kërkesën e Perëndisë së tij të çuditshëm që ta shpëtonte fshatin, kur shumë shpejt pas largimit të gjyshit, shpërthimi i tifos e shkatërroi fshatin. Shumë veta vdiqën ose u bënë të paaftë. Kurse familja jonë ishte mbrojtur, prej hirit të Perëndisë.

Po ç’u bë me premtimin se gjyshi im do ta shpëtonte fshatin? Ajo mund të jetë historia më e çuditshme prej të gjithave. Kur gjyshi u largua, ai dhe familja kaluan tek fshati i kushëririt të tyre. Por ai fshat ishte në gjendje të tmerrshme—fqinjë të pasur, grabitës, hajdutë, dhe shumë njerëz të ligj jetonin atje. Ishte si një Sodomë e Gomorrë virtuale.

Ata i shpaketuan çantat dhe nisën të jetonin atje. Pasi e kaluan vitin tjetër duke i ndihmuar të varfrit, siç e kishin zakon, gjyshi dhe familja e tij e panë veten në kushte të vështira. Dikush hyri tek shtëpia e tyre dhe ua grabiti gjërat. Gjyshja ime vajtonte, kurse gjyshi vazhdonte të lutej. Gjyshi im besonte se ata po sprovoheshin nga Perëndia, që ai të mund ta shihte nëse ata kishin besim tek ai apo jo.

Këta janë brezat

Pas një viti tjetër, gjyshi im dëgjoji sërish nga Perëndia. Mesazhi ishte i njëjti: “Ti do t’i shpëtosh fshatarët.” Ai e dëgjoji atë tri herë, me zë të lartë si gjithmonë.

Kështu që e diskutoi atë me të shoqen. Ajo shqetësohej, ngaqë ata as nuk kishin ushqim për të ngrënë. Si mundeshin ata ta shpëtonin vetveten, lëre më pastaj fshatin e tyre të vjetër? Ajo tha me vete se ai duhej të ishte duke menduar që të largohej sërish për biznes, dhe unë përfytyroj se ndoshta ajo nuk donte që t’ia përplasnin kokën pas një muri tjetër. Por ai premtoi se do të qëndronte, duke thënë se Perëndia nuk i kishte thënë për të shkuar gjëkund ose për të bërë ndonjë gjë. Ai tha se ata thjesht duhej të besonin se Perëndia mund të kishte një qëllim e një plan. Kështu që ata pritën.

Në fshatrat malore, bandat me kusarë ishin shumë të zakonshme. Disa dukej sikur kishin njëfarësoj ndërgegjeje, duke vjedhur vetëm prej pasanikëve, kurse të tjerët ishin thjesht të inatosur dhe merrnin gjithçka prej gjithkujt. Kështu që në fshat zbriti një bandë vjedhësish të mirë, të gatshëm për t’i grabitur pasanikët e qytezës. Përfytyrojani befasinë e tyre kur një burrë i varfër—gjyshi im—ua ndërpreu grabitjen me qëllim që t’i edukonte, duke u treguar se është mëkat të vjedhësh prej çfarëdolloj qenieje njerëzore. Nuk ishte predikim. Ai nuk po i drejtonte ata për tek Perëndia. Por ata ndaluan, të shtangur, mjaftueshëm gjatë për t’ia vënë veshin.

Pastaj kryetari i grabitësve (ndoshta duke u sforcuar për të marrë një shpjegim përse një fshatar i varfër do ta rrezikonte jetën e tij për t’i mbrojtur fqinjët pasanikë, që dukej se nuk i kishin dhënë ndonjë ndihmë familjes së tij) e pyeti gjyshin tim, nëse ai kishte lindur në atë fshat. Gjyshi im shpjegoi se ai nuk kishte lindur atje. Ai e prezantoi veten përpara kryebanditit, sikur të ishte duke i folur një vizitori të shquar, dhe i tregoi se në fakt ai ishte prej filan fshati, ca më larg prej atje.

Kur kryebanditi e dëgjoji emrin e fshatit të gjyshit tim, i dha një njohje fillestare. Ai i shpjegoi gjyshit (dhe gjyshes sime, e cila, si

zakonisht, po e vështronte gjithçka me interes të madh) se banda e tij i kishte vjedhur pasanikët e atij fshati, dhe se fshatarët atje i kishin treguar atij historinë për një burrë, që dikur e kishte shpëtuar fshatin prej urisë, pak kohë përpara se të binin ethet e tifos mbi ta. Banditi pyeti nëse gjyshi im kishte dëgjuar për atë burrë.

Në këtë çast, gjyshja ime nuk mundi ta përmbante dot më veten. “Është ai! Është ai!” - bërtiti ajo. Por kjo e hutoi edhe më tepër kryebanditin. Pse, pyeti ai, një burrë i tillë do ta linte pas tij pasurinë dhe emrin e mirë, me qëllim që të shpërngulej në një fshat ku kishte vetëm varfëri dhe lënie pas dore?

Gjyshi im ndjeu një mundësi të artë për ta drejtuar kryebanditin për tek Zoti. Ai i tregoi sesi Perëndia e kishte dërguar atë larg fshatit me qëllim që ta shpëtonte atë. Që të gjithë banditët qeshën me këto fjalë ngaqë gjyshi im, aq i varfër sa ç’ ishte, vështirë të dukej në një pozitë për të shpëtuar ndonjë send. Por gjyshi im e vazhdoi dëshminë e tij i patrembur. Ai u tha se besonte që Fjala e Perëndisë ishte jeta e tij dhe se ai do t’i shpëtonte edhe fshatarët e tanishëm. Dhe ndonëse ai nuk kishte ndonjë gjë për t’i dhënë ndonjërit në këtë moment, Perëndia me siguri do t’i fliste atij dhe do t’i tregonte çfarë të bënte.

Kur ai tha këtë, kryebanditi shpërtheu me të qeshura. Ai u bëri shenjë duke treguar me gishtin e madh të dorës prapa shpatullave të tij drejt një makinerie të madhe e të rëndë për bluarjen e orizit, të cilën disa prej larove të tij po e tërhiqnin me mundim përgjatë rrugës. “Ne i kemi grabitur që të gjithë fshatrat në këtë zonë”, - shpjegoi kryebanditi, - “dhe tani duhet të vazhdojmë më tej. Kjo makineri për bluarjen e orizit është aq e rëndë për ne sa nuk mund ta marrim me vete. Perëndia të ka vendosur ty në shtegun tim pikërisht në këtë çast të duhur. Tani ti mund t’i shpëtosh të gjithë fshatrat!” Dhe të gjithë banditët qeshën, ndonëse kryebanditi dukej sikur e kishte me tërë mend atë që tha.

Teksa gjyshi shkoi ta inspektonte makinën, grabitësit që e kishin mbartur atë i thanë atij se në kohët e hershme ajo makinë

kishte qenë një gjë e mirë për t'u pasur. Ata gjithashtu i dhanë atij një kalë. Dhe kështu, gjyshi im u bë i pasur sa hap e mbyll sytë—pronari i një makine për bluarjen e orizit dhe i një kafshe të bukur dhe të dobishme që vinte bashkë me të.

Por gjyshi im ishte shumë më tepër i interesuar për shpirtrat e grabitësve, sesa për gjendjen e financave të tij. Kështu që ai i kthye shpinën makinës blujtëse dhe i bëri thirrje kryebanditit që të pendohej dhe të besonte se Perëndia ishte i gjallë. “Na ktheni ato që keni vjedhur”, - iu përgjërua ai.

Kryebanditi shpejt e shpejt i hodhi tutje ato mendime për Perëndinë dhe këmbënguli se banda e tij do të kishte nevojë për mishin dhe gjërat e tjera që ata kishin vjedhur për udhëtimin e gjatë që kishin përpara. Por si dhuratë lamtumire, ai ra dakord t'u jepte të gjithë fshatarëve ca mëndafsh për vështirësitë e tyre. Dhe ata u ndanë si miq, ashtu siç bënte gjyshi shpesh me armiqtë e tij, dhe kryebanditi i la me shpresën se gjyshi vërtet do t'i shpëtonte të dy fshatrat me ndihmën e Perëndisë së tij shumë të çuditshëm.

Gjyshja ime tha se kryebanditi premtoi të kthehej sërish një ditë, por ai nuk u kthye kurrë. Por përmes hirit dhe sigurimit të Perëndisë, gjyshi im me të vërtetë i shpëtoi të dy fshatrat. Gjyshërit e mi u begatuan me atë makinën e bluarjes së orizit, fituan para dhe patën të gjithë orizin që ata dhe fshatarët e tjerë kishin nevojë.

Por nuk kaloi shumë kohë, përpara se ai zëri të thërriste: “Sung do! Sung do! Sung do! Atëherë, ashtu si më parë, gjyshi im po lutej. Perëndia i tha atij: “Është koha që të largohesh nga Kina. Nxito dhe shko sa më shpejt në Korenë e Veriut, me çfarëdolloj mënyre.”

Kështu që gjyshi im ia tregoi familjes. Në atë kohë, vëllai më i madh i mamasë sime ishte kreu i familjes dhe kujdesej për gjyshërit e mi. Gjyshja ime kërkoi që të vinin fëmijët. Ajo tha: “Unë nuk mund t'ju detyroj të largoheni. Por unë po largohem. Ju zgjidhni.” Kështu që, prindërit e mi, dy prej vëllezërve më të mëdhenj të mamasë sime, dhe motra e vëllai i saj, të dy më të vegjël nga ajo, që të gjithë u larguan me gjyshërit e mi. Vetëm dy

persona nuk u larguan me ta—njëri prej vëllezërve më të mëdhenj të mamasë sime dhe motra e saj më e madhe.

Perëndia u kërkoi që të largoheshin, dhe atë bënë. Kur ata ishin larguar nga Kina, atje shpërtheu dhunshëm Revolucioni Kulturor anembanë vendit. Ai zgjati për dhjetë vjet dhe qëllimi i tij ishte largimi i të gjithë njerëzve të arsimuar prej pozitave të pushtetit në Kinë. Ju mund ta dini se Mao Ce Duni (Mao Zedong), drejtuesi afatgjatë i Revolucionit Komunist në Kinë, rridhte nga një familjeje fshatarësh. Gruaja e tij e katërt Xhian Çing (Jiang Qing), një aktore, vuri re me shqetësim popullaritetin e Liu Shaoqit, i cili e kishte zëvendësuar Maon në rolin e tij si kryetar shteti, kur Kërcimi i Madh Përpara i Maos në fakt e kishte çuar vendin shumë mbrapa. Xhian Çing e nxiti xhelozinë e Maos, duke këmbëgullur se leksionet që Liu Shaoqi jepte në universitet po e ngrinin Liu Shaoqin lart në sytë e studentëve, duke gëzuar respektin e tyre, dhe ajo këmbënguli se studentët po llastoheshin shumë.

Jo vetëm që Liu Shaoqi u largua nga pozita e tij e punës, por gjithkush që mund të etiketohej si intelektual u sulmua. Prindërit e mi ishin mësues përpara Revolucionit Kulturor, dhe njëri prej xhaxhallarëve të mi ishte mjek. Secili prej anëtarëve të familjes sime do të ishte kualifikuar si intelektual—secili, do me thënë, me përjashtim të atyre të dyve që kishin zgjedhur të rrinin në Kinë. Kështu që, gjithkush në familjen time që do të ishte vrarë në Kinë, tashmë ishte larguar për në Korenë e Veriut, dhe u shpëtua prej zërit të Perëndisë që i kishte ardhur gjyshit tim. Gjithsecili në familje që mund të ishte shpëtuar disi në Kinë, qëndroi atje. Duke i njohur tani dekadat e shtypjes së rëndë që pasardhësve tanë do t'u duhej të përballonin në Korenë e Veriut, unë vetëm mund ta marr me mend se në mëshirën e tij, Perëndia na lëvizi disa nga ne për në Korenë e Veriut dhe i mbajti disa nga ne në Kinë, secilin në atë vend ku, pavarësisht nga vështirësitë pikëlluese në të dyja vendet, me anë të hirit të tij ne do të duronim dhe do ta ruanim mesazhin e Perëndisë së gjyshit tim.

Gjatë Revolucionit Kulturor, socializmi po përhapej më shpejt se në çdo kohë tjetër në Kinë, Bashkimin Sovjetik dhe Korenë e Veriut, dhe kjo nënkuptonte mundime të mëdha për të krishterët. Koreja ishte çliruar prej Japonisë më 15 gusht të vitit 1945. Sovjetikët e çliruan Korenë e Veriut, dhe ata zhvilluan biseda të gjata lidhur me atë që do të emërohej presidenti i këtij shteti të ri. Më në fund, u zgjodh Kim Il Sung, ngaqë ai ishte përfshirë në betejat e armatosura kundër Japonisë dhe ishte i mirënjohur në Korenë e Veriut. Ai u vajos si Drejtuesi Suprem, duke i shqetësuar shumë të krishterët, frikërat e të cilëve shumë shpejt e befasisht do të materializoheshin.

Në atë kohë, njerëzit fetarë hidheshin në det prej Departamentit Shtetëror të Sigurisë që të mbyteshin, me gurë të lidhur rreth qafave të tyre. Të krishterët silleshin për ndëshkim të posaçëm. Koreja e Veriut e idhujtarizoi Kim Il Sungun, dhe i përmbysi të gjitha fetë e tjera, ndërkohë që kontrolli i fortë i Kimit forcohej anembanë vendit.

Për shkak se u linda në vitin 1958, unë kam vetëm historitë e gjyshërve të mi për ta ditur se çfarë ndodhi në ato vite përndjekjeje. Gjyshja ime fliste me një zë të ulët e paralajmërues sesi qeveria kërkonte pa pushim nga një shtëpi në tjetrën, duke djegur Biblat dhe duke kapur personat që dyshoheshin si të krishterë. Ajo më tregoi sesi qeveria i çoi duzina të krishterësh në skajin e një shkëmbi dhe i detyroi ata t'i përgjigjeshin pyetjes: “A do t'i jeni besnikë Shokut Kim Il Sung, apo do të besoni në Perëndinë?” Po që se nga frika e vdekjes do të përgjigjeshin “Kim Il Sungut,” ata “shpëtoheshin”—kurse po të përgjigjeshin “Perëndisë”, ata shtyheshin teposhtë shkëmbit për në detin drithërues. Ajo më tregoi se kjo nisi në vitet 1960.

Nga gjërat që kam dëgjuar prej vëllezërve e motrave më të moshuar në besim, që i mbijetuan çlirimit në Korenë e Veriut, në atë kohë gjithkush që zotëronte një Bibël ose një libër që tregon te fatin ishte në probleme. Çdo libër i këtij lloji merrej e digjej në zjarre gjigante drurësh. Kim Il Sungu tmerrohej me idenë se ndonjë koreanoverior mund t'i shërbente ndonjë perëndie, ngaqë

çdo perëndi, nga vetë përkufizimi, e kërcënonte të drejtën e tij për të folur si zëri i vetëm hyjnor i Koresë së Veriut.

Pak veta e dinë se gjyshi i Kimit nga e ëma ishte pastor ose që gjithsecili në familjen e tij kishte besim në Perëndinë. Babai i tij, Kim Hjong Xhik (Kim Hyong Jik), kishte shkuar në shkollë tek Kolegji Sungsil, një shkollë e krishterë në Pjongjang. Kim Hjong Xhiku e kishte njohur Perëndinë që kur ishte në moshë të re—dhe po ashtu edhe Kim Il Sungu.

Por diçka ndryshoi. Kim Il Sungu në vazhdim do të konfiskonte—prej secilit centimetër katror anembanë Koresë së Veriut—pikërisht atë libër që edhe prindërit, edhe gjyshi i tij dhe gjithë familja e tij e kishin nderuar. Ai dërgoi hetues derë më derë për ta gjetur e për ta djegur atë libër dhe për ta dënuar pronarin e tij kudo ku gjendej libri. Në Korenë e Veriut, njerëzit nisën t'i quanin të gjitha fetë “besëtyt-ni”—edhe kur rrinin strukur nëpër shtëpitë e tyre. Jam i mrekulluar që familja ime ia doli mbanë. Ka vetëm një shpjegim. Ai zëri.

Gjyshi im jetoi edhe për gjashtë vjet të tjerë pasi erdhi bashkë me familjen e tij në Korenë e Veriut. Kur ai erdhi, unë isha tre vjeç, kur ndërroi jetë isha njëmbëdhjetë vjeç. Në ato vite unë shkoja shpesh tek shtëpia e gjyshit tim. Ai mbillte misër, kështu që unë shkoja sidomos për vizitë në kohën kur piqeshin misrat. Po ashtu unë shkoja atje të dielave, dhe ai më tregonte historitë e tij.

Në ato gjashtë vite të fundit të jetës së tij në Korenë e Veriut, gjyshi agjëronte dhe lutej shumicën e kohës. Dukej qartë se ai po bluante shumë gjëra në mendje—kish të ngjarë për të ardhmen e familjes së tij dhe për ruajtjen e mesazhit që i ishte besuar atij. Gjyshja ime tha se në ato vitet e fundit ai e dëgjonte shpesh zërin e Perëndisë, në mbrëmje.

Në një mbrëmje të tillë, ai vrapoi me nxitim për tek e shoqja. “Unë e dëgjova atë!” - pëshpëriti ai me ngut. “Po na ikën koha. Largoji librat! Nuk kemi mjaftueshëm kohë!”

Distanca mes shtëpisë sime dhe asaj të gjyshërve ishte katër kilometra. Ata më dërguan të vrapoja si i çmendur që të merrja

Këta janë brezat

Biblën e mamasë sime. Unë u ktheva, pa frymë, dhe ia zgjata librin gjyshes sime. Ajo e vuri atë përmbi dy Biblat e tjera që kishte familja jonë—Biblën e vjetër e të madhe të gjyshit tim, dhe atë që i përkiste xhaxhait tim.

Me një vështrim që tregonte një zgjidhje të dhimbshme, gjyshja ime i grisi njërën pas tjetrës të gjitha fletët e secilës prej Biblave dhe i dogji ato një e nga një tërë natën, derisa në mëngjes nuk kishte mbetur asnjë gjë. Gjyshi im bënte rojë tek dera.

Mëngjesin tjetër, një hetues nga Departamenti Shtetëror i Sigurisë erdhi te shtëpia. Ai pretendoi se kishin marrë informacion nga njëri prej fqinjëve tanë se brenda shtëpisë sonë ishte fshehur një armë. Por ishte mjaft interesante se ai e kërkoi atë “armën” në raftet tona të librave, e nuk gjeti asgjë atje. Ai u largua po aq vrullshëm sa ç’kishte ardhur.

I kërkova gjyshit të ma tregonte vazhdimisht atë histori. Në atë kohë mamaja ime ishte afro tridhjetë e një ose tridhjetë e dy vjeçe, kurse unë isha një djalë i vogël i magjepsur prej këtij burri të qetë e zemërbutë që gëzonte respektin e gjithkujt që e njihte. Më shumë se gjithçka tjetër, unë magjepsesha me historitë e tij. “Çfarë ndodhi atë natë?” - e pyeta qindra herë. Dhe ai e imitonte atë zërin.

“Sung do! Sung do! Sung do!

“Po?” - u përgjigj gjyshi atë natë. Zëri e thirri atë tre herë, tha ai, dhe secilën herë ai u përgjigj: “Po.”

Pastaj Perëndia tha: “Nuk është më koha që të besoni nga ana e jashtme, por që të besoni nga përbrenda. Biblat që keni duhet të digjen. Nuk ke më kohë tani. Bëje shpejt!” - bërtiti zëri.

Ishte viti 1967.

Dhe kështu gjyshi im i dogji të gjitha Biblat, ashtu siç e kishte urdhëruar Perëndia, dhe u tregua më i zgjuar se autoritetet e Koresë së Veriut.

Dhe ungjilli vazhdoi të përhapej.

KAPITULLI DY

Djali: I krishteri që vodhi patate për të mbijetuar

Nga Z. Bae

Kujtimi im më i hershëm vjen nga koha kur isha pesë vjeç. Gjyshi dhe gjyshja ime po luteshin, me sytë mbyllur dhe kokat ulur, duke murmuritur. Kjo më frikësoi.

Nuk më trembi fakti që po luteshin, por ajo që më tha gjyshja kur i hapi sytë dhe më pa se po i vëzhgoja me kujdes. Ajo tha qetësisht por me vendosmëri: “Mos i trego askujt për këtë gjë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të tregosh. Po t’i thuash ndonjërit, do të vijnë burra të këqij e do të të marrin.” Natyrisht që unë nuk i tregova askujt asnjëherë. Por që nga ajo kohë, më bëhej trupi mornica kur kisha pranë njerëz të panjohur.

Për herë të parë i dëgjova Dhjetë Urdhërimet prej buzëve të gjyshit tim. Ai kurrë nuk i quajti ato Dhjetë Urdhërimet, dhe as nuk e përmendi se prej nga kishin ardhur ato, ose kush i kishte dhënë. Ato ishin dhjetë këshilla që e dëgjoja atë t’ia jepte vazhdimisht mamasë e babait tim, xhaxhait dhe anëtarëve të tjerë të familjes, teksa mblidheshim bashkë në shtëpinë e gjyshërve të mi çdo të diel në mëngjes përpara agimit. Mos vidhni. Mos lakmoni. Mos gënjeni. Nderoni nënën dhe babain. Nuk ka rëndësi cili ishte problemi; njëra nga ato dhjetë këshillat dukej se ishte gjithmonë zgjidhja.

Koreanoveriorët punonin çdo të diel, por ne ecnim katër kilometra prej apartamentit tonë në katin e dytë në qytet deri tek shtëpia e

gjyshërve të mi në periferi të qytetit çdo javë pa munguar asnjëherë. Ndërkohë që gjyshja përgatiste mëngjesin për ne, gjyshi im u fliste të rriturve dhe bisedonte me ta, duke diskutuar çfarë ishte e mirë apo e keqe në gjërat që ata kishin bërë atë javë, dhe i këshillonte ata sesi të mendonin e të vepronin ndryshe në javën që do të vinte. Mos vidhni. Mos lakmoni. Mos gënjeni. Nderoni nënën dhe babain.

Pastaj gjyshja ime sillte ushqimin dhe gjithsecili në familje ulte kokën dhe mbyllte sytë, dhe gjyshi murmuriste diçka përpara se ne të hanim. Ajo as që nuk mund të quhej e folur me zë. Mezi dëgjohej, asnjëherë nuk ishte më shumë se një pëshpërimë. Herë të tjera, pritej që edhe ne të bënim të njëjtën gjë—përfshirë edhe mua. Si fëmijë që isha, pashmangshmërisht koka ime ngrihej lart dhe sytë e mi hapeshin. Për çfarë murmuriste gjithsecili? Pastaj e ndieja nga prapa dorën e mamasë time duke ma shtyrë kokën dhe e ulja kokën sërish.

Fëmijët në këto rrethana nuk bëjnë pyetje, sidomos nëse e ndiejnë se të rriturit kanë frikë se mos i dëgjon dikush dhe u kujtohet se do të vijnë burrat e këqij dhe do t'i vjedhin si me marifet fëmijët që dinë tepër. Por kur unë isha nëntë a dhjetë vjeç, pështjellimi im e nënshtroi momentalisht frikën dhe e pyeta mamanë përse duhej ta bëja këtë murmurimë. “Qielli të sheh gjithmonë”, - tha ajo qëllimisht, - “edhe kur ti vjedh një laps. Prandaj, kur bën gabim, rrëfeja atë qiellit. Po të mos e rrëfesh, ti do të ndëshkohesh. Dhe kur merr përpara ushqim për ta ngrënë, ti shpreh falënderimet e tua.”

Dhe kjo është mënyra sesi unë mësova të lutem. Në të vërtetë, unë kuptoja shumë pak lidhur me ç'do të thoshte e gjitha kjo, po cili fëmijë e kupton? E dija se ishte e rëndësishme. E dija se ishte e rrezikshme. Dhe e dija se në njëfarë mënyrë na lidhte ne me qiellin.

Shtëpia e gjyshërve të mi nuk ishte i vetmi vend ku takohej familja jonë për kohë të tilla. Jo larg prej shtëpisë sonë ishte një plazh i bukur, me një gji të vogël rëre dhe me pisha. Gjyshi shkonte atje për peshkim, dhe im atë, ime ëmë, dhe anëtarët e tjerë të familjes mblidheshim rreth tij për atë që e quanim “koha e pyetje-përgjigjeve.” Kjo ishte hera e parë fare, kur e dëgjova të

thuhej emri i Perëndisë: Hananim—fjala në gjuhën koreane që do të thotë “i vetmi Perëndi.” Është fjala që të krishterët e Koresë së Jugut e përdorin gjithmonë për Perëndinë, por ajo nuk dëgjohej pothuajse asnjëherë në Korenë e Veriut. Kur koreanoveriorët flasin në mënyrë supersticioze për natyrën dhe forcat hyjnore, ata i referohen Perëndisë si Hanulnim—që do të thotë “Zoti i qiellit,” një term më i përgjithshëm për hyjinë. Edhe kur familja jonë mblidhej së bashku tek shtëpia e gjyshit çdo javë, kjo ishte fjala që përdorim—Hanulnim. Por atë ditë pranë plazhit, fjala doli nga goja e gjyshit tim si një shigjetë që e shpoi ajrin tejpertej. “Hananim!” Pyeta veten se mos vallë nuk e kisha dëgjuar mirë.

Kur ishte sëmurë gjyshi, takimet javore i drejtonte gjyshja. Ai vdiq gjashtë muaj përpara saj; me jetët e tyre të jashtëzakonshme që u mbyllën të dyja jashtëzakonisht në mënyrë paqësore, gjatë kësaj stine të besimit të brendshëm. Asnjëri prej tyre nuk u sëmur, as nuk u matufos nga pleqëria, as nuk vuajti nga demenca. Që të dy vdiqën paqësisht në gjumë.

“Më misteriozë se fantazmat”—kështu i thoshin prindërit e mi njëri-tjetrit për gjyshërit e mi. Ai ishte një përshkrim i kuptueshëm—ishin historitë e së shkuarës së tyre, natyrisht, dhe ecja e gjyshit tim me Perëndinë dhe të folurit rregullisht me të, madje edhe gjatë asaj stine të fundit të jetës në Korenë e Veriut. Por gjyshërit e mi ishin më shumë se misteriozë. Unë gjithmonë do t'i kujtoj ata si njerëz të butë, të sjellshëm e të respektueshëm. Edhe kur isha fëmijë, unë mahnitesha prej karakterit të tyre.

Isha njëmbëdhjetë vjeç kur ata vdiqën. Shumë pak kohë pasi vdiqën ata, erdhën njerëzit e këqij dhe ne u bëmë fantazma misterioze për vete.

Koreja e Veriut gjithmonë ka qenë krenare për pastërtinë e saj etnike dhe racore. Si rezultat i kësaj, edhe imigrantët koreanë që vijnë në Korenë e Veriut nga vende të tilla si Kina—njerëz si ata të familjes sime që ishin larguar prej Koresë gjatë kohës së pushtimit japonez—kurrë nuk patën ndonjë mundësi brenda Koresë së Veriut.

Edhe përpara kohës së urisë masive, imigrantëve u referoheshin në publik si “njerëz të këqij” dhe përjashtoheshin gjerësisht prej përkujdesjes publike e trajtimit me njerëzillëk. Qeveria e Koresë së Veriut nuk na dha kurrë neve shumë punë ose tokë, dhe ata i monitoronin nga afër lëvizjet tona. Mua gjithnjë më thërrisnin “fëmijë pis” në shkollë. Ne trajtoheshim shumë më keq se ata që kishin jetuar tërë jetën e tyre përbrenda kufijve të vendit. Jetonim nën kërcënim të përditshëm—dhe pikërisht këtë donte qeveria.

Për herë të parë e ndjeva tmerrin e ftohtë, e të pastër kur isha nxënës në klasën e katërt fillore, shumë shpejt pasi ndërruan jetë gjyshërit e mi. Një natë, afër orës një ose dy të natës, një grua—një ish-shoqe shkolle e mamasë sime në Kinë—na erdhi papritmas për vizitë. Ajo që ishte edhe më e çuditshme ishte se kur mbërriti në apartamentin tonë, ajo ishte veshur vetëm me të brendshme. Ajo tha se ishte sulmuar nga vjedhësit, që i kishin grabitur gjithçka, përfshirë edhe veshjet dhe paratë. Mamasë sime i erdhi keq për të, e futi brenda në shtëpi, i dha për të ngrënë një vakt, dhe e lejoi të flinte me ne atë natë.

Megjithatë, mikpritja mund të jetë një gabim vdekjeprurës në Korenë e Veriut nëse ia hapni shtëpinë tuaj dikujt që shteti e konsideron si të padëshirueshëm. Mëngjesin tjetër përpara agimit—nga ora pesë ose gjashtë—ne u zgjuam nga zhurma e qenve që lehnin. Kjo gjë ishte e çuditshme, mendova në gjendjen time gjysmë të zgjuar, ngaqë ne jetonim në qytet—nuk ishte zonë bujqësore, nuk kishte qen. Pastaj pjesa tjetër e gjumit u shkatërrua nga goditjet me çekan në derën e shtëpisë sonë, disa çaste përpara se të shkelmohej. Agjentët e Departamentit të Sigurisë së Shtetit u dyndën në atë pak vend që kishim. Zhurmat e qenve të tyre dhe të këpucëve të rënda dhe pamja e armëve të tyre në gjendje gatishmërie më hodhën si me katapultë përgjithmonë jashtë atij iluzionit të vogël të sigurisë që marrëzisht e kisha marrë të mirëqenë deri në atë pikë në jetën time të re. Me të vërtetë që edhe tani më mbushet trupi me mornica kur mendoj për ato gjëra.

Mamaja dhe babai kërcyen nga shtrati e u futën në dhomën kryesore të apartamentit tonë me dy dhoma gjumi, ndërsa unë dhe motrat e vëllezërit e tjerë qëndruam zgjuar e pa lëvizur në dhomën e gjumit që e ndanim mes nesh. Gruaja misterioze që sapo ishte bërë mikeshja jonë instinktivisht u turr për tek hapësira që kishim tek muri i brendshëm i dhomës së gjumit, tek e cila vendosnim batanijet çdo mëngjes.

Nuk duhet shumë kohë që një grup agjentësh të SHKS (Shërbimi Kombëtar i Sigurisë) ta kthejnë përmbys një apartament të vogël. Ata e gjetën dhe e kapën vizitoren tonë për pak sekonda. Ata nuk na bënë as edhe një pyetje të vetme—thjesht u kthyen kah babait tim për fare pak kohë, sa ta urdhëronin që të shkonte tek rajoni i policisë më vonë në mëngjes, teksa ata marshuan përjashta shtëpisë me gruan dhe qentë e tyre, me armët dhe këpucët e rënda.

Kur babai im mbërriti tek rajoni i policisë fill pas kësaj, ata e qortuan atë me zemërim se është detyra e çdo qytetari ta regjistrojë secilin mik te autoritetet, përpara se ta lejojë të futet në shtëpinë e tyre. Ishte në rrezik siguria e fshatit dhe e kombit! Ata donin ta dinin përse im atë e kishte fshehur atë grua. Natyrisht që ai nuk kishte fshehur askënd—ai vetëm sa e kishte lejuar mamanë time ta ndihmonte këtë endacake për të veshur diçka që të mbulonte trupin, pasi e kishin grabitur. Pa pritur që ai të përgjigjej, ata e pyetën nëse grua ja i kishte dhënë familjes sonë një orë dore.

Në ato kohë, orët e dorës ishin të çmuara si floriri. Sa orë dore na kishte dhënë ajo, i bënë presion ata, dhe sa opium? Ata nuk pushonin kurrë, që ta linin atë të përgjigjej. Po çfarë mund të thoshte ai? Ai nuk dinte asgjë për atë grua, me përjashtim të faktit se ajo ishte një shoqe e vjetër shkolle e mamasë sime, me të cilën mamaja ime u takua rastësisht tek tregu përpara tre muajsh—thjesht një takim i rastësishëm gjatë të cilit të dyja gratë e kuptuan se ato njiheshin me njëra-tjetrën që nga Kina. Ato kishin shkëmbyer shprehjet e mirësjelljes dhe mamaja ime i kishte tregu-

ar asaj ku jetonim, nëse ndonjëherë ish-shoqja e saj e vjetër prej viteve të shkollës do të gjente rastin për ta vizituar. Dhe ç'vizitë na bëri, duke na ardhur pa paralajmërim tek dera e shtëpisë në mes të natës, vetëm me të brendshme, duke mos qenë në gjendje të na tregonte ç'e mirë e kishte sjellë atje, e jo më të na ofronte një orë dore ose ca opium.

Ata ulërinin: - A kishte ajo një certifikatë të regjistrimit të qytetarëve? A e kishim ne një certifikatë të tillë? Që ta mikprisje dikë prej një qyteti ose fshati tjetër në Korenë e Veriut, secila palë duhej të dorëzonte një kërkesë për vizitë. Po të mos plotësohej përpara kohe gjithë dokumentacioni nga të dyja palët, për të gjithë kishte dënim më pas.

Çdo ditë, pesë ditët në vijim, prindërit e mi duhej të shkonin tek Departamenti i Sigurisë Shtetërore për t'u marrë në pyetje me të njëjtat pyetje secilën herë, të gjitha këto vetëm për shkak të gruas misterioze veshur vetëm me të brendshme. Agjentët këmbëngulnin se prindërit e mi po gënjenin. Dalëngadalë ne po arrinim të kup-tonim se gruaja ishte përfshirë në ndonjë lloj biznesi të opiumit dhe të shitjes së paligjshme të orëve të dorës; secili krim do të kishte qenë krim serioz, dhe kombinimi i të dy krimeve së bashku ishte shkatërrues—si për të, edhe për ne. Kjo ishte arsyeja që ata dërguan agjentët e Departamentit të Sigurisë Shtetërore për ta shkallmuar derën tonë: Gruaja ishte arratisur nga burgu, i kishte hedhur tutje rrobat e burgut dhe po përpiquej t'i hiqte qafe agjentët që po e ndiqnin këmba-këmbës. Ajo i drejtoi ata direkt e tek dera e prindërve të mi. Mendoj se edhe sikur prindërit e mi t'ia kishin mbyllur derën asaj e të mos e lejonin të futej në shtëpi, do të kishte qenë i njëjti fund; ne ishim imigrantë, në fund të fundit—”njerëz të këqij”—dhe njerëz të tillë shumë rrallë lihen të qetë në atë vend. Dhe kështu ndodhi që pas dhjetë ditësh, agjentët e Departamentit të Sigurisë Shtetërore erdhën sërish e trokitën në derën tonë, kësaj radhe me urdhrin që ne t'i ngarkonim plaçkat tona menjëherë për në kamionin e tyre dhe të largoheshim përgjithnjë nga shtëpia jonë.

Qeveria na shpërnguli në një fshat të largët bujqësor që ndodhej lart në male, dy orë larg përmes një rruge të pashtuar. Për fat të keq, asnjëri nga ne nuk kishte kultivuar as edhe një copë toke fushore përpara. Në fund të fundit, në Kinë ne zotëronim tokë, por gjithmonë kishim jetuar në qytet. Ky fshat ishte si të ndodhej buzë ndonjë shkëmbi. Edhe agronomët ekspertë do të ziheshin ngushtë duke u përpjekur ta siguronin jetesën në atë tokë shterpë.

Atje kishte edhe familje të tjera që gjithashtu ishin dëbuar—ndoshta 5 përqind e popullsisë së atij vendbanimi të hapërdarë, mjaftueshëm të paktë në numër sa për t'u siguruar se izolimi dhe diskriminimi që kishim hasur më përpara tani do të intensifikohesh. Atje kishte një president të punëve, një drejtues grupi dhe një drejtor menaxhimi. Ata i trajtonin prindërit e mi tej mase keq: ne nuk ishim thjesht shkelës ligji, por shkelës ligji imigrantë—klasa më e ulët sociale prej të gjithave. Për secilën fushë, kishte afro pesëdhjetë njerëz prej pesë familjesh që ishin caktuar për të punuar atje. Ishte lloji i punës për të cilin kishte ndjesinë e keqe më të paimagjinueshme.

Ishte pikërisht atje, kur të stresuar prej ushqimit të pamjaftueshëm, i pashë prindërit e mi të ziheshin për herë të parë. Ju mund ta përfytyroni bashkëbisedimin. Babai im, i acaruar: “Pse duhej ta ndihmoje atë gruan, për të cilën nuk dije asnjë gjë? A nuk dyshove për asgjë kur erdhi vetëm me të brendshmet?” Mamaja ime, e vendosur: “Ishte një person i vuajtur që kishte nevojë për ndihmën time. Si mund të mos e ndihmosh një person në nevojë?” Kur unë isha i uritur, ju më dhatë diçka për të ngrënë... Kur isha i zhveshur, ju më veshët. Ishte një besim që i kishte kushtuar mamasë time—dhe gjithsecilit anëtar të familjes sime—gjithçka. Që nga çasti i mbërritjes sonë na brejti uria. Patjetër që nuk ndihmonte për të na qetësuar nervat ose për të na shëruar dhimbjet.

Oh, ato dhimbjet! Që nga dita e parë kur kamioni na zbriti tek ai vend i shkretë, unë u detyrova të shërbeja për të ndihmuar fshatin. Kishin nevojë tejet të madhe për punë, edhe sikur puna të vinte prej një djali thananik e të patrajnuar. Mua më kërkonin të

Këta janë brezat

bëja punë fushe, punë shtëpie, punë fshati dhe pak a shumë çdo lloj pune që drejtuesit imagjinonin se mund ta bënte një fëmijë i moshës sime. Unë u përpoqa sa munda të isha i mirë—dhe i heshtur—duke kujtuar gjithmonë se njerëzit e këqij mund të më merrnin prej atje e të më shpinin larg po të tregoja edhe detajin më të vogël për familjen tonë të pazakonshme.

Por askush nuk më bëri asnjëherë as edhe një pyetje—ata thjesht më jepnin urdhra me ashpërsi, nga njëra punë tek tjetra, orë pas ore mbytëse, ditë pas dite mbytëse. Atyre nuk iu deshën shumë orë ose ditë për të mësuar se unë nuk isha shumë i zoti në punë. Dhe as mua nuk m'u desh shumë për të mësuar përse që të gjithë, duke përfshirë edhe fëmijët më të vegjël, e përshkonin fshatin me shpatullat e përkulura dhe duke u ngërdheshur gjithë kohën: brenda pak ditësh, edhe unë dukeshja njëlloj si ata. Njëzet e katër orë në ditë shpinën ma përshkonte dhimbja, duke u përhapur kudo nëpër trupin tim deri tek gishtërinjtë e duarve e të këmbëve që ishin përgjakur e bërë plot kallo. Pavarësisht nga përpjekjet e mia më të mira, punëtorët e tjerë e vinin re vazhdimisht se unë nuk ndihmoja shumë.

Në atë fshat unë mbusha dymbëdhjetë vjeç. Ditëlindjen e kalova duke prerë dru zjarri dhe duke e mbartur barrën në kurriz për tek fshati përmes një buze të ngushtë shkëmbi të lëmuar, që ishte bërë shumë e pasigurt e që ndodhej mbi një faqe shkëmbore lart përmbi tokën plot kreshta që nuk të falte. Ishte pikërisht ajo ngushtësi që e bënte detyrën sidomos të përshtatshme për atë që drejtuesit duhet ta kishin konsideruar si një djalë dymbëdhjetë vjeçar shumë të pavlerë. Dëgjova fjalë sesi jo shumë kohë më parë, një njeri ose lopë, ose ndoshta të dy, ishin rrëzuar e kishin vdekur për shkak se kishin hedhur hapin e gabuar tek ajo buzë shkëmbore. Tani, mua më jepej detyra e përditshme që ta përshkoja atë rrugë të rrezikshme me një barrë drush zjarri mbi shpinë. Pothuajse çdo ditë isha në rrezik të vdisja.

U rrita pothuajse në çast. I pyesja prindërit përse ne duhej të vuanim si skllevërit. Mamaja ime tha: “Ne mund të bëhemi qenie

njerëzore pasi të kemi kaluar nëpër këto gjëra. Tani po vihemi në provë, por prapëseprapë duhet t'i jetojmë jetët tona me besim. Perëndia do të na e lehtësojë dhimbjen." Fjalët e saj ma prekën zemrën. Si mund ta dinte ajo—ose unë—se Perëndia po na përgatiste me hir për atë me të cilën do të përballej vite më vonë secili prej nesh, për krimin shumë më të rëndë të mbartjes së emrit të tij?

Edhe atëherë mamaja ime kurrë nuk hoqi dorë nga disiplinimi ynë. Pikërisht atje, përmes pëshpërimave të saj në atë fshat të ftohtë malor me terren të thyer e plot erë, unë mësova se ato dhjetë këshillat e gjyshit në realitet ishin Dhjetë Urdhërimet, e dhëna prej Hananimit, të vetmit Perëndi. Ajo na zgjonte natën për t'i mësuar urdhërimet e për t'u lutur me të.

Por gjithçka ishte shumë e kufizuar. Natyrisht, ne nuk mund të luteshim më përpara vakteve. Kur pyeta pse—me atë lloj marrëzie tipike për dymbëdhjetë vjeçarët—ajo shpjegoi me atë pëshpërimën e saj plot durim se besnikëria jonë duhej të ishte akoma më tepër e brendshme nga sa kishte qenë më parë për shkak të mbikëqyrjes edhe më të madhe prej autoriteteve nën të cilën ishim tani.

Ne u internuam në malësi në fund të verës. Sapo mbërritëm, drejtuesit e kooperativës na dhanë sasi të pakta orizi, që duhej të na zgjasnin derisa të vinte korrja. Gjithmonë formula e tyre ishte ta llogarisnin sa ishte sasia që ata mendonin se nevojitej për të mbijetuar, dhe pastaj të jepnin gjysmën e saj. Kjo ishte disiplina, ndëshkimi për t'i rikujtuar shkelësit e ligjit se ata nuk ishin të denjë për të jetuar dhe prandaj mezi duhet të mbijetonin.

Gjatë korrjes, të gjitha familjet i japin qeverisë gjithçka që kanë prodhuar. Pastaj qeveria llogarit numrin e ditëve që ka punuar gjithsecili dhe i jep secilit pjesën që i takon. Ne kishim qenë atje katër muaj, dhe ato gjysmëracionet që kishim pothuajse garantonin se nuk do t'ia dilnim dot mbanë ta mbyllnim dimrin. Pavarësisht nga administrimi shumë i kujdesshëm i nënës sime, neve na mbaruan rezervat shumë shpejt, gjë që ishte alarmuese. Teksa po na kërcënonte uria, nuk kishim asnjë zgjidhje tjetër përveçse të

shkonim derë më derë duke u kërkuar ndihmë fqinjëve tanë që nuk ishin shkelës të ligjit. Ne morëm vetëm neveritje. As edhe njëri prej tyre nuk na ofroi as ndihmën më të vogël. Në fund të fundit, ne ishim kriminelë imigrantë.

Kështu që një natë, unë u zgjova prej masazhit që po më bënte në shpinë mamaja ime e trishtuar. Ajo më kërkoi plot zymtësi që të shkoja të vidhja ca patate.

Unë u shtanga. “Mama, - kundërshtova unë, - ti na mësove që të mos vjedhim. Tani ti po më kërkon mua të shkel urdhërimin. Përse?”

Ajo më pa e menduar dhe pëshpëriti: “Sepse vetëvrasja është mëkat më i madh.”

Kështu që, mos u nxitoni të më dënoni, kur t’ju them se unë shkoja tek fushat me patate përpara agimit, për shumë ditë, kur frynte erë me forcë shumë të madhe dhe kur fusha ishte krejt e braktisur. Shumica e koreanoveriorëve nuk nisën të vuanin urie deri nga vitet 1990. Familja jonë gati sa nuk vdiq urie në vitin 1970.

Unë mësova të prisja dru zjarri e t’i mbartja në kurriz duke ngrënë vetëm disa copa të vogla patatesh të vjedhura. Kjo është mënyra sesi Perëndia ma zhvilloi vullnetin e fortë dhe shpirtin e paepur.

Padyshim që ne do të kishim vdekur nëse Perëndia nuk do t’i jepte tim eti dhuntinë e një intelekti të mprehtë. Ashtu si gjyshi im, ai fliste kinezçe, japonisht dhe koreanisht. Me vullnetin e fortë dhe një shpirt të paepur të vetin, ai vendosi që të na nxirrte nga situata ku ndodheshim. Kështu që, disi, mes përgjegjësive të pafundme e të përditshme të kultivimit të bimëve bujqësore, babai im nisi të studionte vetë. Ai merrte libra hua prej bibliotekës për të mësuar si punonin transformatorët elektrikë, si punonin motorët, si funksiononin pompat e ujit.

Në fermë, zona më e vogël ku u caktua familja ime quhej “Li” dhe njësia tjetër më e vogël pranë nesh ndodhej dymbëdhjetë kilometra larg, dhe quhej “Kun.” Kurdoherë që data mbaronte me numrin një, neve na jepej një ditë pushim për të udhëtuar për tek tregu në Kun, i vetmi vend ku gjendeshin furnizime. Pa para e pa mjet transporti,

datat një, njëmbëdhjetë e njëzetën të çdo muaji mund të na shërbenin thjesht për të na kujtuar vazhdimisht për mungesën e shpresës sonë. Por një ditë nga këto të tregut, pasi babai im i kishte lexuar të gjithë librat që mund të merrte hua, ai vendosi që të ecte dymbëdhjetë kilometra për në Kun. Në mendjen e tij ai e kishte planifikuar gjithçka. Ai e dinte se ky ishte shansi ynë i vetëm.

Në Kun, ai u prezantua tek dikush që ishte te bordi i menaxhimit të fermës. Ai deklaroi se dinte si t'i rregullonte motorët elektrikë dhe pompat e ujit, që gjithmonë ishin shumë problematike në Kun. Mekanikët ishin tejet të rrallë në ato ditë, dhe—nga që ata pothuajse asnjëherë nuk përfundonin në vendet aq të largëta sa Kuni—kur vinin ndonjëherë, ata trajtoheshin me përkujdesje e dashuri të veçantë.

Bordi ishte aq i dëshpëruar sa që vendosën ta shfrytëzonin rastin, kështu që i kërkuan babait tim të rregullonte një motor të prishur. Ai e rregulloi, krejtësisht prej hirit të Perëndisë. Ata nuk mund ta besonin dot se në Li ishte një person që kishte këtë talent të mrekullueshëm. Një njeri i tillë duhej të vinte në Kun! Dhe kjo ishte mënyra sesi ne lëvizëm nga Li për në Kun, rreth kohës kur unë u futa në shkollën e mesme. Ajo ishte një mrekulli, nga që lëvizjet në Korenë e Veriut gjithmonë nënkuptonin se kishe marrë miratimin nga të gjitha nivelet qeveritare—një arritje e madhe për kriminelët imigrantë.

Zyra e menaxhimit të krahinës e mbikëqyrte gjithë punën lidhur me makineritë e fermës, kështu që ata e caktuan babain tim atje si mekanik. Siç mund ta imagjinoni, në fillim ai ishte më shumë sesa pak në ankth, duke pasur për mësues vetëm librat. Por pasi rregulloi disa probleme të mëdha, ai u bë mekaniku kryesor në krahinë. Ai ishte shumë, shumë i zgjuar.

Teksa mundësitë po shtoheshin dhe dollapi ynë i ushqimeve nisi të rimbushesh, ai bëri diçka edhe më të shquar sesa riparimi i një motori. Ju do të mendonit se një burrë që shumë pak kohë më parë ishte çliruar nga lugina e hijes së vdekjes, po ashtu do të çlirohej

edhe nga tundimi për ta praktikuar besimin e ndaluar të familjes sime, e jo më ta ndante atë me të tjerët. Por kur miqtë e tij na erdhën për vizitë gjatë festave, babai im u tregoi atyre për Perëndinë.

Sa për shtetin (i cili natyrisht nuk dinte asgjë rreth veprimtarive ungjillëzuese të tij) babai im po reformohej me hir dhe po ngrihej në pozitë, pavarësisht dështimeve të tij të pafalshme. Por ndërsa unë rritesha e piqesha, nuk mund ta besoja dot se ai po detyrohej të vazhdonte të punonte në një nivel kaq të ulët. Në Kinë, ai kishte qenë ndihmës-dekani i një universiteti! Si të mos ngrihej ai në detyrë? Ishte e dukshme që ai ishte qindra herë më i zgjuar dhe më i kulturuar sesa eprorët e tij, dhe në atë kohë mekanikët konsideroheshin si klasa më e ulët e mosshkelësve të ligjit.

Kur u bëra pothuajse pesëmbëdhjetë ose gjashtëmbëdhjetë vjeç, e pyeta babain përse ai nuk ishte drejtues ose mësues. Ai u përgjigj: “Ngaqë unë nuk jam në gjendje të bëhem komunist. Pavarësisht sa shumë punon, po të mos jesh komunist, konsiderohesh i padobishëm. Ne erdhëm nga Kina, dhe atyre që kanë ardhur nga Japonia ose Kina, është thuar se pamundur t’u jepet mundësia të anëtarësohen në Partinë Komuniste. Madje edhe ata që drejtonin universitete atje, do t’i kalojnë jetët e tyre si bujq dhe mekanikë këtu. Sidomos ata si ne, që kemi anëtarë familjeje akoma në Kinë, gjithmonë janë të dyshuar si spiunë.” Por ai u përpoq të më inkurajonte duke më thënë se ndoshta brezi im do të kishte një mundësi më të mirë për t’u bërë drejtues.

Por, për çdo burrë në Korenë e Veriut, shtegu për të pasur jetën e një drejtuesi—vërtet, shtegu për kudo, përveçse në burg ose në varr—kalon përmes Ushtrisë Popullore të Koresë (UPK). Shumica prej nesh nuk kishte ndonjë zgjedhje, përveçse të futej në UPK pasi të mbaronte vitet e detyruara të arsimit, kur mbushte shtatëmbëdhjetë ose tetëmbëdhjetë vjeç. Pastaj, pasi të mbaronim shërbimin e detyruar ushtarak, do të ktheheshim në shtëpi ku na priste certifikata e diplomimit. Shumica e burrave shërbejnë për dhjetë vjet. Unë shërbeva për dhjetë vjet e pesë muaj për shkak

të disa rrethanave shumë të pazakonshme. Dhe kjo është mënyra sesi unë u bëra komunist.

Askush nuk paguhet në ushtri. Por pas dhjetë vjetësh në ushtri, ju mund—thjesht mund, me shumë punë, me lidhjet e duhura, dhe me pak ndërhyrje—të ftoheni për t'u anëtarësuar në Partinë Komuniste. Gjatë kohës që shërbeva unë, ushtarët trajtoheshin mjaft mirë. Unë shërbeva nga mesi i viteve 1970 deri në mesin e viteve 1980. Duke pasur parasysh vështirësitë që kisha përjetuar më parë në jetën time, koha që kalova në ushtri ishte krahasimisht e gëzueshme. Madje edhe kur babai na nxori prej fermës, kishte përsëri gjashtë fëmijë për të ushqyer. Dhe ndonëse unë isha fëmija i dytë, trajtoheshja si më i madhi, ngaqë vëllai im më i madh nuk ishte aq i zgjuar. Edhe atij iu desh të shkonte ushtar. Por shpresat e familjes sime vareshin në të vërtetë nga unë.

Kur isha në ushtri, unë kërkova çdo mundësi për të shkëlqyer, për të bërë pak më shumë, dhe për të fituar pak vëmendje. Në ato çaste të shkurtra që na jepnin kohë të lirë, ushtarët e tjerë shihnin sport për t'u argëtuar, kurse unë, duke kujtuar shembullin e babait tim, e përdorja çdo sekondë të kohës së lirë për të studiuar vetë me qëllim që të përparoja. Edhe pse gjithmonë kisha qenë një nga fëmijët më trupvegjël në shkollë, unë spikasja për aftësitë e mia në atletikë. Kështu që, kur u bëra ushtar, unë praktikojta volejbollin natën. E dija se si lojtar volejboli, unë mund të ngrihesha në detyrë nga toga te kompania, nga kompania te batalioni, nga batalioni te regjimenti—njëlloj si kur lëvizëm nga Li për në Kun. Duke pasqyruar përkushtimin e tim eti, unë fitova disa medalje argjendi e ari në konkurset sportive. Përveç volejbollit, unë vrapova në garën e vrapimit të shpejtë 100 metra (sprint) dhe mundesha në kategorinë e mundësve 68 kg. Unë isha edhe kampion në kërcimin së larti.

Kur isha nëntëmbëdhjetë vjeç, gjatë vitit të dytë në ushtri, pashë një reklamë ku kërkonin të rekrutonin njerëz për të mësuar si t'i binin fizarmonikës duke përdorur instrumentet që siguroheshin prej vetë Drejtuesit Suprem, Kim Il Sung. Gjatë audicionit, mendoj se u bëra

Këta janë brezat

përshtypje të gjithëve me intelektin dhe pasionin tim për të mësuar, por ajo përshtypje pozitive padyshim që avulloi kur u përpoqa plot vetëbesim t'i bija instrumentit duke e mbajtur kokëposhtë. Por pas tre muajsh, duke u njohur si nxënësi më i shpejtë mes pesëdhjetë kursantëve, mua më nxitën për të shërbyer si mësues i të tjerëve. Deri në kohën kur e përfundova shërbimin ushtarak, unë kisha trajnuar afërsisht treqind njerëz që të mund t'i binin fizarmonikës.

Gjatë asaj kohe, ushtarët që u binin instrumenteve muzikorë dhe që konkurronin në atletikë konsideroheshin specialë. Meqenëse unë mund t'i bëja që të dyja, kjo gjë hapi dyert për njohje të mëtejshme—si për shembull kur njësitë ushtarake konkurronin me njëra-tjetrën për çështje nderi. Anëtarit politik që ishte mbi mua ishte në bashkësinë komuniste, dhe komandanti i regjimentit përmbi mua ishte në komunitetin administrativ. Njërit i pëlqenin aftësitë e mia në atletikë, tjetrit i pëlqente muzika ime. Çdo vit për ditëlindjen e Kim Il Sungut, zhvilloheshin konkurse për këngët e ndryshme të besnikërisë. Një këngë tipike shkante kështu:

*Kur largohesh për të shkuar në ushtri, ti nuk ke
asnjë medalje / nder / dekoratë.*

*Kurse në kthim, ti bëhesh hero; do të përqafohesh
në gjoksin e dikujt!*

*Mamaja ime më shpuri tek depot e ushtrisë që
nga qyteti im, ku kisha lindur, isha rritur, dhe
kisha miqtë.*

*E dhashë të gjithë trupin tim për Drejtuesin
Suprem dhe për Komitetin Qendror Komunist!*

Fito një konkurs këngësh dhe sigurisht që do të të vënë re. Fito atë lloj konkurimi dhe merr një medalje për ushtrimet fizike? Kështu do të ishte legjendë.

Por për shkak të prejardhjes së familjes sime, unë duhej të isha shumë më tepër se një legjendë me qëllim që të bëhesha anëtar partie. Kështu që, jo vetëm që dola shumë mirë në konkurset e këngëve dhe shkëlqeva në garat e ushtrimeve fizike, por gjithashtu njëherë organizova një skuadër propagande shëndetësore që promovonte sa të këqija ishin pirja e duhanit dhe e alkoolit. Dhe përveç këtyre gjërave, unë drejtoja edhe aktivitetet politike.

Edhe komandanti i regjimentit, edhe anëtari politik, mrekulloheshin rregullisht me mua. Por përfundimi ishte ky: Për ata që kishin shërbyer në ushtri, nëse prindërit e tyre ishin komunistë, edhe ata do të ftoheshin të bëheshin komunistë gjithashtu. Kurse për fëmijët e atyre që nuk ishin anëtarë partie, dhe ishin nga familjet e deportuara të emigrantëve, do të kishte qenë më e lehtë të konsideronin marrjen e një bilete për në hënë. Unë vetëkënaqesha duke menduar se, nëse nuk mund të bëhesha anëtar partie pas dhjetë viteve të shërbimit të detyruar, prapëseprapë unë do të mund të isha në gjendje të jetoja një jetë të mirë, ashtu si im atë. Do të ishte një gjë më e mirë sesa të vidhja patate.

Njëherë mora guxim të mjaftueshëm sa t'i shkoja për vizitë administratorit, i cili e pëlqente muzikën time. Duke qenë një ushtar i zakonshëm, unë nuk mund të shkoja aq lehtë e pa problem në zyrën e një eprori të tillë dhe të nisja një bisedë për jetën time personale. Madje nuk ishte e lehtë që të arrije të takoheshe me dikë në atë nivel pa pasur arsye të fortë, ngaqë dallimi klasor mes nesh ishte i madh. Por me të kisha një marrëdhënie për shkak të disa misioneve që kisha kryer. Kështu që, mrekullisht, një ditë e gjeta veten të ulur përballë këtij burri kur më shpëtoi pa dashje nga goja: “A po i bëj të gjitha gjërat në rregull?”

Komisari turfulloi. “Si supozon se mund ta di unë?” - tha ai me mosbesim. “Do të më duhet të kontrolloj nëse dole mirë ose jo nëpër misionet e tua që ta di.” Do të kishte qenë krejt normale po ta kishte hedhur pas krahëve çështjen time, por ai u tregua mjaft i mirë sa të shihte në dosjen time. Dhe pasi kontrolloi, ai më

tregoi se kurrë nuk kishte qenë asnjë njeri që i kishte përmbushur misionet më mirë se unë. Kështu që unë shfrytëzova çastin për të provuar fatin tim, përtej kufizimeve që më jepte uniforma ime dhe statusi i familjes sime. “Ata që u futën në ushtri si unë, duhet të largohen”, - ia vura në dukje me aq pafajësi sa munda të mbledh. “Jam njëzet e tetë vjeç tani dhe shumë shpejt do të më dërgojnë në shtëpi. Kur të më lirojnë nga ushtria, nuk do të jetë askush tjetër këtu që i bie fizarmonikës. A nuk mendoni se duhet të trajnojmë dikë që të më zëvendësojë mua?”

Kjo e bëri atë të shqetësohej. Prandaj ai më pyeti: “E po mirë, pse nuk e zgjedh ti dikë?”

“Hëm...” - thashë unë i menduar. “Do të duhet ta trajnojmë një person të tillë për gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj. Por unë nuk kualifikohem të jem komunist.” Po kërkoja kompensim për atë që kisha bërë duke i shkuar shumë afër plotësimit të kushteve për të dalë përpara gjykatës ushtarake direkt aty.

Ai u mrekullua: “Unë mendova se ti ishe komunist! Nuk qenke akoma, kështu që le ta gjejmë mënyrën që të bëhesh.”

Kështu që përditë, unë e mbyllja punën rreth orës 10 të natës dhe pastaj bija si i vdekur në shtrat. Po pastaj, pas vetëm pesëmbëdhjetë minutash kërceja më këmbë që të bëja trajnimin e “kohës vullnetare të besnikërisë.” Një orë në natë ndihmoja që të ndërtohej një shtëpi. Atje kishte shumë drejtues ushtarakë që më vëzhgonin mua dhe të tjerët me të cilët unë konkurroja për vëmendje. Edhe ata ishin atje për të dhënë vullnetarisht kohën e tyre të besnikërisë, gjithsecili me arsyet e veta, njëlloj si unë. Veprimtaria—e gjitha vullnetare, e gjitha e kryer natën vonë pas përfundimit të detyrave të përditshme që të thyenin shpinën—i nxiste toga e batalione të tëra në nivele të çmendura të entuziazmit për vullnetarizëm. Unë e mblodha mendjen që të isha vullnetari më i zellshëm e më besnik nga të gjithë.

Në punën time të përditshme, kompania më caktonte mua tek njësia më e dobët—gjë që do të thoshte se unë kisha mundësinë

për të fituar famë duke e rindërtuar atë. Kështu që unë i trajnoja ushtarët duke u lidhur qeska rëre te këmbët. Pas gjashtë muajsh trajnimi, fuqia e tyre për të luftuar testohej sërish. Ata ishin të jashtëzakonshëm në çdo testim, përfshirë vrapimin dhe ushtrimet në paralele. Fjala doli vërdallë, dhe ata u filmuan si standardi që duhej të përqeshin ta arrinin të gjitha njësitë.

Një ditë, pashë një tullë të thyer tek shtretërit e luleve. Kështu që u kërkova atyre që jepnin mësim mbi aftësitë zbukuruese që të vinin e ta rregullonin, duke e mbushur me çimento dhe disa zbukurime. Kur erdhi për inspektim komisarari i njësisë, ai u habit tej mase prej mjedisit të rregullt e të bukur. Pse jo, edhe tullat nëpër shtretërit e luleve të ishin të patëmeta! Komisarët na pyetën të gjithëve cili ishte përgjegjësi për nxitjen e kësaj pune të madhe, por unë kërkova nga secili të më premtonin se do të heshtnin, me qëllim që të rritej kureshtja. Pastaj, gjashtë muaj më vonë, lëshova një informator që të raportonte mbi punët e mia të mira. Fëmijët e prindërve që nuk ishin anëtarë partie dhe vinin nga familje emigrantësh të deportuar kishin nevojë për sa më shumë raportime gojore që të mund të kishin ndonjë rast për t'u anëtarësuar në Partinë Komuniste.

Dy muaj më vonë, komisarari i regjimentit më tha se ai dëshironte të takohej me tim atë. Kështu që unë e kontaktova tim atë dhe e solla atë te komisarari. Im atë ishte më shumë se i kapur në befasi dhe ishte i merakosur që po e thërrisnin në një takim të tillë, por i thashë atij që të mos merakosej dhe thjesht të shkonte. Ai solli me vete alkool të bërë në shtëpi—dhuratë e madhe në ato kohë. Ai hyri në zyrën e komisararit i zbardhur në fytyrë si një fantazmë. Kur dera u hap pak më vonë, ai doli duke buzëqeshur vesh më vesh. “Dëgjova se ke dalë shumë mirë në ushtri”, - tha ai me një krenari të thellë e të dukshme—dhe me një ndjesi jo të vogël çlirimi.

Në fund të fundit, ai ishte arsyeja përse nuk kisha qenë në gjendje të anëtarësohesha në partinë komuniste në radhë të parë. Para shtetit, ai ishte një imigrant që dikur ishte dëbuar, i cili kishte ardhur në Korenë e Veriut nga Kina—një burrë me besnikëri të

dyshueshme, me fjalë të tjera. Më keq akoma, gjatë kontrolleve për prejardhjen time, kur po shqyrtohej aplikimi im për anëtarësim në parti, Departamenti i Sigurisë Shtetërore zbuloi se ai e kishte vizituar sërish Kinën. Në hetimin për tim atë kishte dalë edhe një histori për radiot e paligjshme: Pranë dyqanit të riparimeve, ku u caktua atëherë im atë, ishte dikush që riparonte radiot. Një ditë, ai gabimisht kapi një frekuencë dhe dëgjoi një program nga Koreja e Jugut, kur babai im ishte aty pranë. Në Korenë e Veriut, edhe ngjarjet më të vogla gjithmonë vihen re disi, diku, nga dikush. Dhe ato gjithmonë rishfaqen pikërisht atëherë kur nuk i do.

Natyrisht që komisar i duhej t'i sillte këto gjëra në vëmendjen e tim eti—një lëvizje e hirshme, e cila i jepte këtij burri një mundësi për t'i shpjeguar gjërat, që t'ia hapte disi rrugën të birit për të vazhduar të bënte gjëra edhe më të mëdha. Babai im i shpjegoi atij se të afërmit e tij jetonin në Kinë dhe natyrisht që ai shkoi atje për të parë, nëse mund t'i sillte ata këtu, në parajsën e punëtorëve. Dhe sa për radion, ai e kishte pasur mundësinë për ta dëgjuar programin nga Koreja e Jugut, vetëm për shkak të gabimit të teknikut të radios. Por ai nuk e kishte kuptuar mesazhin, shtoi nxitimthi ai, dhe as që kishte interes për të gjithësesi.

Komisari i regjimentit i hodhi tutje të gjitha ato me një goditje të lehtë mbi dokumentat. “Sapo ta mbledh mendjen”, - e siguroi ai tim atë, - “unë mund ta lë djalin tënd të anëtarësohet në partinë komuniste kur të dua unë.” Babai im padyshim që u çlirua kur mësoi se unë nuk do të duhej të vuaja ashtu si ai.

Shumë shpejt pas atij takimi, komandanti i kompanisë më thirri e më tha: “Ej, do të të kërkojnë të bëhesh drejtues i menaxhimit.” Kur një ushtar nuk ka asnjë shirit tek spaletat, do të thotë se ai është ushtar i thjeshtë. Tëtarët marrin një shirit, rreshterët e personelit marrin dy, rreshterët e klasit të parë marrin tre, rreshterët mjeshtra marrin një shirit të trashë, dhe drejtuesit e menaxhimit marrin dy shirita të trashë. Drejtuesi i menaxhimit është niveli më i lartë që mund të arrijë dikush përpara se të bëhet oficer.

Unë nuk e pranova komplimentin. “Mua nuk më lejohet të anëtarësohem në partinë komuniste”, - i thashë rastësisht.

“Kjo nuk duhet të përbëjë ndonjë problem”, - tha ai po aq rastësisht. Nuk duhet të ishte problem?

Dhe kështu unë u ngrita në detyrë në rangun e drejtuesit të menaxhimit. U preka kaq shumë nga pamundësia e gjithçkaje sa që qava.

Më thanë se të gjithë kishin rënë dakord që unë të anëtarësohesha në parti. Kur bashkohesh me partinë, ke nevojë për garantor. Nëse komandanti i kompanisë dhe oficerët duan të dalin garant për ty, është nderi më i madh që mund të bëhet. Në atë kohë, vetë komisari i regjimentit doli garant për mua. Kurdoherë që të tjerët futeshin në parti, ata kishin kundërshtarë, kurse unë nuk pata. As edhe një person i vetëm nuk e kundërshtoi futjen time në partinë komuniste.

Si drejtues i menaxhimit unë kisha nën komandë 120 ushtarë. Kalova edhe gjashtë muaj të tjerë në ushtri, trajnova një person që të më zëvendësonte për të luajtur në fizarmonikë, dhe pastaj mora emërimin zyrtar ushtarak në një universitet.

E po, pothuajse e mora. Universiteti Ekonomik Uonsan (Wonsan University of Economics) ishte universiteti më i mirë ku shkonin elitat, dhe ushtria do të më dërgonte pikërisht mua atje. Po pastaj, sërish dikush zbuloi prejardhjen e familjes time, dhe në vend të atij universiteti mua më dërguan në një kolegji inxhinierie. Në Korenë e Veriut disa gjëra të ndjekin nga pas përgjithmonë.

Prapëseprapë, çfarë gjëje mund të ishte më e mirë se të isha në gjendje të përfundoja me nderim shërbimin e detyruar ushtarak, të anëtarësohesha në partinë komuniste, dhe të jetoja në të njëjtën shtëpi me prindërit e mi të dashur, ndërkohë që shkoja në kolegji? Por po vinte edhe një surprizë tjetër e këndshme.

Kur e nisa kolegjin, isha tashmë tridhjetë vjeç. Kësisoj, isha duke studiuar me vajza shumë të reja në moshë—në shumicën e rasteve me tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë vjeçare—ngaqë shumë pak

vajza shkonin në ushtri. Prandaj unë nuk kisha interes për asnjërën prej shoqeve të mia të klasës. Por shumica e profesorëve ishin gra—me moshën njëzet e pesë vjeç a diçka e tillë—dhe ato ishin shumë të interesuara për burrat që e kishin përfunduar shërbimin e detyruar ushtarak. Kolegji gjithashtu përdorej si një vend për trajnimin e mësuesve. Dhe kjo është mënyra sesi e takova Znj. Bae.

Ajo vinte në kolegji për këto ngjarjet e trajnimit të mësuesve. Natyrisht, asnjëherë një grua nuk do t'i fliste një burri para se ai t'i fliste asaj. Prandaj tre herët e para kur kaluam pranë njëri-tjetrit në korridor, ne thjesht u pamë në sy. Ajo kishte për të bërë gjërat e veta në kolegji, kurse unë kisha mësimet e mia.

Por pastaj, sa herë kalonim pranë njëri-tjetrit, unë nisa ta pyesja: Ku jeton ti? Sa vjeç je? Unë doja të avancoja më tej, kështu që kisha nevojë për një justifikim që të ndërtoja një marrëdhënie. Për fat të mirë, kërkesat e diplomimit ma siguruan justifikimin. Që të diplomoheshe, duhej të dorëzoje shumë punime kërkimore. Duhej të shkruaje një artikull për strategjinë e luftës së Kim Il Sungut, dhe duhej të shkruaje artikuj të tjerë të zgjeruar mbi secilin prej tetëdhjetë citimeve të tij—çfarë nënkuptonin ato, si të flisnin ato ty, dhe si do të përpiqeshe gjithë jetën tënde për ta ndjekur atë. Duhej të kishe shkrim dore fantastik dhe të jepje përgjigje plotësisht të sakta. Pastaj duhej të shkruaje artikuj të tjerë për ato njëqind citatet e Kim Jong Ilit. Pastaj, mbi këtë punë, duhej të bëje një testim—një provim të përgjithshëm për të gjitha gjërat lidhur me Kimin. Dhe duhej të shkruaje një punim diplome.

Kështu që unë e kisha një justifikim të gatshëm për të shkuar më thellë. Nuk e dija nëse ajo shkruante mirë, por e dija se unë kisha nevojë për ndihmë. Kështu që e pyeta dhe ajo më tha “Po”. Kur një vajzë beqare nga Koreja e Veriut nis të njihet me një burrë beqar nga Koreja e Veriut, ajo gjithmonë pyet nëse burri është anëtar partie dhe nëse e ka mbaruar shërbimin ushtarak. Një burrë që nuk e ka përfunduar shërbimin ushtarak duhet të ketë pasur probleme të rënda me shëndetin. Një burrë që e ka përfunduar

shërbimin ushtarak si anëtar i partisë komuniste ka prejardhje të mirë familjare dhe nuk ka pasur asnjë problem me vjedhjen ose me femrat. Po një burrë që e kishte përfunduar shërbimin e tij ushtarak, ishte bërë anëtar partie dhe ishte futur në kolegji? Vetëm burrat e rrallë dërgoheshin në kolegji— shumica e burrave dërgoheshin për të punuar nëpër miniera ose në fabrika, edhe sikur të ishin anëtarë të partisë komuniste. Kështu që një burrë kolegji si ky ishte me të vërtetë i kërkuar—burri i duhur të cilit duhej t'i thoje “Po” kur ai të të kërkonte ndihmë me detyrat e tij të diplomimit.

Ajo nuk ishte gruaja e parë që kisha takuar. Në fakt, unë i kisha thënë “Jo” pesëdhjetë e shtatë grave që më ishin rekomanduar përgjatë tre viteve. Shumica e burrave që e përfundojnë shërbimin ushtarak martohen brenda një viti, kurse unë jo. Pasi kisha punuar shumë për një kohë aq të gjatë që ta përmbysja për mirë fatin e familjes sonë, unë nuk mund të rrezikoja të kisha martesë të keqe. Dhe kishte diçka ndryshe te kjo grua.

Ajo ra dakord që të më ndihmonte me punimet e diplomimit, dhe unë i dhashë asaj një muaj afat për të m'i përfunduar detyrat. Por ajo më dërgoi një letër pas dy javësh ku më njoftonte se punimet e mia ishin përfunduar. Unë bëra përgatitjet e duhura për ta vizituar atë në shtëpinë e saj që t'i merrja punimet. Hëngrëm drekë bashkë me prindërit e saj, dhe më pas i shqyrtova punimet. Ma hoqi trurin fare. Ajo ishte një shkrimtare e shkëlqyer, dhe gjithçka në ato artikuj ishte pa të meta.

Fusha ime e studimit ishte inxhinieria. Që të diplomohesha, unë duhej të përfundoja edhe një detyrë inxhinierie. Unë mund të merresha me shifrat, planifikimin dhe vizatimet, por pjesa e shkrimit shkonte përtej aftësive të mia. Dhe natyrisht që unë doja të afrohesha me të dhe të ndërtoja marrëdhënien tonë. Kështu që i kërkoja të më ndihmonte me këtë detyrën shtesë, dhe ajo lehtësisht ra dakord. Edhe prindërit e saj më pëlqenin mua. Ajo tha se asaj i kishin prezantuar shumë djem, por asnjëri nuk ishte aq i mirë sa unë.

Këta janë brezat

Që ta përfundoja atë detyrën përfundimtare, unë shkova tek shtëpia e saj me dy dhoma. Prindërit e saj rrinin në njërën dhomë, kurse ne punonim me detyrën në dhomën tjetër. Ne kishim kohë vetëm në mbrëmje, pas punës dhe shkollës. Punuam bashkë tri ditë, deri në orën 1 ose 2 të mëngjesit. Kjo na dha kohë për të folur gjithashtu. Ajo më tregoi sesi shumë prej djemve që kishin pasur interes për të ishin përpjekur ta kapnin përdore, por ajo kishte vënë re se unë nuk e kisha bërë një gjë të tillë. Unë isha i përqendruar vetëm tek detyra. Ajo tha se kjo gjë e kishte bindur atë se unë kisha karakter të mirë.

Atë ditë të tretë, pasi kishim përfunduar detyrën, nuk kishte më justifikim që të takoheshim. Kështu që e pyeta nëse ajo kishte ndonjërin në mendje për t'u martuar me të. Ishte hera e parë që e hapa atë temë troç fare. Ajo tha se nuk kishte ndonjë në mendje. Kështu që e pyeta nëse asaj i kishin prezantuar prindërit ndonjërin dhe ajo më tha se nuk i kishin prezantuar asnjërin për të cilin ajo kishte interes. Ajo më bëri mua të njëjtat pyetje. Unë i thashë “Jo”.

Dhe pastaj i propozova menjëherë. “Unë vërtet dua të mendoj për martesë me ty.”

“Nuk jam kundër”, - tha ajo.

Secili prej nesh foli me prindërit dhe vendimi u mor. Unë e takova atë në shkurt—muajin e diplomimit—dhe ne u martuam në maj, tre muaj më pas.

Në atë kohë, të gjithë studentët që diplomoheshin nga kolegji ose universiteti dërgoheshin menjëherë në projektet më të rëndësishme që kishte ndërmarrë kombi—stacionet e energjisë atomike, uzinat e prodhimit të plehërave kimike, ose fabrikat e llojeve të ndryshme. Gazetat dhe raportet televizive i trumbetonin sukseset e secilit projekt, por ata prej nesh që punonim atje i dinim gjërat më mirë. Unë u caktova në një projekt fabrike për tetë vjet. Problemet që pashë atje pasqyronin problemet me të cilat përballej i tërë kombi ynë. Drejtuesi Suprem vdiq. Bashkimi Sovjetik u

shpërbë. Ishte sikur vullneti i vendit—pa përmendur elektricitetin, ushqimin dhe shenjat e fundit të dhembshurisë së tij—u përthith krejtësisht jashtë kufijve të tij.

Kur e përfundova projektin e fabrikës, unë gjeta një punë në qytetin tim të lindjes në mes të viteve 1990. Gjatë asaj kohe, e tërë shpërndarja kishte ndalur krejtësisht. Kjo do të thoshte se megjithëse punoje, nuk paguheshe. Hija e errët e zisë së bukës po shtrohej pothuajse në çdo qytet, fshat dhe familje. Shumë herë kaloja pranë apartamentit ku kishim jetuar deri kur na dëbuan në fshat. Tani, uria na kishte ndjekur sërish deri te ky vend. Një ditë, fëmija i një fqinji vdiq. Mbrëmjen tjetër, ishte fqinja që kishim prapa shtëpisë—një grua plakë, e cila ishte rrëzuar e pajetë, duke vdekur urie në shtëpinë e saj. Është gjë shumë e zymtë ta shohësh një të vdekur. Nuk e kisha hasur atë më parë në tërë jetën time, madje as kur isha në ushtri. Kurse tani kudo kishte trupa të vdekurish—absolutisht kudo. Trupa të vdekurish në rrugë. Trupa të vdekurish në shtëpitë dhe apartamentet kudo përreth nesh. Trupa të vdekurish të mbledhur kapticë te stacioni i trenit. Njëherë shkova tek stacioni që të merrja një tren. M'u desh të prisja atje pothuajse një orë. Tetëdhjetë fëmijë jetimë ishin mbledhur kruspull së bashku për t'u ngrohur. Shtatë prej tyre ishin të vdekur. Fëmijë të tillë ne i quajmë “kotjebi”—dallëndyshe pa vlerë. Zogj të ngordhur. Fëmijë, prindërit e të cilëve kishin vdekur dhe që nuk kishin ku të shkonin tjetër, ngaqë askush nuk do t'u jepte atyre asgjë. Askush nuk mund t'u jepte atyre as edhe një gjë. Askush nuk kishte asgjë për të dhënë. Nuk kisha si ta harroja urinë që përjetova kur isha djalë i vogël, teksa e shihja kujdestarin e stacionit t'i përzinte fëmijët që ishin gjallë, që ai të mund t'i hidhte tutje trupat e të vdekurve. Dallëndyshet e pavlera.

Në atë kohë mora një vendim: Unë duhej të punoja në një punë jashtë sektorit të prodhimit dhe ndërtimit. Po të punoje në sektorin e prodhimit dhe të ndërtimit, katandiseshe i vdekur. Nuk kishte para për të paguar punëtorët në ato profesione, dhe mospasja e

Këta janë brezat

parave do të thoshte mospasje ushqimi, gjë që do të thoshte uri. Fatmirësisht, arsimimi im dhe anëtarësimi në parti më ofruan disa opsione.

Që nga viti 1980 vazhdon një fushatë për të fituar valutë të huaj e për ta sjellë atë brenda vendit. Natyrisht që njerëzit e bënin këtë gjë gjithë kohën në tregun e zi. Kurse njerëzit e rangut më të lartë mund të caktoheshin me detyrë nga qeveria për të fituar ligjërisht valutë të huaj. Dhe në kohën e zisë së bukës, kjo ishte e vetmja valutë që duhej. Dhe kjo është mënyra sesi hyra unë në botën e tregtisë ndërkombëtare.

Natyrisht, “tregti ndërkombëtare” në Korenë e Veriut kryesisht do të thotë të bësh biznes me Kinën—duke shitur lloje të ndryshme të perimeve dhe xeherorë mineralesh nga Koreja e Veriut. Koreja e Veriut është vend malor, dhe është pothuajse e pamundur që të mbjellësh bimë majë maleve—siç e kisha mësuar plot dhimbje në fëmijërinë time—por nëntoka është e pasur me burime minerare. Këto nxirren në sipërfaqe prej të gjithë ushtarëve që dërgohen nëpër miniera kur e përfundojnë shërbimin e tyre ushtarak. Dhe ato i shiten Kinës si xeherorë të papërpunuar, prej ushtarëve si puna ime, që ishin mjaft me fat për të qenë në gjendje të shkonin në kolegji. Të gjitha u shiten direkt siç dalin nga nëntoka Kinës dhe Ruisë e vendeve si ato, për shkak se nuk ka elektricitet dhe as mjeshtëri për t’i rafinuar mineralet në një shkallë më të lartë. Është një gjë e trishtueshme.

Ishte një çështje e trishtueshme e një lloji tjetër, gjithsesi, ajo që më në fund ra mbi familjen tonë, e cila në atë kohë ishte rritur duke përfshirë dy fëmijët tanë. Përmes pozicionit tim në parti dhe arsimit e punës sime në tregtinë ndërkombëtare, ne mundëm ta mënjanonim zinë e bukës. Por përmes të gjitha ndryshimeve në jetën time, ishte një gjë që e kisha trashëguar prej gjyshërve dhe prindërve të mi, të cilën nuk mund ta lija kurrë pas: xeherorin e parafinuar e të veçantë të familjes sonë, të cilin edhe atëherë unë pata pak aftësi ta rafinoja.

Unë dija pak gjëra për atë besim misterioz të gjyshit tim, dhe dija akoma më pak për atë Perëndi misterioz të tijin, i cili e kishte thirrur atë me emër në kohët e vështirësive të popullit të tij. Por kur miku im më i mirë, i cili po kalonte vështirësi në martesën e tij, na pyeti mua dhe gruan time sesi ia dilnim që të kishim një jetë të lumtur, nuk mund të mos i tregoja të vërtetën atij. “Janë Dhjetë Urdhërimet”, - i thashë atij. “Dhe qielli shikon gjithnjë. Kur i shkel ato, i kërkon falje qiellit. Dhe kur merr ushqim, falënderon.”

Siç dukej nuk mjaftonin për ta riparuar problemin në martesën e tij. Përgjithësisht nuk është e ligjshme të divorcohesh në Korenë e Veriut, dhe procesi është shumë i vështirë. Ti duhet të japësh provat se personi prej të cilit kërkon të divorcohesh është një person shumë i keq. Nëse personi i keq është dikush që njihet se qëndron kundër ideologjisë komuniste—epo, një shoqëri duhet të ketë përparësi, ju e dini këtë.

Dhe kështu unë përfundova në burg për mbartjen e emrit të Perëndisë. Ishte e çuditshme që gjithçka ndodhi kaq afër vendit ku SHKS na kishte bastisur shumë vjet përpara. Dhe në shumë mënyra, i tërë procesi i hetimit nuk ishte shumë i ndryshëm nga sa kujtoja prej përjetimit që pata në fëmijërinë time—vetëm se kësaj here nuk do të kishte kthim në shtëpi në fund të marrjes së përditshme në pyetje. Ishte e qartë që nga fillimi se unë nuk do të kthehesha kurrë më në shtëpi.

Ata që ishin afër meje gjithashtu u thirrën për t’u marrë në pyetje. Disa prej tyre gënjyen për mua, duke u thënë agjentëve të Departamentit të Sigurisë së Shtetit ato gjëra që ata donin ose duhej t’i dëgjonin. Po kush mund t’i fajësonte ata? Kujt i duheshin problemet me shtetin?

Megjithatë, krimi im ishte shumë më i keq sesa shitja e orëve të paligjshme të dorës ose trafikimi i opiumit. Unë e kisha korrup-tuar mikun tim përmes “besëtytnive” të mia fetare, gjë që ishte më i keqi i krimeve politike. Si tregtar ndërkombëtar, unë isha i

dyshuar i veçantë—jo vetëm që duhet të kisha futur në xhep para që me të drejtë i përkisnin shtetit, por gjithashtu duhet t'ia kisha gërryer themelet shtetit me kriticizmin tim.

Ungjillëzim. Përvetësim. Tradhti. Kjo ishte një trio akuzash që kishte vetëm një përfundim: vdekje me ekzekutim. Ajo që pasoi ishte, me aq sa kam qenë në gjendje të përmbledh prej atyre rreth meje në atë kohë dhe prej atyre dezertorëve koreanoveriorë me të cilët kam mundur të flas që prej asaj kohe, diçka e paprecendent në historinë juridike të Koresë së Veriut: të kaloja më shumë se një vit në kushtet më të vështira të burgut, pa u akuzuar zyrtarisht, ndërkohë që qeveria e hetonte rastin.

Në burg unë u trajtova si insekt. Secila ditë e atyre trembëdhjetë muajve ishte njësoj. Ngrihu në 5:00 të mëngjesit. Laj dyshemenë. Pastro. Shko në banjë. Hidh mbeturinat që janë në kova. Pastaj duhej të rrija këmbëkryq me duart mbi gjunjë për shtatëmbëdhjetë orët e tjera. Nuk më lejohej ta ktheja qafën ose të kërrusja shpinën. Çdo dy orë ne lejohej të urinonim. E vetmja herë tjetër që na lejohej të lëviznim ishte gjatë vakteve, që ishin saktësisht njëminutëshe. Në orën 10 të mbrëmjes, na lejohej të shkonim në shtrat, por kokat tona duhet të ishin kthyer në drejtimin e kundërt me hekurat e burgut. “Shtrat” nënkuptonte të rrije shtrirë në dyshemenë e drunjtë.

Kur të jesh ulur, nuk mund të lëvizësh, edhe sikur të të pickojë ndonjë mushkonjë. Edhe sikur të dridhesh, merr ndëshkim—poshtërime torturuese të ëndërruara prej rojeve. Në një ndëshkim, të duhej të rrije me gjunjët e përkulur, duke mbajtur një tas të mbushur plot me ujë mbi kokë për tridhjetë minuta. Po të derdhje qoftë edhe një pikë, do të të rrihnin me një shkop aq sa të bije pa ndjenja.

Për një ndëshkim tjetër, të duhej t'i zgjasje duart përtej hekurave të burgut, që roja në anën tjetër të t'i bënte copë pëllëmbët, duke i kthyer në shirita të përgjakur mishi me anë të një gozhde të mprehtë hekuri. Mund të të urdhëronin të rrije varur duke u

mbajtur në një shufër hekuri për gjysmë ore ose të zvarriteshe si insekt nëpër dyshemenë e drunjtë.

Megjithatë, shumicën e kohës, unë thjesht ndenja ulur, i palëvizur, për shtatëmbëdhjetë orë në ditë, për më shumë se një vit të jetës sime. Dhe gjatë asaj kohe unë mendova shumë për jetën time dhe për gjithçka që kisha përjetuar deri në atë pikë. Mendova sesi, gjatë shërbimit tim nën armë, unë e kisha varrosur dashurinë e Perëndisë në një dhomë të prapme në zemrën time dhe në vend të saj kisha marrë dashurinë e eprorëve të mi. Mendova sesi e kisha kërkuar anëtarësimin në Partinë Komuniste përmbi gjithçka tjetër në jetë, sesi isha kthyer në shtëpi plot krenari pasi e kisha realizuar atë. Mendova për vajtjen në kolegji dhe diplomimin, për gjetjen e një pune me rrogë të mirë edhe në mes të kohës së zisë së bukës, dhe si e kisha mbajtur familjen time të sigurt, për shkak të inteligjencës sime dhe të punës sime të shumtë, siç e mendoja në atë kohë, ndonëse kaq shumë të tjerë vdiqën nga uria. Mendova për të gjitha bisedat që kisha pasur me prindërit e mi në ato vite kur u ktheva nga ushtria, dhe sesi gjithçka që ata më kishin treguar kishte rënë në veshë të shurdhër. Mendova sesi e kisha harruar Perëndinë dhe nuk ia kisha dalë dot mbanë të mbështetësia tek ai. Mendova sesi isha mbështetur vetëm në shkëlqimin tim. Dhe kur ktheja kokën mbrapa, unë gjithashtu kujtoja të dielat në shtëpinë e gjyshit tim dhe sesionet e pyetje-përgjigjeve nën hijen e pishave përgjatë plazhit. Hananim!...

Dhe kjo është mënyra sesi unë u pendova për mangësitë e besimit tim, që nuk e kisha marrë plotësisht dhe nuk e kisha pasuar krejtësisht gjithçka që gjyshërit e prindërit e mi e kishin ruajtur si thesar më të vyer se anëtarësimi në parti, dhe e kishin vlerësuar më shumë se konkurset e këngës, më shumë se medaljet e atletikës, më shumë se vetë jetën.

Dhe kështu, i ulur atje orë pas ore, ditë pas dite, muaj pas muaji, teksa një vit i linte vendin vitit pasardhës, unë u pendova. Dhe

mbi të gjitha gjërat, përbrenda meje u rrit një frymë falënderimi. Unë u bëra falënderues ndaj Perëndisë për këtë kohë në burg—që ai më kishte arrestuar mua prej krenarisë sime dhe që më kishte tërhequr në një kohë reflektimi, murmuritjesh që mezi dëgjohehin, përpjekjesh për të kujtuar me anë të hirit të tij çdo himn që e kishim kënduar ndonjëherë, çdo mësim që ma kishte mësuar ndonjëherë gjyshi. Kjo ishte mënyra sesi unë arrita të mbështetem vetëm në Frymën e Shenjtë me anë të besimit.

“Sepse kushdo që kërkon, merr; ai që kërkon, gjen; dhe atij që troket, dera do t’i hapet”—vazhdova ta risillja ndërmend atë varg. Mamaja ime ma pëshpëriste atë varg në netët e shumta në fshatin e ftohtë malor, plot erë, e me terren të thyer gjatë mërgimit tonë, kur uria na mbërthente me dhimbjen e saj të mefshtë dhe shpresa gërryhej njëlloj si fusha që kultivonim.

Hananim!... E thirra emrin e tij në mendjen time mijëra herë, dhe pastaj sërish njëmijë mijëra herë të tjera.

Dhe Perëndia nuk më braktisi mua. Në fakt, krejt për habinë e të gjithëve, ai më shpëtoi. Zakonisht, autoritetet e dorëzonin vendimin e tyre brenda një muaji. Por, nëse krimi që kishe bërë ishte shumë i keq, mund të kalonin paraprakisht një deri në tre muaj përpara se të dërgoheshe në ndonjë kamp përqendrimi ose të ekzekutoheshe publikisht, me gojën të mbushur me gurë. Sapo përfundonte hetimi, po të të thërrisnin që të dilje përpara e të shkoje në shtëpi, kjo do të thoshte se do të vdisje. Ja ç’do të thoshte “shko në shtëpi.” Pothuajse asnjëri nuk u largua i gjallë nga burgu; nëntëdhjetenëntë përqind morën gjykimin dhe paguan dënimin.

Por pas më tepër se një viti, unë u lirova si i pafajshëm. Asnjëherë nuk u akuzova. Procesverbalet e mia të shkuara ishin shqyrtuar, llogaritë e mia ishin këqyrur me kujdes, bashkëpunëtorët e mi ishin marrë në pyetje. Dhe në fund asnjë armë e sajaur kundër meje nuk qe në gjendje të funksiononte. Një rast si imi nuk kishte ndodhur asnjëherë në historinë e departamentit. Tërë stafi ishte i

shtangur. Unë arrita të përjetoja punën e Perëndisë; diçka që fuqia njerëzore nuk mundet dot as ta kontrollojë, as ta kuptojë.

Pasi u lirova nga burgu, mua madje m'u dha mundësia t'i rikthehesha punës sime në tregtinë ndërkombëtare. Kisha plot pyetje lidhur me besimin për t'ia bërë mamasë sime, të cilat i kisha mbledhur gjatë sezonit të reflektimit e të pendesës në burg. E pyeta atë për shumë gjëra lidhur me Biblën, si të lutesha përpara ushqimit ashtu siç e kishte zakon gjyshi, dhe si të mblidheshim të dielave e ta mbanim ditën të shenjtë. Mamaja ime kishte për mua një fletushkë për besimtarët e rinj. Ajo kishte rrezikuar jetën e saj për ta sjellë atë prej Kinës, ku ajo kishte vizituar një kishë. Unë arrita të kisha një jetë besimi.

Kështu që, po të më pyesnit tani sesi mund të jesh një i krishterë e megjithatë të përulesh përpara statujave të Kim Il Sungut dhe Kim Jong Ilit, përgjigjja ime tani do të jetë: nuk mundesh, sapo jeta jote e besimit të zgjohet përbrenda teje. I studiova Dhjetë Urdhërimet qëllimisht, njërin pas tjetrit. Ndieja sesa shumë jetë koti kisha bërë deri tani në idhujtarinë time ndaj Kim Il Sungut dhe Kim Jong Ilit, një ushtar që u përulej statujave të tyre dhe që ua premtoje jetën portreteve të tyre dhe që qante përpara fotografive të tyre. Nuk mundesh ta bësh atë gjë.

Familja jonë nuk i dinte të gjitha vargjet e Biblës, por ne dinim mjaftueshëm për të mos marrë pjesë në ngjarjet idhujtare ku, në ditëlindjen e Kim Il Sungut, njerëzit shkonin tek statuja e tij dhe përuleshin e adhuronin. Dhe ne as nuk shkonim të votonim. Në vend të këtyre gjërave ne i ndiqnim të Dhjetë Urdhërimet, duke u dhënë ushqim fqinjëve tanë, që po kalonin kohë të vështira dhe vdisnin urie nëpër rrugë. Ne i respektonim prindërit tanë. Ne nuk gënjenim. Ne respektonim ditën e Zotit.

Por ju them se këto gjëra është e lehtë të thuhet, por jo të bëhen në Korenë e Veriut. Por unë mendoj se duhet të jetë kështu për çdo të krishterë, në çdo vend, në çdo jetë besimi, apo jo? Mos vidhni. Mos lakmoni. Mos gënjeni. Nderoni nënën dhe babain. Po

Këta janë brezat

t'i bënim këto gjëra me zemër, a ka ndonjë qytet në tokë—ose ndonjë apartament, apo ndonjë fermë në ndonjë fshat shkëmbor—ku ne do të ndiheshim me të vërtetë në shtëpi?

Në Korenë e Veriut, na u paraqit një zgjedhje e çuditshme: të kryenim idhujtari çdo çast që ishim zgjuar, apo të kryenim një vepër penale kapitale duke mos pranuar të kryenim idhujtari. A do ta vije atë stemën me figurën e Kim Il Sungut, të detyrueshme për t'u vënë nga çdo qytetar, apo do të vishje uniformën e kampit të përqendrimit? A do t'i dërgoje fëmijët në shkollë për të mësuar si ta adhuronin Kim Il Sungun apo do t'i nisje marsh për në kampin e përqendrimit? A do ta dërgoje djalin tënd në ushtri për t'ia dhënë gjithë trupin e tij adhurimit të Drejtuesit Suprem, apo do t'ia mbushje gojën me gurë përpara skuadrës së pushkatimit të ushtarëve? Nuk ishte ndryshe nga vendimi i mamasë sime për të zgjedhur mes vjedhjes e vetëvrasjes. Dhe unë tashmë isha dërguar në burg për besimin e vogël, e megjithatë isha liruar. Çfarë duhej të bëja unë tani që besimi im ishte në lulëzim të plotë?

Nganjëherë duhet të largohesh nga fshati e nga njerëzit e tu me qëllim që t'i shpëtosh ata; Perëndia i gjyshit tim ia kishte thënë atij dikur, kohë më parë. Dhe askush nuk do ta kuptojë teksa ti lë pas gjithçka që ke marrë dhe njohur e dashur, dhe e ndjek zërin e atij Perëndie misterioz dhe ecën ngadalë por me vendosmëri për të dalë jashtë qytetit.

KAPITULLI TRE

Nëna: Shitësja e bukës së jetës

Nga Z. Bae

Kur një koleg mësues i tha mamasë sime një ditë se, ndërkohë që ajo ishte duke dhënë mësim, kishte ardhur një burrë për ta takuar, mamasë sime nisi t'i rrihte zemra fort.

Për fat të mirë, kjo vizitë ishte shoqërore; nuk solli agjentë të sigurimit, qen që lehnin dhe dyer të shkallmuara. Ja, kështu e takoi mamaja ime babain tim.

Të dy prindërit e mi kishin lindur në familje të devotshme të krishtera në Kinë. Gjyshërit e mi nga mamaja shkonin në një kishë të ndryshme nga ajo ku shkonin gjyshërit e mi nga babai, por ata kishin të njëjtën vendosmëri—që fëmijët e tyre të martoheshin me të krishterë prej familjeve që ata i njihnin. Gjyshja ime nga mamaja ishte afruar me një nga anëtarët e kishës, djali i të cilit—babai im i ardhshëm—ishte mësues në shkollën ku vajza a saj—mamaja ime e ardhshme—jepte mësim gjithashtu. Edhe pse ishin në të njëjtën shkollë, prindërit e mi nuk e njihnin njëri-tjetrin përpara sesa familjet e tyre të nisnin të diskutonin mundësinë e martesës. Babai im as nuk e dinte sesi ishte nga pamja mamaja ime ose çfarë lënde jepte mësim atje. Ai as nuk e kishte parë fotografinë e saj. Por për fatin e tij të mirë ajo ishte shumë e bukur.

Kur mamaja ime doli që ta takonte babain tim për herë të parë, ajo shkoi me dy shoqet e saj. Babai im ishte shumë i gjatë, afro 1.8 metra, kurse mamaja ime ishte vetëm 1.5 metra e gjatë. Në

Këta janë brezat

fillim, mamasë sime nuk iu duk tërheqës, ngaqë ajo mendoi se ai ishte tepër i gjatë për të. Por ajo u tërhoq pas intelektit të tij dhe pas burrërisë. Kështu që ata ua thanë prindërve të tyre opinionin që kishin për njëri-tjetrin dhe më në fund u martuan.

Revolucioni Kulturor i shtyu prindërit e mi dhe shumicën e anëtarëve të familjes sime të largoheshin nga Kina për në Korenë e Veriut. Sa për prindërit e mi, ky revolucion i përzuri ata nga klasa e mësimit dhe i shpuri të punonin në një fabrikë gjërash të vogla për të ngrënë dhe karamelash në Korenë e Veriut. Në fund të fundit, ata ishin imigrantë, dhe imigrantëve nuk mund t'u besohej detyra e rëndësishme e mësimeve. Kështu që në vend të saj ata bënë gjëra të vogla për të ngrënë e karamele. Ngaqë mamaja ime ishte shumë tërheqëse, shpesh burrat tek puna i vardiseshin. Por mamaja ime as nuk ua hidhte sytë asnjërit prej tyre. Ajo i përkiste tim eti.

Vetëm kur u shpërngulën në shtëpinë e gjyshërve të mi në vitet e fundit të gjyshërve, prindërit e mi nisën ta jetonin besimin e tyre tek Perëndia. Ata filluan duke u lutur përpara vakteve dhe duke mbajtur ditën e Shabatit.

Unë shkoja bashkë me mamanë nëpër shumë vende. Një ditë mamaja ime e pyeti gjyshin tim nëse ai do të na shoqëronte për një shëtitje. Ajo nuk mund të fliste lirshëm në shtëpi nga frika se mos kishin vënë përgjues. Në atë kohë, në vitin 1970, qeveria kishte nisur fushatën e shfarosjes së të krishterëve, prandaj besimtarët ishin shumë të kujdesshëm për të marrë masat e duhura kundër pajisjeve të përgjimit.

Mamaja ime e pyeti gjyshin tim: “Baba, a e dëgjove ti me të vërtetë zërin e Perëndisë?” Kur ai i tha asaj “Po”, ajo ngulmoi t'i dinte të gjitha detajet. Ai tregoi sesi zëri i Perëndisë ishte sidomos i qartë për të kur ai agjëronte, lutej ose flinte. Mamaja ime i tha atij se ajo dëshironte ta dëgjonte Perëndinë ashtu siç e kishte dëgjuar ai. Ajo ishte e trishtuar që nuk mund ta dëgjonte Perëndinë, dhe pyeste veten sesa më i thellë ishte besimi i babait të saj krahasuar me të sajën.

Në atë kohë, ajo ishte në të tridhjetat dhe ishte bërë kureshtare për besimin e saj. Ajo e pyeste vazhdimisht atë për Arkën e Noeut, për Sodomën e Gomorrën, dhe për mënyrën sesi ishin krijuar njerëzit. Për shkak se nuk kishte fare Bibla në atë kohë në Korenë e Veriut, babai i saj u bë Bibla e saj e gjallë. Dhe ajo mësoi mirë. Pas vdekjes së tij, ajo m'i transmetoi mua ato histori të Biblës, krejtësisht të mësuara përmendësh. Ja sesi i mësuam ne Dhjetë Urdhërimet dhe disa himne.

Pasi vdiq gjyshi im dhe ne u dëbuam për të jetuar në krahinën bujqësore, ne nuk luteshim përpara vakteve. Ishte tepër e rrezikshme, Thoshte mamaja ime. Por ajo prapësepapë na mblidhte së bashku ne fëmijëve, shpesh gjatë natës, për të na dhënë mësim, njëlloj siç ia kishte dhënë asaj dhe motrave e vëllezërve të saj babai i tyre çdo javë—që ne duhet të jetojmë sipas Dhjetë Urdhërimeve dhe se ne duhet ta kujtojmë çfarë u ndodhi Sodomës e Gomorrës. Ajo na tregoi neve edhe historitë për Moisiun—sesi e ëma e vuri atë në një shportë dhe e futi mes kallamave përgjatë brigjeve të Nilit. Ishte mjaft argëtuese ta dëgjonim atë kur na i tregonte këto histori të vjetra, por qëllimi i saj nuk ishte kurrë argëtimi. Qëllimi ishte gjithnjë i njëjti, sidomos kur po kalonim përmes kohëve më të vështira: Perëndia na shikon kudo që jemi dhe ai vështron gjithçka që bëjmë. Ajo donte që ne ta mbanim mend këtë, dhe donte që ne të mos mëkatonim.

Ne kaluam një kohë të vështirë në fshatin bujqësor joprodhues. Kishte plot raste kur babai im e fajësonte mamanë time për rrethanat tona, ngaqë ajo e kishte ftuar atë kriminelen kineze në shtëpinë tonë. Por mamaja ime i thoshte: “Si mundemi ne, nga të gjithë njerëzit, t'i shpërfillim ata njerëz të gjorë që vijnë këtu prej Kinës? Si mundemi ne, si të krishterë, të jetojmë ashtu? Mund të jetë një test prej Perëndisë. Ne gjithnjë duhet ta jetojmë besimin tonë në çdo çast dhe të mos lejojmë kurrë që ai të lëkundet. Babai e pranoi atë që tha ajo, por atij nuk i pëlqeu ajo gjë.

Gjithsesi, ajo gjithnjë e jetoj besimin e saj. Ajo kishte dhembshuri për të uriturit dhe të varfrit, dhe i ndante ato pak gjëra që

zotëronte me ta. Ajo ishte gjithnjë e vëmendshme dhe bujare me njerëzit. Dhe gjatë atyre kohëve të vështira, ajo na inkurajoi të gjithëve ne—babain, mua dhe vëllezërit e motrat e tjerë.

Ndërkohë që babai nxehej lehtësisht dhe fillonte debatet kur ishte duke kaluar ndonjë vështirësi, mamaja nuk ndryshonte as edhe një çikë. Ajo e mposhti secilën vështirësi me një buzëqeshje. Ndonëse ishte e shkurtër nga trupi, ajo nuk i trembej asgjëje. “Pse duhet që t’i trembem ndonjë gjëje?” - pyeste ajo. “Perëndia është pranë meje, dhe ai do të hapë një rrugë për ne. Edhe në kohët e vështira, ai do t’i zgjidhë që të gjitha problemet tona. Po pse duhet të fokusohemi ne tek vështirësitë?” Kur ajo erdhi në Korenë e Veriut prej Kinës (gjë që ishte një krim—kontrabandë), ajo nuk kishte fare frikë. Ajo besonte vërtet se Perëndia do ta mbante atë të sigurt.

Mamaja ime gjithashtu kishte shumë urtësi. Ajo madje ishte një pioniere në biznes në Korenë e Veriut. Ajo nuk kishte fare trajnim në këtë fushë, por nevoja të bën mësues të mirë kur trajneri yt është Perëndia. Më lejoni të shpjegojem.

Kur ishim të dëbur në krahinë bujqësore, mamaja kujdesej për fëmijët kurse babai punonte në një fabrikë dhe në fermë. Ajo lindi edhe tre fëmijë të tjerë gjatë asaj kohe, dhe kur erdhi koha që të largoheshim nga krahina bujqësore, ne ishim bërë gjashtë fëmijë. Ngaqë babai ishte punëtor krahu, ne merrnim racione ushqimi nga qeveria, por—ngaqë ne ishim shkelës ligji imigrantë—asnjëherë nuk na jepnin aq sa na takonte të merrnim. Sasia jonë ishte 700 gramë në ditë, por neve gjithmonë na jepnin 550 gramë, më pak nga sa ishte e nevojshme për të mbajtur frymën gjallë. Pjesa tjetër mbahej nga qeveria, e cila kërkonte që çdo familje t’ia “dhuronte” një pjesë të racionit të saj të orizit, “fondit të luftës” së qeverisë.

Si rezultat i kësaj, mamaja bëri diçka që nuk ishte bërë asnjëherë më parë askund në Korenë e Veriut komuniste, me sa dimë ne të gjithë. Ajo u bë një tregtare e pavarur—bukëshitëse. Ajo nuk dinte asgjë për pjekjen e bukës ose për drejtimin e një biznesi.

Gjithçka që dinte ajo ishte se fëmijët e saj duhej të rriteshin të shëndetshëm dhe se Perëndia do ta drejtonte atë dhe do ta mbronte që ta përmbushte atë dëshirë të perëndishme.

Shitësit individualë si ajo, natyrisht, ishin të paligjshëm në një vend komunist, por mamaja gjeti një mënyrë shumë të zgjuar për ta bërë këtë gjë të funksiononte, me bashkëveprimin e plotë të qeverisë. Në Korenë e Veriut, një menaxher i ushqimit dhe veshjes menaxhon disa restorante shtetërore. Mamaja bëri një marrëveshje, me anë të së cilës ajo do t'i raportonte të gjitha shitjet prej pjekjes së bukëve tek menaxheri, dhe pastaj do t'ia jepte restorantit gjysmën e parave që fitonte, duke mbajtur për vete gjysmën tjetër. Të gjithë fitonin—qeveria, menaxheri, dhe fëmijët e mamasë sime, të cilët nuk vdiqën. Në fakt, ne u rritëm mjaft të shëndetshëm, duke pasur parasysh rrethanat ku ishim.

Ajo ishte mjaft e mirë në bërjen e bukës gjithashtu. Duke i shtuar afro 5 përqind miell misrit të bluajtur me përmasa orizi, buka dilte tej mase e shijshme. Atë nuk e kishin mësuar sesi të bënte bukë më parë, prandaj ajo e bëri sipas mënyrës së saj—si petullat e skuqura mbi një tigan hekuri. Disa klientë të restorantit porosinin dhjetë bukë prej të sajave!

Ky ushtrim i hershëm i sipërmarrjes krijuese do të ishte vendimtar njëzet vjet më vonë. Kjo ndodhi ngaqë kur hyri viti 1990, racionet e qeverisë po pakësoheshin deri në zero, kurse zelli i qeverisë për t'i arrestuar shitësit ishte në rritje. Ata i lejonin njerëzit të shisnin vetëm sende që mund t'i prodhonin, t'i rrisnin ose t'i mblidhnin me duart e tyre—gjëra të tilla si shkurre tërfili, bastunë dhe kaci. Nëse dikush kapej duke shitur veshje, këpucë ose bukë, ai ose ajo duhej arrestuar nën dyshimin se kishte vjedhur nga rezervat e qeverisë.

Kështu që mamaja ime e vuri sërish në punë trurin. Ose, më saktë, ajo u lut—edhe pse ju nuk do të mund ta dallonit se po lutej po ta shihnit atë, ngaqë të krishterët e Koresë së Veriut nuk mund t'i ulin kokat ose t'i mbyllin sytë ashtu siç mund të bëni

ju. Po ta bënin këtë, ata do të përfundonin në burg ose në ndonjë kamp përqendrimi. Kështu që, kur ngrihesha në mes të natës, shihja mamanë që rrinte mendueshëm për periudha të gjata kohe, duke dëgjuar për zërin e Atij që i kishte gjëmuar kaq shumë herë babait të saj.

Ja sesi i erdhi ideja asaj që të blinte sende të importuara nga Kina dhe t'ua shiste ato fqinjëve tanë. Kjo punë e re nuk ishte e paligjshme: Në fund të fundit ne ishim nga Kina, dhe kishim të afërm atje. Nuk kishte asnjë ligj që të të pengonte t'i shisje sendet që t'i dërgonin të afërmit e tu nga Kina.

Edhe pse kishte plot të tjerë që shisnin mallra kineze, shumë njerëz blinin prej nesh. Mamaja ime i reklamonte sendet tona duke theksuar se tonat ishim më të lira nga ato të të tjerëve sepse ne i merrnim ato drejtpërdrejt prej të afërmeve tanë në Kinë.

Në atë kohë, u prezantua një politikë e re befasuese në Korenë e Veriut, drejtpërdrejt prej vetë Kim Jong Ilit. Drejtuesi i Dashur shpalli se qeveria nuk do t'i siguronte më racionet ushqimore. Në vend të kësaj, që tani e tutje njerëzit do të duhej të siguronin për veten e tyre. Në njëfarë mënyre njerëzit do të duhej ta zgjidhnin vetë nevojën e tyre për të ngrënë, duke siguruar në të njëjtën kohë lekët edhe për transportin dhe karburantin.

Për fat të mirë, prindërit e mi ishin të pajisur mirë për detyrën. Mjeshtëritë e tyre lidhur me gjërat e huaja, që gjer tani kishin qenë një burim dhimbjeje dhe humbjesh, më në fund sollën shpërbllim: ata ishin folës të shkëlqyer të kinezçes në një vend ku vetëm pak qytetarë mund të flisnin kinezçe. Mamaja ime kishte një mik të vjetër në Kinë, djali i të cilit drejtonte një kompani tregtare, kështu që ata u bënë vizitë atyre me shpresën se mos babai im punësohej si përkthyes. Ata i bënë përshtypje kësaj familjeje kineze duke i bërë të qeshnin me një shaka që ua treguan të gjithën në kinezçe. Më e rëndësishmja, ata u shpjeguan se nuk kishte asgjë të paligjshme në ato që po propozonin prindërit tanë. Ata e vulosën marrëveshjen: familja siguroi një çertifikatë punësimi

për babain tim dhe prindërit e mi u shpërngulën për në kufirin Kinë/Kore e Veriut në fillim të viteve 1990—pikërisht në kohë, që Perëndia përsëri ta shpëtonte familjen tonë dhe të na përdorte ne për të shpëtuar jetët e shumë njerëzve. Historia e gjyshit tim po vazhdonte—përmes nesh!

Të qenët përkthyes për një kompani tregtare i siguroi mundësinë e përsosur babait tim që të udhëtonte brenda e jashtë Koresë së Veriut me qëllim që t'i trajnonte partnerët e kompanisë. Për shkak se partnerët e kompanisë po trajnoheshin prej tij, ata dhanë raporte të favorshme për të tek qeveria. Tërë kohën mamaja ime e udhëzonte, duke e drejtuar atë që të na i dërgonte neve fëmijëve pothuajse të gjitha paratë që fitonte.

Dhe qëllimi nuk ishte që ndonjëri prej nesh të bëhej i pasur. Si gjithnjë, fokusi i nënës sime ishte t'i ndihmonte të varfrit. Ajo i ndihmoi koreanoveriorët që po kërkonin t'i shpëtonin urisë dhe vuajtjes. Kjo ndodhi madje përpara Marsit të Mundimit të Madh—një nivel të ri e të pakrahasueshëm të urisë dhe vuajtjeve që nisi në vitin 1995. Ngaqë mamaja ime njihej si dikush që ishte e gatshme t'i ndihmonte të tjerët, atë e vizitonin edhe jetimët që i kërkonin para. Mamaja gjithmonë i ndihmonte ata me gjithë zemër. Shumë shpejt shtëpia e tyre mbushej plot me njerëz që zhurmonin teksa kërkonin ndihmë. Mamaja ime nuk ankohej fare për këtë, por disa anëtarë familjeje po shqetësoheshin se mos ajo hynte në telashe me qeverinë ngaqë strehonte ngatërrestarë. Por ajo na qortonte ne: “A mos mendoni se e keni siguruar ju vetë mirëqenien tuaj? Ne vërtet i detyrohemi Perëndisë për gjithçka kemi. Gjithçka që kemi na është dhënë prej Perëndisë.”

Duke e thënë këtë, ajo sërish na e riktheu fokusin tek Perëndia në mes të një kohe të vështirë. Askujt nuk i duhej ai rifokusim më tepër sesa vëllait tim të vogël. Prindërit e mi u mashtruan shumë herë prej atyre që vizitonin shtëpinë e tyre, prandaj ai nxehej dhe shpesh tundte gishtin në shenjë qortimi ndaj mamasë. Ajo më kishte qejf mua ngaqë unë nuk sillsha si ai.

Në atë kohë, mamaja ime vendosi se nuk mjaftonte që të varfrit të hanin një vakt në shtëpinë e tyre dhe thjesht të largoheshin, kështu që ajo e mblodhi mendjen t'i dërgonte ata nëpër kishat e Kinës për ndihmë të mëtejshme. Ajo i këshillonte jetimët të shkolin në Kinë dhe të kërkonin një ndërtesë që kishte kryq mbi çati. “Thoni se jeni nga Koreja e Veriut dhe kërkonte që të jetoni atje”, - thoshte ajo, duke e ditur se kishat do t'i merrnin ata. Teksa bota përreth saj po shkërmoqej nga uria, edhe kur u bë e vështirë për mamane time që të kujdesej për veten e vet, ajo përditë ndërmernte punën e rrezikshme të drejtimit të koreanoveriorëve për në kishat e Kinës. Në mënyrë të veçantë, ajo mbronte vajzat e bukura që nuk kishin asgjë për të ngrënë. Në Kinë, numri i pakët i grave, së bashku me dëshpërimin e dukshëm njerëzor për urinë, pothuajse me siguri i dënonte ato që të hynin në tregtinë e seksit. Kështu që ajo gjithmonë u jepte atyre të njëjtat udhëzime: Shkoni në Kinë tek një ndërtesë që ka një kryq mbi të, martohuni dhe vazhdoni të shkoni sërish tek ajo ndërtesa me kryq.

Edhe kur u plak, mamaja ime nuk pati asnjë problem shëndetësor. Asaj nuk iu mpakën sytë dhe dëgjonte mjaft mirë. Dhe një zë ishte i pagabueshëm për të—ishte ai që e kishte dëgjuar i ati i saj dhe të cilin ajo kishte dëshiruar fort ta dëgjonte edhe vetë. Unë nuk e di nëse ajo arriti ta dëgjonte ndonjëherë në të njëjtën mënyrë që e dëgjoi ai, por e di se ajo bëri diçka që ai nuk e bëri kurrë: ajo nisi të ungjillizojë sa më shumë koreanoveriore që mundi.

Dhe nuk arriti vetëm anëtarët e familjes së saj. Duke e ndier se po i afrohej fundi i ditëve të saj, ajo i intensifikoi përpjekjet e saj për ta zgjuar për Krishtin secilin koreanoverior që ajo takoi. Për më tepër, ajo shkonte e vinte nga Kina për të marrë materiale për besimtarët e rinj dhe i fuste kontrabandë në Korenë e Veriut. Zakonisht këto ishin libra të hollë me përmasat e pëllëmbës së dorës, që mund të fshiheshin, ndonëse futja e tyre kontrabandë gjithmonë ishte e rrezikshme. Ajo i mbështillte me vinil dhe i fshihte në vende të ndryshme anembanë shtëpisë

për të shmangur zbulimin e tyre, në rast se do të vinin për kontroll në shtëpi.

Unë tund kokën i mrekulluar teksa rilexoj këto që sapo shkrova. Do doja shumë që t'ua përcillja juve sesa e pamundur ishte kjo punë, dhe sesi mamaja ime e bëri atë punë absolutisht pa pasur fare frikë. Ajo i ungjillizoi fqinjët e saj—kjo gjë thjesht nuk ndodh kurrë në Korenë e Veriut. Askush nuk do të guxonte t'i ungjillizonte fqinjët—ka tepër shumë spiunë mes tyre. Gjithkush ka marrë urdhrin të raportoje gjithçka që ka parë në jetët e atyre që ka përreth. Ata spiunojnë edhe ndaj njëri-tjetrit, duke u përpjekur të kuptojnë nëse tjetri është spiun prej vërteti apo jo. Jezusi tha se kudo ku dy ose tre janë mbledhur së bashku në emrin e tij, ai është mes tyre. Kurse në Korenë e Veriut, kudo që dy ose tre janë mbledhur bashkë, ata gjithmonë do ta vënë në dyshim identitetin e të tjerëve dhe do të pyesin veten se cili prej tyre është spiun i qeverisë. Si mundet dikush të ungjillizojë në këtë situatë?

Mamaja ime e bëri këtë. Nëse e mbaj mend tamam, afro shtatë njerëz e vizituan shtëpinë tonë në kohë të ndryshme. Mamaja ime i vinte përpara të futeshin tek dhoma, e mbyllte derën dhe i studionte bashkë me ta materialet për besimtarë e rinj. Ata dilnin nga ajo dhomë të shpëtuar dhe largoheshin si bashkëbesimtarë. Thjesht ishte e mrekullueshme. Së pari, bisnezi i bukëve. Pastaj, biznesi i importit. Tani, kjo. Kush mund ta kuptojë çfarë pioniereje ishte mamaja ime në shoqërinë e Koresë së Veriut?

Ajo gjithnjë na thoshte neve që të shkonim në Kinë. Në Korenë e Veriut, motra ime më e vogël dhe vëllai im më i vogël ishin mësues. Ju nuk mund ta imagjinoni sesa e vështirë është të punosh si mësues në Korenë e Veriut. Ata nuk kanë zgjedhje tjetër, përveçse të hanë drithra të ziera çdo vakt, dhe madje edhe atëherë, pothuajse asnjëherë nuk kanë mjaftueshëm për të ngrënë. Akoma më keq, a mund ta përfytyroni të jeni një i krishterë i fshehtë që jepni mësim në një sistem arsimor tërësisht të ndërtuar rreth lavdërimit dhe adhurimit të Kim Il Sungut dhe Kim Jong Ilit?

Por motra ime më e vogël dhe kunata ime ishin paralizuar nga frika dhe ishin të trembura për të bërë ndonjë gjë. Në fakt, zgjidhja e tyre ndaj sfidave të familjes sonë ishte ta nxisnin mamanë time të dorëzohej tek autoritetet. Po të kapej mamaja, që të gjithë ne do të dërgoheshim në një kamp përqendrimi për “krimet” e saj. Prandaj motra dhe kunata ime donin që mamaja t’i rrëfente aktivitetet e saj dhe ta shfaqësonte pjesën tjetër të familjes. Por mamaja ishte e palëkundur. Ajo thoshte: “Bota do të përfundojë brenda disa vitesh. Përpara se të vijë fundi, unë duhet të ungjillizoj sa më shumë njerëz të mundem. Prandaj, mos më kërkoni të vetëdorëzohem.”

Por mamaja tërhoqi vëmendjen time kur ajo na nxiti që të gjithëve për të shkuar në Kinë. Ndërsa koha kishte kaluar dhe unë isha rritur në besimin tim, idhujtaria në shoqërinë e Koresë së Veriut ma shqetësonte gjithnjë e më shumë ndërgjegjen. Si mund ta adhuronim Perëndinë dhe t’i zbatonim Dhjetë Urdhërimet në atë mjedis? Ndërkohë, akoma më shumë ligje po nxirreshin për ta frenuar “mospajtimin.” Gratë lejoheshin të vishnin vetëm funde kur dilnin përjashta. Takat e këpucëve të tyre duhej të ishin më pak se 5 cm. Njerëzve nuk u lejohej të vishnin bluza ose këmisha që kishin shkrim në anglisht mbi to. Flokët e gjatë u kriminalizuan. Elektriciteti, racionet dhe shërbimi i trenit nuk siguroheshin më.

Këto nuk ishin thjesht shqetësime të veçanta: vajza jonë u mor në pyetje gjatë natës, kur një ditë kishte veshur pantallona jash-të shtëpisë, dhe ne nuk mund të bënim asgjë për të marrë vesh vendndodhjen e saj ose për të vendosur sesi mund ta ndihmonim. Duke pasur parasysh shqyrtimin intensiv nën të cilin ishim për shkak të së shkuarës sime, secili ligj i ri i jepte qeverisë një pretekst më shumë për të na marrë nën shqyrtim e për të na mbajtur nën arrest. Rrjeta po mblidhej për t’u mbyllur shpejt. A do të kalonin ditë, javë apo muaj deri sa mamanë time ta kapnin, dhe ajo bashkë me tërë familjen tonë të dërgoheshim nëpër kampet e përqendrimit?

Por kjo nuk ishte arsyeja kryesore se përse mendova që të largohem. Ishte një kujtesë. Kujtova kohën kur isha fëmijë, dhe e shoqërova mamanë time tek ecte me gjyshim tim kur ajo e pyeti:

“A e dëgjove me të vërtetë zërin e Perëndisë?” Ajo kishte dëshiruar fort për një kohë shumë të gjatë për një besim aq të thellë sa ta dëgjonte Perëndinë të fliste, dhe tani, ja ku ishte, në prag burgimi, absolutisht pa asnjë lloj frikë, duke shpallur Fjalën e Perëndisë. Më kujtonte gjyshin teksa qëndronte tek dera e kishës duke bllokuar avancimin e japonezëve. Ajo ishte bërë si ai.

Po unë? Teksa rrija në udhëkryq për marrjen e vendimit më të rëndësishëm në jetën time, kujtova thirrjen e Perëndisë për gjyshin tim që të linte gjithçka pas në fshatin e tij me qëllim që ta shpëtonte atë. Dhe e dija se edhe unë isha bërë si ata, përmes mësimi dhe shembullit të tyre dhe me anë të hirit të Perëndisë. Do të lija gjithçka për ta ndjekur Perëndinë, me qëllim që të shpëtoja gjithçka që e mbaja të shtrenjtë dhe e dija se nuk mund ta shpëtoja me forcat e mia. Kështu që vendosa të largohesha nga Koreja e Veriut dhe të shkoja jo vetëm në Kinë, por deri në Korenë e Jugut. Me anë të hirit të Perëndisë, do të hapja rrugën që të më ndiqte e gjithë familja, me shpresën se një ditë, ne do të mund ta shpëtonim edhe popullin tonë.

Në çastin që u ktheva për ta kapërcyer lumin që të kaloja për në Kinë, mamaja më tha vetëm një frazë nga mbrapa:

“Mbaje besimin.”

KAPITULLI KATËR

Gruaja: Një lloj krejt tjetër i parashutistëve

Nga Znj. Bae

Babai im punonte si inspektor biznesi për qeverinë dhe edhe mamaja ime ishte një punonjëse për qeverinë. Singërisht, unë nuk dija as edhe një gjë rreth politikës kur isha fëmijë. Megjithatë, ajo që dija ishte se familja jonë kishte një traditë të fortë të ndershmërisë. Kur hedhim vështrimin pas, bashkëshorti im dhe unë mendojmë se prindërit e mi ndoshta dinin shumë gjëra rreth politikës dhe sesi të mos kishin telashe e të ishin në marrëdhënie të mira me qeverinë.

Por edhe atëherë, ligji nuk ishte i domosdoshëm për ta. Edhe pse ata ishin punonjës për ekonominë e përbashkët, ata asnjëherë nuk vodhën gjëra ose nuk i shitën ato në tregun e zi siç bënin shumë prej punëtorëve të tjerë. Në vend të këtyre, ata gjithmonë bënin punë shtesë sa herë që kishin kohë të lirë. Babai im shkonte nëpër ara që në orën 3 të natës, përpara punës që bënte ditën. Mamaja dhe gjyshja ime bënin qepje dhe thurje si punë shtesë. Si rezultat, edhe pse ishim një familje me dymbëdhjetë anëtarë, ne asnjëherë nuk patëm mungesa ushqimi, dhe që të gjithë fqinjët tanë na kishin zili për lumturinë që kishim. Ne hanim mirë, visheshim mirë, dhe jetonim në kushte komode. Arsimi ishte falas për të gjithë kur unë fillova shkollën në vitin 1969.

Mendoj se kur isha nxënëse në shkollën fillore, unë bashkë me vëllezërit e motrat e mia u rritëm mirë, jo për shkak të edukimit

moral që jepte shkolla, por thjesht ngaqë ne e shihnim sesi jetonin prindërit tanë. Edukimi etik nga shkolla në tërësi kishte të bënte me trajtimin mirë të të tjerëve, mosvjedhjen nga të tjerët e kështu me radhë. Kurse prindërit e mi asnjëherë nuk na lejonin ne t'i lëndonim të tjerët, ose nuk na lejonin të flisnim pas shpine për të tjerët, në asnjë mënyrë.

Edukimi moral i prindërve të mi kishte një standard shumë më të lartë. Ata thoshin: “Ti nuk mund t’u japësh të tjerëve, nëse ha çdo gjë që dëshiron.” Ata na mësuam se nëse i jep diçka dikujt, jepi një sasi të mjaftueshme. Për shembull, kur shumica e njerëzve ndanin ushqimin me fqinjët e tyre, zakonisht ata jepnin vetëm një sasi fare të vogël—aq sa të nderoheshin se ishin duke u treguar bujarë. Prindërit e mi ishin ndryshe. Kur ata bënin songpjon (songpyeon, një kek orizi me formën e gjysmëmehënës), jo vetëm që ishte i shijshëm, por ata gjithmonë bënin më shumë nga sa nevojitej. Në atë mënyrë, gjithsecili në familjen tonë mund të hante dhe gjithashtu kishte mjaftueshëm për t’u dhënë edhe fqinjëve. Prindërit e mi donin që fqinjët e tyre të kënaqeshin vërtet me songpjonin. Ata na mësuam edhe ne ashtu.

Vëllezërit e motrat e mia jetonin pranë oqeanit. Nganjëherë ata na sillnin peshq dhe prodhime deti. Prindërit na thoshin t’u jepnim ca nga peshqit e nga prodhimet e detit fqinjëve tanë, dhe ata nuk na lejonin që t’u jepnim të tjerëve pjesën më të keqe të ushqimeve. Mamaja ime gjithnjë i kontrollonte peshqit dhe prodhimet e detit që kishim përgatitur. Pastaj ajo thoshte: “Duhet t’ju vijë turp që e jepni ushqimin në atë gjendje! Jepuni atyre ushqim më të mirë.” Ja çfarë mësova prej prindërve të mi. Mësova më tepër prej tyre sesa prej shkollës.

Dhe për shkak se jetoja nën përpunimin dhe mësimin e prindërve të mi, unë merrja shumë lavdërime në shkollë. Shokët e shoqet e mia të klasës votuan për të ma dhënë mua distinktivin “Veza e Zogut që Troket” kur ishim në klasën e dytë. Unë mora renditjen më të lartë në klasë: presidente e klasit të lartë. Klasa jonë kishte

pesëdhjetë e gjashtë nxënës. Klasa ndahej në grupe me gjashtë ose shtatë nxënës. Një person që ishte president klase kujdesej për një grup me gjashtë ose shtatë nxënës. Kurse presidenti i klasit të lartë kujdesej për të gjithë pesëdhjetë e gjashtë nxënësit dhe atij i jepej një kravatë e veçantë për ta veshur.

Unë gjithashtu mësova sesi të shkruaj më herët se të tjerët. Si inspektor, babai im shpesh shkonte në udhëtime pune. Njëherë, pasi ai ishte kthyer nga një udhëtim pune, po më shihte qetësisht teksa po bëja detyrat e shtëpisë. Unë po shkruaja një raport pasi kisha lexuar vetëm disa faqe. Babai më tha: “Ti je shumë e zgjuar. Si mund t’i mbash mend e të shkruash aq shumë fjalë, pasi e ke lexuar materialin vetëm një herë?” Ma ha mendja se kisha një kujtesë shumë të mirë. Unë mund ta lexoja një faqe vetëm një herë dhe e dija aq mirë tekstin, sa të isha në gjendje ta kopjoja pa e parë. Në fakt, edhe prindërit e mi ishin shumë të zgjuar.

Shkolla nuk më mësoi sistematikisht sesi të lexoja, të flisja, dhe të shkruaja, por në rolin tim si presidente e klasit të lartë, unë mësova t’i bëja ato gjëra. Në Korenë e Veriut, shpesh mbahen konkurse për fjalimet. Unë mora pjesë në këto konkurse dhe fitova shumë çmime të para. Fjalimet kishin tituj të tillë si: “Ndëshkimi i amerikanëve,” “Goditja e Amerikës,”

Amerika është armiku vdekjeprurës i Koresë së Veriut,” dhe “Brutaliteti i amerikanëve ndaj Koresë së Veriut gjatë luftës së Koreve.”

Madje edhe në shkollën fillore ata na mësonin për të madhin Kim Il Sung, që ishte kreu i shtetit atëherë. Arsimi në Korenë e Veriut bazohet në sa besnik je ndaj Drejtuesit të Madh. Kështu që gjëja e parë që mësova në shkollë ishte: “Drejtuesi i Madh Kim Il Sung, falemnderit!” Çdo orë, qëllimi i mësimit ishte të studionim detyrimin tonë ndaj revolucionit. Nuk ka rëndësi çfarë po mësonim—nëse ishte alfabeti i gjuhës koreane ose matematika—krejt qëllimi i arsimit ishte të trajnoheshin nxënësit për të shërbyer si ushtarë revolucionarë që do të ishin përgjithmonë besnikë ndaj

Kim Il Sungut. Neve na mësonin se Kim Il Sung ishte Perëndia dhe se pa të ne do të vdisnim—ne do të vdisnim urie, kombi ynë do të pushtohet dhe ne do të bëheshim skllëvër të Amerikës ose Japonisë. Me qëllim që t'i mbronim kombin tonë dhe Kim Il Sungun, ne duhet të dilnim mirë në shkollë e në jetë. Ky ishte qëllimi kryesor i arsimit tonë. Dhe si ushtarë revolucionarë, neve na duhej të mësonim njohuri të dobishme e praktike.

Patjetër që unë isha mes nxënësve më besnikë. Në shkollën fillore unë mora lavdërime në tre raste të ndryshme: një nga ushtria, një nga Aleanca e të Rinjve, dhe një nga një zyrtar i qeverisë. Unë isha nxënësja më e mirë në tërë shkollën me tetëqind nxënës.

Sigurisht që unë nuk u rrita si e krishterë, por kjo nuk do të thotë se nuk kisha dëgjuar kurrë për krishterimin. Ja ku është njëra nga historitë që kisha mësuar rreth një misionari amerikan nga tekstet e shkollës.

Kjo ngjarje ndodhi përpara Luftës për Çlirimin e Atdheut, ose ajo që ju e quani Lufta Koreane. Ngjarja tregon se ishte një kujdestare shtëpie që punonte për një misionar amerikan. Emri i djalit të kujdestares ishte Bok-Nam. Bok-Nami shkoi tek shtëpia e misionarit për të kërkuar mamanë e tij. Shtëpia ishte e rrethuar me gardh, dhe përtej gardhit kishte rënë një mollë prej pemës që ndodhej në kopshtin e misionarit. Bok-Nami e mori mollën dhe i biri i misionarit e pa. I biri i misionarit u fut në shtëpi dhe i tha të atit: “Babi, Bok-Nami vodhi mollën tonë!”

Pastaj, misionari e futi Bok-Namin në shtëpinë e tij dhe shkruajti fjalën “Vjedhës” mbi ballin e Bok-Namit. Me acid.

“Por vjedhësi i vërtetë ishte misionari”, - na mësonte libri shkollor ne. Misionari kishte veshur maskën e një deleje, por në realitet ishte një hipokrit që kishte hyrë vjedhurazi në Korenë e Veriut. Ai ishte i lig nga përbrenda, mësonim ne.

Qeveria na mësonte në atë mënyrë që të na pengonte për të besuar në Jezusin. Ajo që kuptova ishte se Koreja e Veriut e përdorte Luftën për Çlirimin e Atdheut për t'i bindur koreanoveriorët që ta

Këta janë brezat

urrenin Amerikën, dhe ata e përdornin historinë me misionarin për të na bërë ne që të mos e pranonim Perëndinë.

Ata gjithashtu na mësuan se misionari përpqej t'u mësonte koreanoveriorëve një kulturë “budallaqe.” Sa marrëzi ishte, thoshin ata, që nëse dikush të godet në njërën faqe, ti duhet t'ia kthesh edhe tjetrën. Në atë mënyrë, kombi do të binte, dhe ata thoshin se pikërisht ky ishte qëllimi i misionarit.

Kështu që, nga fëmijëria, secili nxënës i Koresë së Veriut mësohej ta adhuronte Kim Il Sungun dhe vetëm atë. Me aq sa dinim ne, nuk kishte asnjë perëndi tjetër. Një shkollë filllore në Korenë e Veriut ka katër klasa. Pas shkollës filllore, fëmijët koreanoveriorë futen në ciklin e dytë, ose në shkollën e mesme. Shkolla e mesme ka gjashtë klasa. Parashkollori ofrohet për një vit përpara shkollës filllore, por është sipas dëshirës.

Kur nxënësit mbushin nëntë vjeç, ata mund të futen në Lidhjen Rinore të Partisë. Distinktivi i tyre është shalli. Lidhja Rinore e Partisë kërkon që personi të bëjë një betim, përpara se të futet në të. Pasi bëjnë betimin, nxënësit që dalin mirë në shkollën e mesme marrin një shall. Unë isha nxënësja e parë në klasën time që u bë një anëtare e Lidhjes Rinore të Partisë dhe që iu dha si çmim një shall—goxha arritje për një vajzë!

Pasi mbarova shkollën filllore, unë u futa në ciklin e dytë të shkollës. Dola mirë atje ngaqë studiova fort. Mua nuk më pëlqente të isha prapa krahasuar me nxënësit e tjerë. Teksa hedh vështrimin prapa tek ato gjëra, mendoj se Perëndia më dha mençuri në atë kohë. Kështu duhet t'ia kem dalë.

Më vinte shumë ndoresh për të shkruar. Kisha shkrim dore të bukur dhe gjithashtu shkruaja hartime të mira. Momenti im më i paharrueshëm ishte kur shkrova një ese me titullin “Një ditë ekskursioni”, e cila fitoi çmimin e parë në një konkurs. Në atë kohë, vëllai im i madh ishte në vitin e diplomimit. Ai më tha: “Mësuesi yt tha se ti je më e mira. Kështu që, eja ta vëmë në provë këtë.” Pastaj vëllai im i mblodhi miqtë e tij dhe më kërkoi të shkruaja

diçka aty për aty mes tyre që ai të mund ta lexonte. Dhe unë e shkrova. “Uau! Ti je vërtet e mirë”, - tha ai.

Ne mësonim fizikën, kiminë dhe biologjinë. Nxënësit përgatisnin raporte të gjata mbi eksperimentet dhe pastaj mësuesit i korrigjonin ato. Pas korrigjimit, ata i lejonin vetëm nxënësit më të kualifikuar që të jepnin provimin; të tjerët nuk lejoheshin. Nxënësit e shihnin atë si një konkurs. Unë punova shumë fort. U përpoqa t'i bëja raportet e mia të dukeshin sa më profesionale. Nxënësit duhet t'i bënin raportet vetë, ngaqë prindërit gjithmonë ishin tepër të ngarkuar me punë e nuk i ndihmonin dot. Për fat të mirë, që nga fëmijëria, unë kisha lexuar shumë libra, dhe dija sesi t'i bëja kapakët e librave të dukeshin më të bukur. Të gjitha kujtimet e mia të preferuara nga vitet e shkollës përfshijnë leximin e librave dhe shkrimet. Shkollat i shpallnin publikisht rezultatet e çdo konkursi. Kurdoherë që zija vendin e dytë, unë dërrmohesha e nuk flija dot. Kurdoherë që fitoja vendin e parë, unë flija si qengj—pushimi plot kënaqësi i nxënësit revolucionar.

Në ciklin e dytë të studimeve, unë isha presidente e klasit të lartë që nga klasa e parë deri në klasën e tretë. Djemtë që ishin nxënës bashkë me mua nuk ndiheshin rehat pranë meje ngaqë unë nuk flisja shumë dhe talenti im ishte i jashtëzakonshëm. Unë kisha aftësi drejtuese, dhe shpesh merrja pjesë në aktivitete të tilla si konkurse për të folurit. Në fakt, po ta mendoj, as djemtë, as vajzat nuk ndiheshin rehat me mua. Gjithsesi, unë isha zemërmirë për shkak të udhëzimeve të prindërve të mi. Kishte plot nxënës që nuk dilnin hiç mirë në shkollë, dhe shumë të tjerë që ishin pa shpresë për shkak të situatave të vështira. Ata vareshin nga racionet ushqimore, dhe nëse prindërit e tyre ishin pa punë ose ishin të sëmurë, jeta për ta ishte vërtet e keqe. Unë i ndihmoja shumë ata kur isha presidente e klasit të lartë. Kur organizoja grupet, i bashkoja nxënësit e mirë me ata të dobët.

Nganjëherë grumbulloja dru zjarri dhe ua jepja ato nxënësve në nevojë. Gjithashtu u kërkoja nxënësve që kishin para tepër

që t'ua dhuronin ato nxënësve në nevojë. Madje unë i kërkoja secilit nxënës që të mblidhte lekët e xhepit për nxënësit e dobët. Po të ishte ndonjë nxënës që nuk kishte këpucë, fletore ose lapsa, unë i jepja të miat, ose u kërkoja nxënësve të tjerë t'i ndanin me ta sendet e tyre. Në pushimin e drekës, unë i mblidhja të gjithë nxënësit që nuk kishin mundësi të sillnin ushqim me vete dhe i nxisja nxënësit e tjerë që ta ndanin drekën e tyre me ta.

Në ato ditë, kjo nuk ishte një gjë e lehtë për t'u bërë në Korënë e Veriut. Sinqerisht, nuk kishte shumë njerëz që bënin vepra të mira; megjithatë, unë i bëja—për shkak të edukatës që kisha marrë prej prindërve të mi. Babai më kishte mësuar që të isha e mirë dhe e hirshme me të tjerët. Ai më mësoi që t'i përshëndesja edhe ata që shtynin qerret e bujqve. Unë e shihja me kujdes sesi i përshëndeste ai ngrohtësisht duke u thënë: “Vëlla, nga vjen ti?” Ky ishte modeli që pamë ne. Në qytetin tim kishte edhe gungaçë, dhe ata gjithmonë vuanin nga diskriminimi dhe neglizhimi në publik. Por kjo nuk u ndodhte atyre në tryezën e prindërve të mi—gatimi i të cilëve ishte shumë i mirë, dhe gjithnjë kishte vend edhe në familjen tonë të madhe për gungaçët që të vinin të hanin një vakt me ne në ditët e veçanta.

Deri tani unë ju kam treguar të gjitha ato gjëra që i bëja mirë. Por kishte një gjë që nuk e bëja mirë—të qëlloja me pushkë. Kur isha në klasën e katërt të ciklit të dytë të studimeve, unë iu bashkova klubit të të rinjve ushtarakë. Isha shumë e ndrojtur. Ishin disa djem ndër nxënësit që e shpinin plumbin në mes të tabelës së qitjes, sa herë që tërhiqnin këmbëzën e armës. Unë as edhe një herë të vetme nuk qëllova në shenjë. Çdo fishek që gjuaja fluturonte drejt maleve.

Por gjëja që urreja më tepër ishte ajo që ne e quanim “beteja për mbështetjen e fshatit bujqësor.” Nga klasa e parë deri në klasën e tretë të ciklit të dytë të studimeve, ne duhej të shkonim në fermën e fshatit për të punuar pas shkolle. Sapo fillonim klasën e katërt, ne merrnim një lloj vule ushqimore, si pjesë e sistemit të racionimit të ushqimit.

Fëmijët shkonin tek vendet e punës së prindërve të tyre për të marrë një vulë ushqimore që kishte vlefshmëri për pesëmbëdhjetë ditë ose për një muaj. Pastaj ne e shpinim atë kudo ku na nevojitej për të marrë racionin ushqimor, zakonisht në fermën e fshatit. Njerëzit zakonisht shkonin tek ferma që në orën 5:00 të mëngjesit, përpara se të shkonin tek puna e tyre kryesore, me qëllim që të punonin në fushë për racionet e tyre ushqimore, kurse fëmijët nuk mund të shkonin aq herët sepse ishte tepër ftohtë përjashta. Edhe në maj bën shumë ftohtë në Korenë e Veriut; nëse bie shi, ose ka shumë re, zakonisht është tepër ftohtë që fëmijët të punojnë në tokën bujqësore.

Në fermën e fshatit, secila shtëpi ishte përgjegjëse për zonën e tyre e cila ishte afro 32.5 metra katrorë. Ti nxjerr përjashta fidanët e orizit tërë ditën, dhe për punën e asaj dite merr 0.5 pikë. Por që të arrish të marrësh ushqim, duhet të plotësosh një pikë. Kështu që, përfytyroni të nxjerrësh përjashta të gjithë fidanët e orizit në një zonë me sipërfaqe 65 metra katrore për të arritur të marrësh racionin tënd ushqimor. Ishte rraskapitëse. Ishte e vështirë të studioje, të mbështesje fermën e fshatit dhe të shërbeje me organizatat e rinisë. Për fat të mirë, unë nuk duhej të punoja aq shumë sa të tjerët ngaqë isha më e vogla në familjen tonë.

Në pranverë, neve na duhej të kalonim tridhjetë deri në dyzet e pesë ditë për të hequr barërat e këqija nga pjesa jonë e fushës në fermën e fshatit. Në vjeshtë, ne kishim pesëmbëdhjetë ditë për ta korrur orizin dhe misrin. Pasi fidanët e orizit piqeshin, ne duhej t'i nxirrnim ata përjashta e t'i transferonim dorazi për në orizoret. Me të vërtetë që e urreja atë punë.

Në ciklin e dytë të studimeve, besnikëria ndaj shtetit ishte absolutisht thelbësore. Përmbi gjithçka tjetër, secili nxënës duhej të mbillte fasule dhe të dorëzonte të paktën një kilogram prodhim çdo vit. Ne gjithashtu duhej të mblidhnim hekurishte, sende qelqi e shishe dhe duhej t'i dorëzonim edhe ato.

Një nga detyrat më të vështira për nxënësit ishte të dorëzonin lëkurat e lepujve. Të gjithë ne duhej të rritnim një lepur në shtëpi,

ta hanim dhe ta dorëzonim lëkurën. Problemi ishte se asnjëri nga anëtarët e familjes nuk më ndihmonte mua për t'u kujdesur për lepurin. Unë iu ankova prindërve për atë gjë, por edhe vëllai im dhe motra ime gjithashtu duhej të dorëzonin lëkurat e tyre. Dhe shkolla nuk i pranonte lëkurat e vogla. Me të vërtetë që nuk më pëlqente t'i kryeja ato detyra.

Shkolla i dorëzonte që të gjitha gjërat që grumbullonim ne tek ushtria ose në vendet ku ndërtohej. Rëndësia e studimit u theksohet të gjithë nxënësve koreanoveriorë, por po ashtu u theksohet rëndësia e mbështetjes së fermës së fshatit, rëndësia e mbjelljes së fasuleve, rëndësia e grumbullimit të mbetjeve për riciklim, dhe rëndësia e marrjes së lëkurës së lepujve. Kështu që jeta e një nxënësi koreanoverior është punë e vazhdueshme, edhe mendore, edhe fizike.

Ndryshe nga lepuri, unë mbijetova. Dhe unë madje mora një rekomandim që më krijonte mundësinë për të shkuar në universitet—një nga vetëm katër nxënës në shkollën time që u përzgjedhën. Pasi universitetet i përzgjedhin nxënësit e tyre, ushtria pastaj rekruton cilin të dojë prej nxënësve që mbeten. Ata që nuk përzgjidhen përfundojnë në miniera ose në fermën e fshatit. Në kohën time, nënkuptohej se nxënësit do të ndiqnin gjurmët e prindërve të tyre: Nëse prindërit shkonin tek ferma e fshatit, fëmijët e tyre shkonin me ta. Nëse prindërit shkonin tek miniera, fëmijët e tyre i ndiqnin ata tek miniera.

Unë mora rekomandimin për në universitet, por mësuesit gjithashtu më rekomanduan që të futesha në ushtri. Kështu që në të njëjtën kohë unë iu nënshtrova ekzaminimit fizik për në ushtri, dhe një provimi për pranimin në universitet. Unë mora letrën e pranimi prej të dyve. Kur pashë se disa nga miqtë e mi u futën në ushtri, edhe unë doja që të hyja në ushtri. Por prindërit e mi më thanë: “Yt vëlla e jot motër u futën në ushtri. Si mund të hysh në ushtri edhe ti?” Prindërit donin që unë të bëhesha mësuese, ngaqë ata mendonin se mbi supet e mësuesve nuk binte as shi, as borë, dhe se thembrat e këpucëve të mësuesve nuk bëheshin me baltë.

Por unë nuk pranova të dorëzohesha aq lehtë. Përpara udhëtimeve të biznesit të tim eti, prindërit e mi hanin një vakt së bashku. Kështu që në njërin nga këto raste, unë e hapa derën, u futa në dhomën ku po hanin ata dhe shpalla: “Vetëm reaksionarët po jetojnë këtu. Unë do të futem në ushtri dhe do të bëhem parashutiste.” Kisha një ambicie të madhe. “Unë do të hip në një aeroplan dhe do të bëhem parashutiste. Më pas do të largohem me nderime nga ushtria si komandante batalioni. Do t’jua tregoj! Dua të shkoj në ushtri sa më shpejt!”

Por ata më panë të patrazuar. “Jo, nuk mundesh”, - theksoi im atë. Prindërit e mi këmbëngulën se për mua ishte më e përshtatshme karriera e mësuesisë. Dhe kështu, për shkak të kundërshtimit të tyre ndaj meje që të mos futesha në ushtri, unë nuk kisha zgjedhje tjetër, përveçse të shkoja në universitet.

Shumë profesorë donin të më kishin mua studente të tyre. Ata thoshin: “Ti duhet të vish tek ne.” Ata donin që unë të bëhesha mësuese e shkollës fillore, mësuese e shkollës së mesme, dhe madje edhe mësuese e Lidhjes Rinore të Partisë. Mësuesi i Lidhjes Rinore të Partisë i kontaktoi prindërit e mi dhe i pyeti: “Çfarë doni ju që të bëhet vajza juaj?” Prindërit e mi i thanë atij se unë duhej të bëhesha mësuese.

Në të vërtetë unë nuk doja të bëhesha mësuese. Unë i kundërshtova prindërit e mi: “Si do kujdesem unë për fëmijët e vegjël?” Por prindërit e mi thanë se të qenët mësuese ishte një punë e pastër. Kështu që atje e fillova karrierën time.

Një arsye përse unë nuk doja të bëhesha mësuese ishte se në Korenë e Veriut mësimdhënia gjithmonë përfshinte premtimin e përditshëm të besnikërisë ndaj shtetit, dhe gjithçka bëhet e lodhshme—sidomos për drejtuesit. Që nga klasa e parë e ciklit të dytë të studimeve, nxënësit duhet të recitojnë një betim të shkruar ndaj atit tonë të respektuar, Kim Il Sungut, dhe pas recitimit fillonin mësimet. Teksa rritesha në shkollë, dhe duke qenë presidente e klasit të lartë, unë duhej ta mbartja atë betim

Këta janë brezat

me vete, duke e vënë gjithmonë në pjesën ballore të çantës sime të shpinës. Ishte e ngjitur fort dhe e mbuluar me një kapak të kuq. Në faqen e parë ishte shkruar betimi ndaj Kim Il Sungut. Në faqen tjetër kishte një betim tjetër të shkruar që thoshte diçka të tillë: “Unë do të studioj fort dhe do të dal mirë me Lidhjen Rinore të Partisë.” Unë duhej t’i drejtoja ata përditë. Kështu që mezi po prisja që të mos më duhej të isha personi që duhej ta bënte këtë gjë në universitet.

Pastaj ishte jeta në grup, takimet që zgjasnin gjithë ditën, të programuara që të siguroheshin se në çdo fushë të jetës sonë, ne ishim duke jetuar si ushtarë të revolucionit. Gjatë jetës në grup, grupe me dyzet e pesë studentë uleshin së bashku. Secili grup drejtohej nga kreu i shoqatës së kolegjit dhe një mësues. Fillimisht jeta në grup zgjaste dy ditë. Më vonë, ajo u ndryshua në një javë. Përveç kësaj, kishte edhe jetë të përmuajshme në grup, tremujore, dhe vjetore. Si studente, unë duhej të shkruaja një raport ditor, një raport planifikimi dhe të krijoja rendin e ditës së takimit. Me të vërtetë e urreja kryerjen e këtyre gjërave, dhe iu betova vetes se sapo të shkoja në universitet nuk do të bëhesha kurrë drejtuese e shoqatës së kolegjit.

Dhe sikur ta dinit; unë u bëra drejtuesja e shoqatës së kolegjit në universitetin tonë. Me të vërtetë që nuk e pëlqeja fare. Çdo ditë, unë duhej të merrja pjesë në realizimin e detyrave për programin e jetës së grupit që në agim. Më duhej t’i inspektoja përditë ditarët e studentëve për jetën e grupit. Si drejtuese e shoqatës së kolegjit, unë nuk kisha fare kohë për të studiuar. Kur të tjerët studionin, mua më duhej të shkruaja raportet për jetën e grupit, të vendosja notat për jetën e grupit dhe të hartoja planet për jetën e grupit. Mua më duhej ta paraqisja raportin tim për jetën e grupit tek Komiteti i Shoqatës së Kolegjit që ta inspektonin. Ndërsa të tjerët ktheheshin në shtëpi në orën 6:00 pasdite, unë nuk kthehesha në shtëpi deri në orën 11:00 të natës. Si rezultat, unë nisa të specializohesha në punën mbi shoqatën e kolegjit e jo

të studioja që të diplomohesha në arsim. Asnjëri nuk e mendoj se kjo gjë ishte ndopak e çuditshme. Edhe në universitet, të qenët një ushtar revolucionar ishte thelbësore. Në fund të fundit ne që të gjithë po hartonim historinë e revolucionit. Ne e kalonim shumicën e kohës sonë duke mësuar rreth politikës madhështore të komunizmit e socializmit, kështu që kishim fare pak kohë për të studiuar ndonjë gjë tjetër. Të gjithë ne donim të ishim mësues dhe anëtarë të Partisë Komuniste në të njëjtën kohë. Dhe pranimi në Partinë Komuniste kërkonte shumë më tepër gjëra sesa marrja e lëkurëve të disa lepujve.

Unë u diplomova nga universiteti me ambicien e anëtarësimit në parti. Unë gjithashtu u diplomova shkëlqyeshëm. Dhe kjo nënkuptonte se duhej të kisha qenë në radhë për një pozicion prestigjioz në një shkollë shumë të mirë. Por në Korenë e Veriut, gjithçka kthehet tek nevojat e partisë, të shtetit dhe të revolucionit. Ngaqë unë isha prej një fshati që ndodhej shumë afër kufirit mes Koresë së Veriut e të Jugut, kjo nënkuptonte se unë—dhe gjithkush tjetër në fshatin tim—kishim përgjegjësi speciale për shërbimin ushtarak civil. Kështu që unë u dërgova për të kryer detyrën e mbrojtjes së një mali që konsiderohej shumë i cënueshëm në rast sulmi nga Koreja e Jugut. Për fat të mirë, rezultatet e mia më dallonin, dhe më kërkuan përsëri në universitet e më dhanë mundësinë që t'i përfundoja studimet e mia.

Por pas diplomimit, unë u caktova menjëherë në një shkollë që ndodhej përsëri pranë kufirit. Që nga oborri i shkollës unë mund t'i shikoja telat me gjemba të ZDM - Zonës së Demilitarizuar, një shirit toke që shërben si tampon mes Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut. Kaq e pati rëndësia dhe prosperiteti.

Gjithsesi jeta për mësuesit në Korenë e Veriut (sidomos për ata që janë beqarë, të rinj dhe të talentuar) nuk përfshin shumë qëndrueshmëri dhe stabilitet. Shumë shpejt, unë u caktova në një shkollë për tetë muaj. Më vonë, u thirra në një qytet tjetër për të shërbyer në një shkollë atje. Por nuk ishte edhe aq keq. Në fakt,

shumica e njerëzve duket sikur i kujtojnë vitet e tyre të kolegjit si kujtimet më të dashura të jetëve të tyre. Por shumicës së njerëzve nuk u duhej t'i paraqisnin për inspektim te Komiteti i Shoqatës së Kolegjit raportet e tyre për takimet e jetës në grup, deri në orën 11 të natës. Prandaj, disa nga kujtimet më të lumtura të jetës sime të re ndodhën në ato vite të hershme të mësimdhënies. Unë kisha shumë energji dhe shumë ide të mira, po përmirësohesha në punën time, dhe efektshmëria ime në punë ishte e mirë—edhe pse më duhej të ecja 35.5 km për të mbërritur te shkolla nga qendra e qytetit, ngaqë nuk kisha makinë. Por të paktën nuk kisha për të rrjepur lëkurat e lepujve.

Kur shkolla ime në kufi mernte pjesë në sporte, ne nuk arrinim kurrë të fitonim ndonjë kampionat lojërash, për shkak të numrit të vogël të nxënësve tanë. Por unë bërtisja deri sa më ngjirej zëri, duke parë volejball, basketboll dhe hendboll.

Kishte shumë konkurse individuale, si luajtja në instrumenta muzikore ose kënga. Unë i trajnova nxënësit për të kënduar, për t'i rënë fizarmonikës dhe harmonikës. Unë i trajnova ata që të fitonin. Unë nuk doja që të tjerët ta shihnin me përbuzje shkollën tonë për shkak të numrit të vogël të nxënësve. U thashë nxënësve tanë: “Po të mos e fitoni konkursin, duhet të vdisni atje. Unë nuk dua që të zini vendin e dytë. Zini vendin e parë, tani!” Ishte e paharrueshme.

Për shkak të efektshmërisë sime të mirë, unë mora famë. Pati (dhe ka akoma) shumë çmime dhe matës të shkëlqyeshmërisë për nxënësit dhe mësuesit. Unë mora dhjetë letra rekomandimi prej të tjerëve, që të gjitha në të njëjtën kohë, dhe letrat iu raportuan shkollës. Kjo gjë solli një emërim prestigjioz për mua në një shkollë që po hapej, ku u ngarkova me përgjegjësinë për t'u siguruar se ajo do të arrinte ta merrte titullin e rrallë e të lakmuar “shkollë model.” Megjithatë, askush nuk më mësoi sesi ta arrija që ta merrnim atë titull. M'u desh që ta kuptoja gjithçka vetë dhe ta plotësoja krejt dokumentacionin gjithashtu vetëm fare. Procesi ishte mjaft i

ndërlikuar e i pashpresë. Kishte plot kritere që duheshin plotësuar, si sa tekste librash duhej të lexoheshin prej nxënësve, cilat lëndë duheshin dhënë mësim, çfarë duhej të kishte në planin e biznesit të shkollës e të tjera.

Këto aplikimet për shkollën model gjithmonë i raportohen ushtrisë. Nëse ushtria i miraton, ato i raportohen zyrtarëve shtetërorë të qeverisë, dhe rishikohen për miratim. Pas miratimit të tyre, aplikimet i dërgohen zyrtarit të qeverisë qendrore. Dhe pas kësaj, ato rishikohen prej Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, i cili përbëhet nga treqind anëtarë. Prandaj, kur një shkollë merr titullin shkollë model, kjo do të thotë se shkolla ka nxënësit më të mirë, që janë të trajnuar me përsosuri në trup, njohuri e moral. U sjell përfitime edhe nxënësve, edhe mësuesve, por përfitimin më të madh e merr drejtori i shkollës.

Kurse mësuesja e re, që bën tërë punën e vështirë për të mundësuar që shkolla e drejtori të marrin titullin, nuk merr asgjë. E po, kjo nuk është krejtësisht e saktë. Unë mora vëmendjen e pandalshme (dhe krejtësisht të padëshiruar) të drejtorit dyzet e dy vjeçar të shkollës, që e tha me vrull se sapo ishte divorcuar me të shoqen dhe donte që të jetonte me mua. Ai më premtoi se, po të flija me të, ai do të ma realizonte ëndrrën time më të dashur: anëtarësimin në Partinë Komuniste.

Në atë kohë unë isha njëzet e pesë vjeçare. Doja me çdo kusht që të isha anëtare partie, që njerëzit të më respektonin. Por nuk isha lejuar që të futesha në parti, ngaqë zyrtarët e shkollës e dinin se po të futesha në parti, natyrisht që do të martohesha dhe ditët e mia të mësimdhënies do të përfundonin. Kështu që shkolla vazhdoi të më ndalonte—derisa drejtori erdhi e më thirri.

Natyrisht unë i kundërshtova orvatjet e tij. Isha e tmerruar. Por siç janë rregullat shoqërore në Korenë e Veriut, unë nuk mund t'u tregoja prindërve të mi se drejtori donte të flinte me mua, prandaj hoqa dorë nga ëndrrat e mia për t'u futur në parti, dhe u thashë prindërve se doja të martohesha menjëherë. Ata u shtangën më

shumë sesa kur u thashë se doja të bëhesha parashutiste. “Çfarë të ndodhi?” - më pyetën ata. - “Ti gjithmonë zemëroheshe kur ta përmendnim martesën më parë.”

Kështu që unë u martova me Z. Bae. Ne shkuaam në muajin e mjaltit dhe më vonë unë linda dy fëmijë. Unë isha e lumtur dhe jeta ime ishte e mirë, njëlloj siç ishte kur jetoja me prindërit e mi. Por edhe pse kisha qenë shumë e suksesshme, e zgjuar dhe energjike tërë jetën time, pasi linda fëmijët unë isha vetëm e sëmurë—gjatë gjithë kohës. Prindërit e mi dhe vëllezërit e motrat e mia ndienin keqardhje për mua. Ata pyesnin veten përse po sëmuresha dhe mendonin se mos ndoshta kjo ishte shkaktuar prej ndonjë mëkati të panjohur në të shkuarën e prindërve të mi. I tërë trupi im ishte i sëmurë, por nuk kishte ndonjë emër specifik për sëmundjen time.

Im shoq më tha: “ Nëse është e vështirë për të jetuar, atëherë lutu—me të dyja duart e bashkuara.” Ai as nuk tha “Zoti” ose “Perëndia” e as nuk e shpjegoi çfarë ishte lutja. Ai thjesht tha se unë duhej ta rrëfeja atë që kisha bërë gabim dhe të lutesha. Sinqerisht, m’u duk për të qeshur. Mendova se ai po sillej si budalla. Unë kisha qenë vazhdimisht e sëmurë, dhe ai më tha që të lutesha—me të dyja duart të bashkuara. Kur u luta, unë u shërova. Nuk zgjati përgjithmonë—unë sërish sëmuresha, natyrisht, dhe akoma sëmurem—por kur mendoja për lutjen nuk tallesha më.

Nganjëherë, pas asaj përvojës së parë të shërimit, shkoja përjashta nën dritën e hënës dhe bëja këtë gjënë e lutjes me të dyja duart e bashkuara. “Përse jam e sëmurë?” Nuk e pyesja asnjërin në veçanti teksa i shtrëngoja të dyja duart së bashku. “Kam bërë më të mirën time për të qenë njeri i mirë. Pse jam e sëmurë tani? A mundet ndokush të më shërojë mua?” Dhe nganjëherë shërohesha.

Bashkëshorti im më tha: “Mos mëkato.” Unë as që nuk e dija se çfarë ishin “mëkatet.” Ai më shpjegoi se gënjeshtra është mëkat, t’i shohësh të tjerët me përbuzje është mëkat, vjedhja është mëkat dhe kurorëshkelja është mëkat. Unë as që e dija çfarë ishte kurorëshkelja.

Ai gjithashtu tha se herezia është mëkat. As kjo nuk e dija ç'ishte. E pyeta çfarë do të thoshte ajo, dhe ai më tha se ishin veprimtaritë e spiunazhit. Tani që i mendoj këto, unë nuk dija shumë gjëra.

Por edhe përpara se të lutesha me të dyja duart e bashkuara, unë kisha jetuar me ndershmëri. Ndihesha sikur qielli po më ruante. Unë nuk e duroja dot keqdashjen e as nuk mund ta mallkoja dikë. Po pyesja veten nëse edhe ato ishin apo jo mëkate.

Kishte raste kur blija diçka dhe ma kthenin kusurin gabim. Më takonte të merrja njëqind uon mbrapsht, por më jepnin dyqind uon. Unë gjithnjë i ktheja ato. Kjo gjë konsiderohej thjesht marrëzi mes koreanoveriorëve. Por unë nuk mund ta lija veten të bëja ndonjë gjë gabim. Burri im gjithmonë më mësonte të mos bëja asgjë gabim, dhe unë nuk mund të gaboja edhe sikur të doja.

Mund t'ju tingëllojë e pazakonshme që një burrë e grua të flenë bashkë, të bëjnë fëmijë bashkë, dhe të bëjnë lutjet me dy duart e bashkuara së bashku, e përsëri të mos kenë një bisedë të thellë ku gruaja mund të pyesë: “Po për çfarë, ta hajë e mira, e ke fjalën? Unë nuk mund ta kuptoj as gjysmën e asaj që po thua.” Por është e rëndësishme ta kuptoni se Koreja e Veriut është e pazakonshme në këto gjëra. Burrat e gratë duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur flasin me njëri-tjetrin. Duhet shumë vjet përpara se ata t'i zënë besë njëri-tjetrit mjaftueshëm, sa të flasin për gjërat e thella si besimi.

Njerëzit më pyesnin sesi mund ta ndihmoja e ta respektoja aq shumë bashkëshortin tim, sidomos pas gjithë atyre gjërave të çuditshme që më tha ai. Por prindërit e mi më kishin mësuar mirë. Unë kurrë nuk e ngacmoja bashkëshortin tim përpara shokëve të tij. Ne madje e ndanim mes nesh një gotë uji ose një tas orizi, me qëllim që vizitorët të mund të kishin më tepër për të ngrënë dhe të mos largoheshin nga shtëpia jonë pa një gostitje. Mua gjithnjë më pëlqente t'i gostitja të tjerët me një vakt ushqimi dhe t'u jepja diçka me vete kur largoheshin. Për këtë arsye miqtë e tim shoqi më pëlqenin mua.

Por në Korenë e Veriut, njerëzit duhet të jenë tejet të kujdesshëm kur flasin me miqtë e vjetër. Nuk ka ilustrim më të mirë të kësaj, sesa ngjarja lidhur me arrestimin dhe dërgimin në burg të tim shoqi, vetëm e vetëm për shkak të një komenti të vetëm që i bëri një miku në nevojë dikur, thjesht duke u përpjekur ta ndihmonte. Ky mik na pyeti sesi ia dilnim ne të kishim një jetë të lumtur. Ai nuk kishte një marrëdhënie të mirë me bashkëshorten e vet. Dukej se ai kishte rënë në dashuri me dikë tjetër kur ishte i ri. Për këtë arsye ai nuk trajtohej mirë prej bashkëshortes së vet, dhe ai donte ta dinte sesi jetonim ne së bashku pa konflikt. Bashkëshorti im tha: “Ne mund të jetojmë bashkë pa konflikt për shkak se Perëndia është me ne në këtë botë”, - dhe ai i shpjegoi Dhjetë Urdhërimet. Kaq mjafton në Korenë e Veriut për të përfunduar i ulur mbi dyshemenë e ftohtë të një burgu për më tepër se një vit, pa u akuzuar akoma formalisht.

Mendoj se arsyeja që Perëndia e lejoj bashkëshortin tim të arrestohej në atë çast ishte që Perëndia të më mësonte mua si të lutesha. Burri im ishte në burg për më tepër se një vit, por askush nga familja e tij nuk bëri vizitë te departamenti shtetëror i sigurisë politike për ta parë atë. Unë isha e vetmja që vinte vërdallë për tim shoq.

Nuk e kuptova kurrë këtë gjë, kështu që një ditë fola me vjehrrën time. Ajo tha: “Ai nuk mund të shpëtohet me fuqinë e njeriut. Fuqia e njeriut është e padobishme.” Kunata ime më tha të njëjtën gjë. Për herë të parë, një lutje me dy duart e bashkuara befas më erdhi ndërmend lehtësisht. I thashë kumatës sime: “Atëherë, ne duhet të lutemi.”

Ishte shumë e çuditshme që unë madje dija të lutesha. Unë as që e dija rendin ose procesin për lutjen. Unë nuk isha një besimtare e mirëtrajnuar. Por ajo që jam duke kuptuar tani është se lutja nuk është për t'i kërkuar Perëndisë të më japë këtë gjë ose atë tjetrën. Mendoj se lutja është si një urim nga thellësia e zemrës për t'i kërkuar Perëndisë ta zgjidhë një situatë të mjerueshme. Në

atë kohë, unë as që mund të flija. Rrija zgjuar duke u shqetësuar se mos tim shoq e qëllonin për vdekje, duke menduar sesi mund të isha në gjendje unë ta shpëtoja atë. Unë nuk dija si të lutesha, kështu që thjesht vazhdoja të thosha: “Perëndi, nëse ti ekziston, të lutem na ndihmo. Të lutem mos lejo që ai të vdesë. Të lutem që ai të kthehet në shtëpi.”

Ai ishte në burg për më tepër se një vit, i paakuzuar, e megjithatë i dënuar për t’u ekzekutuar prej një skuadre pushkatimi; prapëseprapë, ai më në fund u lirua i gjallë! Pas lirimit të tij, vjehrra ime na erdhi për vizitë. Tani që im shoq ishte një ish-i burgosur, do të kishte qenë shumë më e vështirë që ne të merrnim leje zyrtare për t’i bërë vizitë asaj, gjë që mund të ngrinte dyshime. Prandaj unë isha shumë falënderuese që ajo që në gjendje të vinte të na shihte. Kishte shumë gjëra që unë doja t’i ndaja me të, dhe madje shumë më tepër gjëra për të cilat doja ta pyesja. I tregova vjehrrës sime sesi kisha qenë duke u lutur vazhdimisht pas arrestimit të tim shoqi. I tregova asaj se unë mendoja që ai ishte liruar për shkak të lutjeve të mia. Im shoq dhe vjehrra ime qeshën me ato që thashë unë, ndërkohë që në atë kohë nuk isha fare besimtare me njohuri. Por unë prapëseprapë mendoj se im shoq është i gjallë dhe u lirua ngaqë unë u luta aq fort. Perëndia e bëri këtë për mua meqë isha aq e mjeruar. Kunata ime në fakt nisi të më besonte mua. Pastaj, edhe im shoq më besoi mua. Dhe ky ishte momenti kur ne vendosëm t’i ungjillizonim njerëzit.

Vjehrra ime donte që unë ta kuptoja gjithçka për krishterimin, prandaj ajo bëri atë udhëtim të gjatë për të ardhur të na shihte. “Në fillim, Perëndia krijoi qiejt dhe tokën...” Edhe pse isha e sëmurë dhe shumë e lodhur, unë ende e kujtoj gjithçka që mësova prej vjehrrës sime. Ajo nuk më lejonte të shkoja të flija deri në orën tre të natës. Por unë isha e apasionuar dhe nuk dremitja fare.

Kur iku, vjehrra ime më dha tridhjetë mijë uon. Tridhjetë mijë uon nuk është ndonjë sasi e madhe parash, por ajo tha se nuk mund të largohet pa më dhënë diçka. Por pastaj ajo më dha diçka

Këta janë brezat

me vlerë shumë më të madhe. Ajo më tha: “Unë të besoj ty. Do të kthehem më vonë.” Këto janë fjalë të thella në Korenë e Veriut.

Ajo nuk mund të mbartte libra kur hynte në Korenë e Veriut apo kur lëvizte brenda vendit, prandaj i duhej t’i mësonte përmendësh të gjitha himnet dhe këngët për ungjillin që i mësonte sa herë vizitonte një kishë koreano-kineze në verilindje të Kinës. Gjithsesi ajo ma sollti një broshurë të vogël. Titulli i broshurës ishte Material për një Besimtar të Ri. Në kapakun e librit, ishte vizatuar një pemë xhinko. Atje ishte Jezusi, dhe dymbëdhjetë dishepujt ishin ulur pranë një shkëmbi. Ajo e fshehu librin brenda të mbathurave të saj, duke e futur kontrabandë në Korenë e Veriut për të ma dhënë mua.

Ajo gjithashtu më mësoi si t’i këndoja himnet dhe këngët për ungjillin që ajo kishte mësuar. Përveç këtyre, ajo më tregoi si të pendohesha dhe si të lutesha. Nganjëherë pas kësaj, ajo shkonte në Kinë dhe pastaj kthehej shpejt tek ne. Nganjëherë ajo nuk ishte në gjendje të vinte tek ne. Por kurdoherë që ajo mësonte disa himne ose këngë për ungjillin, herët a vonë ajo vinte në shtëpinë time për të m’i mësuar. Ajo me të vërtetë që ishte një grua madhështore.

Kur vjehrra ime nisi të ndante ungjillin me mua, unë sinqerisht nuk mendoj se kisha besim. Por ndihesha se isha siguruar prej dikujt. Jeta ime ishte e vështirë dhe e ndërlikuar, por unë gjithnjë mendoja se ishte dikush tek i cili unë mund të mbështetesha. Por kur im shoq u arrestua, nuk kisha askënd tek i cili të mbështetesha. Përgjatë tërë jetës sime, kisha menduar se isha shumë e urtë dhe e shkëlqyer dhe se kisha arritur gjëra të mëdha përmes udhëheqjes. Mendoja se isha mjaftueshëm e mirë. Por ato lloj mendimesh vinin ngaqë unë nuk e njihja Perëndinë. Unë kisha vetëm një arsim xhushe (Juche). Teksa e dëgjova ungjillin, kuptova se të gjitha nderimet e gjithçka që kisha marrë ishin dhurata prej Perëndisë. Pa të, unë nuk kisha bërë asgjë. Pa të, unë nuk mund të bëja asgjë.

As im shoq nuk mund të bënte gjë. Madje edhe pas lirimit të tij nga burgu, për një vit të tërë ai nuk mund të bënte dot as edhe një gjë të vetme. Në burg ai kishte qenë ulur për tërë kohën dhe nuk i kishte përdorur këmbët për më shumë se një vit.

Njëherë unë bëra një ndërhyrje kirurgjikale. Kur u futa në dhomën e operacionit, kisha besim të plotë se nuk do të vdisja. Nuk e shpreh dot sesi, por hyra në dhomën e operacionit me besim. Im shoq tha se atëherë ai u lut shumë për mua. Unë i thashë: “Edhe unë u luta shumë. U luta për një operacion të suksesshëm. Nëse Perëndia ekziston, ai nuk do të më lejojë të vdes.” Ai thjesht qeshi. Ma ha mendja se besimi im po rritej.

Një ditë, unë shkova për vizitë tek vëllai i vjehrrës sime. Djali i tij ishte profesor në një kolegji dhe ai kishte një libër. Ishte një libër i trashë, si enciklopedi, dhe kishte informacion për Perëndinë. Kishte shumë pak ndryshim mes atij libri dhe gjërave që kisha mësuar prej vjehrrës sime. Ajo më kishte mësuar mua për Adamin dhe Havanë, që është emri i Evës në gjuhën koreane. Kurse ky libri e quante atë Eva, me emrin e saj në anglisht. Libri kishte lloj-lloj informacioni në të mbi politikat botërore, Korenë e Veriut, Korenë e Jugut, njohurinë e zakonshme, cili lumë është më i gjati ose më i shkurtri, cili mal është më i larti ose më i ulëti, sasinë mujore të shiut, emrat e presidentëve dhe gjenealogjinë e tyre. Ai gjithashtu mbulonte krijimin prej Perëndisë të qiellit dhe tokës, si dhe Dhjetë Urdhërimet.

Përmes dishepullizimit të vjehrrës sime dhe librave si ky, unë po filloja të kuptoja më qartë. Edhe pse isha besimtare e re, unë i lexova këta librat dhe i përdora të gjitha dhuntitë e mia për të mësuar përmendësh dhe për të studiuar që ta thithja informacionin. Unë u bëra e ditur. Lexova aq shumë, sa që im shoq mendoi se mos po më ikte mendja.

Vjehrra ime nuk mundte dot të na vizitonte shumë shpesh, kështu që kishte shumë gjëra që nuk i dija. Nisa ta kuptoja se e gjithë etika e arsimit në Korenë e Veriut në fakt bazohej në Bibël.

Këta janë brezat

Ata thjesht e kishin kopjuar dhe shtrembëruar gjithçka që mësonte Bibla për pothuajse çdo gjë.

Që nga ajo kohë, familja ime ngriti një mur ndarës ndaj botës. Ne nuk morëm pjesë në aktivitetet e detyrueshme për ditëlindjen e Kim Il Sungut, ku të gjithë koreanoveriorët vendosin lule në këmbët e statujës së tij. Ne këndonim himne, jo këngë jofetare. Natyrisht, ne nuk mund t'i lejonim njerëzit e tjerë që të na dëgjonin kur këndonim, kështu që shkonim të këndonim me zë të ulët në fushat e gjera, kur ato ishin pa njerëz. Çdo mbrëmje, ne e mbyllnim derën dhe mësonim përmendësh Lutjen e Zotit dhe Kredon e Apostujve. Në çdo fushë të jetës sonë, ne nuk ndiqnim mësimin e Kim Il Sungut, por Dhjetë Urdhërimet e Perëndisë. Ne nuk e dinim çfarë lloj vendi ishte një kishë, ose si dukej një shërbesë kishe. Por çdo të diel, ne mblidheshim dhe thoshim përmendësh Kredon e Apostujve, këndonim himne, luteshim duke thënë Lutjen e Zotit, dhe pendoheshim sipas Dhjetë Urdhërimeve. Po të kishte ndonjë gjë që nuk e dija për ndonjë nga traktet, pyesja tim shoq. Ai nuk i dinte të gjitha përgjigjet, por gjithmonë bënte më të mirën që të kujtonte gjërat që kishte dëgjuar prej gjyshit e gjyshes që nga fëmijëria e tij. Ai vetë kishte dëshmuar plot gjëra, kështu që gjithmonë përpoqej të m'i tregonte në mënyra interesante.

Ne e rrëfenim po të kishim bërë ndonjë gjë gabim. Vjehrra ime më kishte mësuar si të luteshim për pendim, si të luteshim për falënderim, dhe si të luteshim për ushqimin. Materiali nga kisha gjithashtu më kishte mësuar si të lutesha. Ishte shumë i thjeshtë, i qartë dhe i detajuar. Gjërat që mësuam prej tyre u bënë mënyra jonë e jetesës. Ne e bënim këtë çdo të diel. Ne nuk dinim si ta mbyllnim adhurimin, kështu që bënim Lutjen e Zotit së bashku dhe këndonim disa himne. Një person drejtonte këngët dhe pjesa tjetër e familjes e ndiqte.

Kur vjehrra na vinte për vizitë, ne luteshim për ushqimin. Ne luteshim: "Perëndi, faleminderit që na jep bukën e përditshme. Faleminderit. Zot, të lutem na udhëzo që të mos mëkatojmë."

Ne i dishepullizuam fëmijët tanë që të lutem në këtë mënyrë. Unë gjithashtu i dishepullizova fëmijët e mi që t'i lutem Perëndisë për çfarëdo gjëje që kishin në mendje dhe për çdo gjë që ata kërkonin. Im shoq dhe unë lutemi ashtu. Ne kemi kaluar tërë natën duke u lutur ashtu së bashku. Nuk jam e sigurt, nëse ishte për shkak të lutjeve tona apo jo, por jeta jonë ishte shumë e qëndrueshme krahasuar me atë të tjerëve.

Më lejoni t'ju tregoj sesi e jepnim të dhjetën ne. Në Korenë e Veriut nuk ekziston asnjë kishë. Nuk ka asnjë vend ose asnjë pastor ku mund ta oferojmë të dhjetën tonë. Por vjehrra ime e theksonte rëndësinë e dhënies së të dhjetës. Kështu që edhe pse ne nuk e dinim si ta ofronim të dhjetën tonë, ne gjithmonë e jepnim—duke e përdorur atë për t'i ndihmuar të tjerët.

Kur të varfrit nuk mund të paguanin për mjekimin ose për trajtimin mjekësor, ne thjesht kujdeseshim për ta. Ne u jepnim atyre mjekime, edhe sikur të humbnim për vete. Ne blinim oriz për të uriturit, dhe i linim ata të na paguanin më vonë. Ua jepnim rrobat tona të tepërta të tjerëve. Kur blinim ushqime, nuk merrnim asnjë kusur prej plakave ose nënave me fëmijë. Kur na peshonin perimet në peshore, thjesht u zinin besë atyre. Ne nuk e vinim në dyshim sasinë.

Dhe i konsideronim të gjitha këto gjëra si ofertën tonë të së dhjetës. Ne e quanim atë “ungjillizim” por nuk mund ta thoshim atë fjalë me zë të lartë. Kur u shkonim për vizitë vëllezërve e motrave tona, ata lumturoheshin nëse u shpinim diçka. Ne nuk kishim mjaftueshëm, por gjithmonë përgatisnim diçka për vëllezërit e motrat tona. Ne sillnim mjekime, ose i gostitnim kur u shkonim për vizitë.

Të gjitha format e idhujtarisë gjithashtu nuk kishin vend te ne. Vjehrra ime e urrente faktin që të krishterët vizitonin shamanët dhe u përulëshin statujave të njerëzve të vdekur. Ajo tha se ne nuk duhet t'i bënim këto gjëra. Kështu që nuk i bënim ato.

Në fillim, kur nisëm t'i ungjillizonim vëllezërit e motrat tona, ata thanë; “A jeni të marrë?” Disa besuan shumë shpejt, kurse disa

nuk besuan. Disa thanë se ishte një gënjeshtër. Gjithsesi, më në fund, ata krahasonin jetët e tyre me tonën dhe nisën ta kuptonim se ne kishim të drejtë. Ata e kuptuan se mosbesimi ishte arsyeja që Koreja e Veriut ishte kaq e varfër, pavarësisht sesa shumë përpiquej Kim Jong Ili që ta bënte vend të begatë. Deri në momentin që u larguam nga Koreja e Veriut, ne u mësuam atyre: Perëndia ekziston, Perëndia është përmbi Kim Jong Ilin, ne nuk duhet ta adhurojmë Kim Jong Ilin, ne duhet të mbështetemi tek Perëndia kur jemi në vështirësi, ne nuk duhet të mëkatojmë, ne duhet ta falënderojmë Perëndinë për ushqimin dhe veshjet, ne duhet t'u gjendemi fqinjëve tanë, e kështu me radhë. Ne nuk mund të arrinim gjithkënd, por i ungjillizuam njerëzit përbrenda kornizës së familjes.

Ata bashkoheshin shpesh me ne në lutjet për ushqimin. Ata nuk na raportuan tek autoritetet ngaqë ishin pjesë e familjes. Dhe ne nuk i lejonim ata të hanin ushqim pa lutje. Ne nuk mund t'ua thoshim të tjerëve, por në familjen tonë e kuptuam se adhurimi i Kim Il Sungut dhe Kim Jong Ilit ishte idhujtari. Ne u thoshim atyre: “Mos kini perëndi të tjera në praninë tonë. Bindjuni vetëm Perëndisë. Askush nuk është i shenjtë, përveç Perëndisë. Mos dëgjoni të tjerët.” Ne i ungjillizuam ata, pavarësisht se nuk dinim si ta bënim këtë.

Familja jonë më në fund vendosi që të arratisesh nga Koreja e Veriut për shkak të tim shoqi. Departamenti shtetëror i sigurisë politike vazhdoi ta monitoronte atë. Ne do të ishim njerëz të lehtë për t'u kapur për shkak se na mbanin nën vëzhgim të fortë.

Kriminelët fetarë lidheshin me zinxhirë dhe dërgoheshin në një kamp përqendrimi. Dhe pastaj ishin edhe fëmijët tanë. Ngaqë i dishepullizonim fëmijët tanë si të krishterë në shtëpi, ne merakoseshim se mos ata bënin gabime kur ishin jashtë shtëpisë. Ata ishin shumë të pafajshëm. Kështu që vendosëm të arratiseshim nga Koreja e Veriut për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Ishte shumë e vështirë të mendonim për largimin. Në fund të fundit, ky ishte vendi i vëllezërve e motrave tona dhe nënave e

baballarëve tanë, i gjyshërve dhe i gjysheve. Por në lidhje me besnikërinë, Zoti më kishte dhënë mua atë që prindërit e mi tokësorë nuk mund të ma jepnin kurrë. Prindërit e mi tokësorë më kishin dhënë çdo grimcë dashurie dhe ishin përpjekur aq sa mundën të më donin, pa kursyer asgjë. Por tani unë jetoja me një zemër të mbushur me falënderim për Zotin që gjithmonë është me ne, na ruan gjithnjë dhe na drejton gjithnjë. Teksa po i shihja malet e parandjenjave, që asnjë këmbë nuk kishte guxuar t'i përshkonte, ku shumë shpejt këmbët e mia dhe ato të fëmijëve të mi do të ndiqnin shtegun ku kishte ecur muaj më parë im shoq kur iku nga vendlindja jonë, unë ruajta në zemër një thesar nga Bibla, Isaian 41:10: Mos ki frikë, sepse unë jam me ty; mos u trondit, sepse unë jam Perëndia yt. Unë do të të forcoj dhe do të të ndihmoj; unë do të të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.

Është një dhuratë që asnjë prind tokësor nuk mund ta japë.

KAPITULLI PESË

Familja: Emanueli

Nga Znj. Bae

Një ditë të vonë nëntori në 2009-n, ime bijë, im bir dhe unë dolëm nga dera e përparme e shtëpisë sonë në Korenë e Veriut dhe nuk e kthym kurrë kokën pas. U nisëm drejt maleve (ose më saktë, iu ngjitëm maleve). Arsyeja përse vepruam kështu është se ne nuk kishim lejen e domosdoshme prej qeverisë së Koresë së Veriut për të udhëtuar, që do të na kishte mundësuar për të kaluar lirshëm përmes qyteteve të Koresë së Veriut përgjatë rrugës sonë ose për të hyrë në mënyrë të ligjshme në Kinë. Kushdo që dëshiron të udhëtojë kudo brenda Koresë së Veriut duhet të ketë një dokument udhëtimi—një tip pasaporte të brendshme me një vulë zyrtare mbi të. Duhet muaj për ta marrë atë, kushton njëqind a më shumë dollarë për person, dhe pothuajse me siguri që nuk do t'i ishte dhënë bashkëshortes dhe fëmijëve të një burri që ishte arratisur së fundmi. Kështu që ne iu drejtuam maleve.

Bashkëshorti im u largua disa muaj para nesh, për të zbuluar rrugën më të mirë dhe për ta përgatitur shtegun për ne. Përgjatë rrugës sonë, në ato vende të pakta ku mikpritja dhe situata e sigurisë ishin të mira, ai na udhëzonte me më të mirën që mundte përmes telefonatave domosdoshmërisht të shkurtra nga telefoni celular. Natyrisht që ishte e vështirë ta zgjidhnim rrugën tonë përmes maleve e qyteteve të panjohur dhe përmes pikave të kontrollit duke u mbështetur vetëm në udhëzimet që na jepeshin me nxitim përmes telefonit. Duhej që Perëndia të ishte Udhërrëfytesa ynë.

Ne ecnim tërë ditën, çdo ditë. Një ditë, në një qytet të Koresë së Veriut me siguri jo aq të fortë, ne qemë në gjendje të siguronim një makinë për të na transportuar për disa orë pa na u dashur të paraqitnim ndonjë leje. Një ditë tjetër, në një fshat tjetër rrëzë një grumbulli malesh, ne vizituam një shtëpi dhe u thamë atyre se po shkonim në një qytet pranë kufirit për të vizituar vjehrrën time dhe i kishim humbur lejet tona të udhëtimit. Ata na drejtuan me mirësi për tek stacioni i trenit. Siç është tipike për Korenë e Veriut, ne duhej të prisnim dhjetë ditë për atë tren; edhe atëherë nuk mundëm të shkonim shumë larg me anë të tij.

Megjithatë, këto ishin ditët e jashtëzakonshme. Shumicën e kohës ne thjesht ecnim—ose më mirë ta themi, u ngjiteshim maleve, ngaqë 70 përqind e territorit të Koresë së Veriut përbëhet nga malet, dhe malet shërbejnë si rojtarë në ato hapësira të pakta që nuk mbulohen prej rojeve, policëve e agjentëve të sigurisë në Korenë e Veriut.

Kur e mendoj duke hedhur vështrimin pas, më duket e pabesueshme që mbijetuam. Akoma pyes veten sesi ndodhi e gjitha kjo. Pyjet në malet ku ne u ngjitëm ishin aq të dendura e me degë të koklavitura, saqë në shumë raste, ne nuk mundnim dot as ta shihnim qiellin mbi kokat tona. Më shumë nga sa ju (ose unë sot) mund ta imagjinoni, ne shtynim përpara ngadalë e me dhimbje përmes reshjeve të ftohta të dëborës, trashësia e së cilës na vinte deri në gjoks. Nuk kishim zgjedhje tjetër, asnjë udhëzim për të shkuar diku, përveçse t'i binim përmes.

Ngaqë im shoq nuk ishte me ne, nuk kishte asnjë person të cilin unë e fëmijët e mi të mund ta thërrisnim të na ndihmonte kur kishim vështirësi—përveçse Perëndinë. Dhe unë besoj se Perëndia eci përkrah meje gjatë atyre ditëve të pasosura në një mënyrë aq të pranishme dhe reale, sa edhe fëmijët e mi që i shihja. Në Bibël, profeti Isaia bërtiti: “Emanuel”—Perëndia me ne—dhe i tillë ishte Perëndia për ne, duke ecur me ne, pothuajse gjithmonë i panjohur prej nesh, ashtu si Krishti në rrugën për në Emaus.

Vetëm se ne ecëm shumë më larg sesa për në Emaus, dhe rruga jonë ishte shumë më e kushtueshme. Kur niste të errej çdo ditë, ne i drejtoheshim fshatit më të afërt dhe rrinim në cilëndo shtëpi që na dukej më e sigurta, në këmbim të pagesës. Unë i kërkoja ndihmë pronarit të çdo shtëpie, duke i thënë se vjehrra ime jetonte pranë kufirit dhe duke i rrëfyer se ne praktikisht kishim humbur rrugën për atje—gjë që ashtu ishte në të vërtetë. Në secilin vend, Perëndia siguroi që një njeri ose familje të ishin të gatshëm të na lejonin ta kalonim natën në shtëpinë e tyre për afro një dollar—një mrekulli e përditshme e mikpritjes, duke e ditur sesa e rrezikshme mund të jetë të futësh një të panjohur në shtëpinë tënde në Korenë e Veriut.

Asnjëra nga familjet nuk kishte shumë para, dhe një dollar mjaftonte për të blerë një kilogram oriz—sa për të ushqyer një familje për një ditë. Ata na jepnin edhe ushqim—nganjëherë më shumë ushqim nga sa ne mendonim se mund të hanim. Ne koreanove-rriorët mund të kemi qenë të gjithë në gjendjen pranë të vdekurit urie, por shumica prej nesh ende kapeshim fort pas sjelljes sonë të njerëzishme, ende bënim më të mirën tonë për të treguar përkujdesje dhe mikpritje, ende kërkonim t'i vazhdonim zakonet që i kishim mësuar prej rinisë sonë.

Dhe ishte gjë e mirë që secila familje ishte aq mikpritëse, sepse neve na duheshin sa më shumë lëndë ushqyese që mund të merrnim. Në atë kohë vajza ime ishte shtatzënë—dhe siç ndodh shpesh me ata që arratisen, asaj iu desh ta linte të shoqin në shtëpi, përndryshe atij do t'i duhej ta sillte gjithë familjen e vet gjithashtu—dhe ju do ta mbani mend se shëndeti im ishte betejë e vazhdueshme. Dhe djemtë në Korenë e Veriut nuk janë ndryshe nga djemtë kudo tjetër—ata gjithmonë kanë nevojë të hanë.

Çdo agim dite sillte një ndarje me mikpritësit tanë, të pasuar me një ditë tjetër të mundimshme me ecje e ngjitje mali duke u fshehur. Në ditën e tetë, ne kaluam trembëdhjetë postbllqe—ato po shtoheshin teksa po i afroheshim kufirit. Gjithçka që kishim me vete ishin disa ndërresa rrobash dhe gjërat më minimale të

domosdoshme, gjë që patjetër na bënte të dukeshim të dyshimtë. Kurdoherë që dikush na pyeste për ku po shkonim, ne i thoshim se po shkonim të vizitonim prindërit e burrit tim që jetonin pranë kufirit. Pavarësisht nga numri i rojeve përmes të cilëve kaluam, ata kurrë nuk u duk sikur na vunë re dhe nuk na kërkuan dokumentacionin.

Emanuel.

Gjatë ditës, unë ndaloja shpesh për t'i pyetur njerëzit për drejtim, dhe në njëfarë mënyre, Perëndia gjithmonë e rregullonte situatën që të takoheshim në njerëz të tjerë që po shkonin në të njëjtin drejtim me ne. Por problemi më i madh ishte se sa më shumë që i afroheshim kufirit, aq më të raskapitur bëheshim nga udhëtimi. Sa herë që na dilte përpara një postbllok, me qëllim që ta shmangnim këqyrjen me detaje, neve na duhej të silleshim si njerëz që ishin në një udhëtim të gëzueshëm për të vizituar të afërmit e tyre, të cilët natyrisht do të ishin të lumtur t'jua tregonin lejet e tyre të udhëtimit, nëse i ndalonit e ua kërkoni lejet, jo si vagabondë të raskapitur të cilëve u dhembte trupi prej ngjitjeve në mal përmes dëborës deri në gjoks, të lodhur përtej besimit nga përsëkrimi i kilometrave të tëra për t'i shmangur autoritetet, me sy të stërvitur drejt kufirit, me zemra të vendosura për dezertim.

Por Perëndia gjithmonë dërgoi dikë për të na freskuar dhe për t'u përkujdesur për ne kurdoherë që ne mendonim se gjithçka shkoi dëm. Përmes hirit të tij, ne madje patëm mundësinë të përhapnim dashurinë e tij gjatë udhës. Një ditë ne ndenjëm me një grua të moshës së mesme që kishte dhimbje të tmerrshme për shkak të një sëmundjeje stomaku. Unë kisha me vete ilaçe të dhëna me recetë nga mjeku për shkak të gjendjes sime të vështirë mjekësore, kështu që i dhashë asaj ca nga ilaçet e mia. Përnjëherësh gjendja e saj nisi të përmirësohej. Unë ofrova t'i jepja asaj krejt ilaçet e mia dhe një sasi parash të barasvlershme me tre dollarë, nëse ajo do të vinte me ne e do të na ndihmonte, gjë të cilën ajo qe në gjendje ta bënte për dy ditë. Udhëtimi pa leje dhe me të huaj me vete në Korenë e Veriut ishte mjaft i rrezikshëm edhe për të,

kështu që shoqërimi që ajo na bëri neve ishte vërtet një sakrificë, sidomos duke pasur parasysh sëmundjen e vet. Unë i dhashë asaj numrin e telefonit të motrës sime dhe e nxita që ta telefononte motrën time nëse do të sëmurej sërish. Ne mund të ishim duke ikur me të katra për të shpëtuar jetën tonë, por prapëseprapë ne ishim të krishterë që po përpiqeshin të shpëtonin jetën.

Gjumi që bëmë në shtëpinë e gruas në moshën e mesme ishte i ëmbël e i thellë. Kur e mendoj tani atë situatë, mund ta shoh sesi dora e padukshme e Perëndisë po e përkundte me butësi secilin prej nesh. Perëndia e dinte se ajo gruaja kishte nevojë për ilaçe, kështu që ai siguroi që ne të mos gjendeshim diku tjetër për të qëndruar në shtëpinë e tyre. Vajza ime, që ishte shtatzënë në atë kohë, kishte nevojë të flinte, kështu që ai siguroi që ajo gruaja e moshës së mesme të na dilte përpara në rrugën tonë. Dhe unë, ndoshta më shumë se gjithkush, kisha nevojë për pushim që t'i qartësoja mendimet për sfidat që na prisnin: Sa më shumë që i afrohem kufirit, aq më shumë ndryshonte dialekti dhe aq më e vështirë—dhe e rrezikshme—do të ishte t'i kërkonim ndihmë ndokujt. Roje e spiunë kishte me bollëk.

Në atë krahinë përdoren kamionë për transportin publik, jo autobusë. Për fat të keq, pa leje udhëtimi për veten e vet, gruaja e moshës së mesme nuk ishte në gjendje për të na shoqëruar më tutje. Ishim përsëri vetëm, pa asnjë njohuri për zonën vendase dhe theksi ynë gjithnjë e më shumë na etiketonte si të huaj, sa më larg shtëpisë të shkonim.

Në postbllokun e parë që hasëm, një roje u afrua për të inspektuar kamionin, ndërkohë që të gjithë ne së bashku mbanim frymën dhe përpiqeshim të dukeshim të çlodhur. Për habinë dhe lehtësimin tonë të madh, roja na kaloi të gjithëve pas jo më shumë se një vështrimi të shpejtë. Por kur erdhëm tek një postbllok i dytë—ky ishte nën drejtimin e personelit të sigurisë shtetërore—ata nisën ta shkarkonin gjithçka nga kamioni dhe ta shqyrtonin me kujdes. Zemrat po na dilnin vendit. Duhej të ishte e dukshme, sepse njëra

nga gratë e moshuara në kamion deshi të më ngushëllonte duke më pëshpëritur se, nëse asnjëri prej nesh nuk kishte bakër me vete, nuk do të kishim probleme. Bakri është shumë i vlefshëm në Kinë. Po ashtu edhe tungsteni. Kjo ishte njëra nga arsyet se pse qeveria e Koresë së Veriut i shqyrtonte me kaq shumë kujdes kamionët dhe pasagjerët për t'u siguruar se askush nuk po përpiquej t'i kontrabandonte ato minerale jashtë vendit. Për fat të mirë, asnjëri nga ne në kamion nuk kishte bakër me vete, dhe rojet na lejuan të kalonim më në fund.

Përfundimisht, ne arritëm në fshatin pranë kufirit ku jetonte vjehrra ime. Ju do ta mbani mend se ajo ishte personi që më drejtoi mua tek Zoti dhe që ishte kujdesur për ne në çdo mënyrë të mundshme gjatë vizitave të saj. Ajo ishte personi që na kishite mësuar kaq shumë gjëra në tryezën e kuzhinës sonë përgjatë shumë netëve. Ju mund të mendoni se ky do të ishte ai çasti i udhëtimit tonë ku dera e saj e përparme do të hapej me vrull dhe ne do të gëzoheshim pas një takimi të ngrohtë e të përzemërt dhe do të kishte shumë lot e lutje—ose të paktën një shtrat të ngrohtë dhe një darkë të madhe familjare. Por ju do të jeni duke harruar ku ishim ne dhe çfarë kishte ndodhur së fundmi: Im shoq sapo ishte arratisur nga Koreja e Veriut dhe tani ai konsiderohej një armik i shtetit. Shtëpia e prindërve të tij tani vëzhgohej papushim prej agjentëve të sigurisë shtetërore. Sheshi përreth qytetit ishte i ngrirë. Edhe përbrenda shtëpisë së vjehrrës sime pothuajse gjithçka ishte e ngrirë. Dhe ne vetë ishim emocionalisht të ngrirë—ne që kishim ndarë mes nesh kaq lot dhe mësim e lutje tani nuk mund të bënim më tepër sesa një bisedë të thjeshtë, duke e ditur se dikush padyshim do të ishte duke vëzhguar, duke dëgjuar e duke raportuar gjithçka.

Takimi ynë mundi të ishte vetëm për një orë. U trishtova kur u ndava me të, u trishtova që nuk isha në gjendje të bëja një bisedë të thellë e të përzemërt, u trishtova që nuk pata mundësi të merrja ato që mund të kishin qenë lutja e saj e fundit, ose nxitja dhe udhë-

zimet e fundit për mua nga kjo anë e parajsës. Prapëseprapë, unë e kuptoja plotësisht përse nuk mund të rrinim më gjatë ose nuk mund të thoshim më shumë gjëra. Tani nuk ishte koha për të qarë, ose për të festuar a për të ngritur ndonjë dyshim. Nganjëherë mjafton që thjesht të jesh në gjendje të shohësh brenda syve të dikujt tjetër.

Ja sesi unë dhe fëmijët e mi e gjetëm veten duke ndenjor përballë stacionit të trenit duke u përpjekur plot dëshpërim për t'u ngrohur. Por edhe qëndrimi atje për më tepër se një orë do t'i kishte nxitur agjentët për të hetuar, kështu që shpejt e shpejt, unë nuk pata ndonjë zgjedhje tjetër përveçse t'i drejtoja fëmijët e mi sërish tek i ftohti i acartë, në mënyrë tejet të pahijshme, teksa mendja ime vraponte duke u përpjekur për të gjetur një vend ku mund të kalonim natën.

Nuk kishte nevojë të shqetësohesha, ngaqë Perëndia ishte me ne dhe nuk e kishte fare problem që të siguronte për ne me hirin e tij përsëri. Ne takuam rastësisht një grua e cila ishte mjaft e mirë me ne sa të na tregonte një vend diku ku mund të rrinim. Ishte shtëpia e një burri, dhe në murin e tij rrinte varur një portret special i Kim Il Sungut. Sigurisht që na jepte një ndjesi të pazakontë që të ishim duke kryer dezertimin tonë nën syrin e Drejtuesit të Madh, për të cilin unë u kisha dhënë mësim besnikërisht kaq shumë vetave për një kohë kaq të gjatë.

Doli se gruaja e këtij burrit ishte arratisur për në Korenë e Jugut. Ata nuk kishin probleme në marrëdhënien e tyre, këmbënguli ai; ajo thjesht iku për të fituar para atje. Por ai po priste që ajo të kthehej, plot mall që të merrte lajm prej saj, dhe i pamartuar me askënd tjetër. Ngaqë jetonte vetëm dhe kishte nevojë të siguronte para për jetesën, ai i lejonte njerëzit që të rrinin me të. Na bëri qull ngaqë nuk kishte oriz, dhe për këtë unë nuk isha shumë e lumtur ngaqë ia kisha dhënë paratë dhe ai mund të kishte blerë ca oriz për ne. Ai tha se donte që të rrinte në Korenë e Veriut dhe të jetonte një jetë të mirë.

Megjithatë, ideja ime e jetës së mirë ishte shumë e ndryshme nga e tija dhe patjetër ajo nuk përfshinte vënien në mur të por-

treteve hyjnore të Kim Il Sungut. Edhe pse ai burri na ofroi që të rrinim më gjatë, ne e dinim se duhej të vazhdonim më tej me qëllim që të shmangnim tërheqjen e vëmendjes.

Përveç përballjes së problemit të një numri gjithnjë në ulje të opsioneve për strehim, ne kishim edhe një shqetësim tjetër të menjëhershëm: sasinë gjithnjë e më të pakët të parave në xhepat tanë. Edhe pse e kishim arritur kufirin, ne nuk kishim paratë e mjaftueshme që do të na duheshin për të kaluar lumin për në Kinë, nuk kishim paratë e mjaftueshme që do të na duheshin për ta përshkuar atë vend të madh, dhe nuk kishim paratë e mjaftueshme për të kaluar nga Kina në një vend të tretë, ku më në fund të mbërrinim në një ambasadë të Koresë së Jugut që ishte e gatshme të na pranonte dhe të na transportonte për në Korenë e Jugut. (Ambasadat e Koresë së Jugut në Kinë nuk i pranojnë koreanoveriorët nga frika e qeverisë kineze.)

Për t'i përkeqësuar gjërat, çmimi i komoditeteve përgjatë kufirit ishte paimagjinueshmërisht i lartë. Orizi, që kushtonte dy mijë uon koreanoveriorë në shtëpi, këtu kushtonte treqind mijë uon—më shumë se njëqind dollarë amerikanë! Ne i këmbuem ato pak para që patëm në jenë kinezë dhe i qepëm ato në tegelat e rrobave të djalit tim për t'i ruajtur, duke arnuar përmbi tegelat që të shmangnim zbulimin e tyre.

Ime bijë dhe unë nisëm të trajtonim të sëmurët në këmbim të parave. Ne fitonim diçka më pak se një dollar për pacient, sasi që jo vetëm nuk ishte e mjaftueshme për të paguar për kalimin e kufirit, por nuk mjaftonte as për të paguar për ushqimin ose strehimin që të na mbante të treve gjallë. E kuptova se neve do të na duhej ta kalonim lumin duke mos qenë në gjendje të paguanim për mbrojtje ose ndihmë. Dukej që ishte një lloj eksodi nga më të dëshpëruarit, ai lloj që shpesh bën që dezertorët të kapen—ose të ekzekutohen.

Ne ecëm përgjatë bregut të lumit për disa ditë, duke kërkuar për vendin më të mirë ku mund ta kapërcenim. Problemi ishte se

vendet më të mira për ta kapërcyer lumin—vendet me praninë më të paktë të policisë—mund të përkufizoheshin si vendet gjithashtu më të rrezikshme, me barriera natyrore që shërbenin si një forcë policore më vete.

Më në fund ne e zgjodhëm një vend ku do ta kapërcenim. Vendimi erdhi me shumë shqetësim për mua për shkak të shtatzënisë së vajzës sime. Me qëllim që ta kapërcenim lumin, së pari ne do të duhej të zbrisnim një faqe shkëmbore me lartësi afro 3.5 metra. Ime bijë e pa shqetësimin tim dhe më nxiti që t'i besoja Perëndisë—një këshillë që u bë shumë më e lehtë, kur gjetëm një litar atje pranë, gjë që unë e dija se ai ishte sigurimi i Zotit. Kështu që im bir u hodh i pari. Unë u hodha. Dhe ime bijë nuk ngurroi fare, duke u kacavjerrë teposhtë pa asnjë shenjë frike dhe duke nisur të vraponte çmendurisht bashkë me ne sapo arriti në fund.

Lumi ishte afro 150 metra i gjerë tek ajo pikë, dhe neve na duhej që thjesht të hidheshim në lumë e të notonim përmes tij sa më shpejt të mundnim, duke mos e marrë parasysh ujin e ftohtë që të priste gishtat, dhe ndikimin e mundshëm në shtatzëninë e vajzës sime. Zërat e fundit që dëgjova në Korenë e Veriut ishin bërtitjet e njerëzve në qytet që thërrisnin: “Kapini ata! Kapini ata!” Ndoshta Perëndia nuk e ndau saktësisht në mes lumin për ne, por ai i kufizoi ata që kërkonin të na lëndonin ne, derisa mundëm të dilnim të sigurt matanë. Ky ishte udhëtim si i eksodit.

Kush mund ta harrojë atë pamjen e parë të tokës jashtë Koresë së Veriut? Ne u përshëndetëm nga një shkëlqim i dritave të Krishtlindjes. Krishtlindja—pothuajse e kisha harruar fare! Lindja e Emanuelit, Perëndia me ne: Sigurisht që Perëndia është me ne.

Por nuk kishte kohë për të ndaluar, për të qëndruar, për të reflektuar ose edhe për ta falënderuar atë për këtë, sepse rojet i bien kryq e tërthor të dyja brigjeve të lumit. Gjithsesi, ishte e pamundur të mos të të binte në sy kontrasti mes larmisë mbresëlënëse të dritave në anën e kufirit kinez dhe errësirës së dendur e të pa-depërtueshme të natës koreanoveriore. Në anën e largët të lumit,

qytetarët nuk kishin asnjë ide se ishte Krishtlindja dhe natyrisht nuk kishin asnjë koncept për Perëndinë që është Emanuel.

Sapo e lamë me të shpejtë bregun e lumit dhe u orientuam, u lidhëm me një kontakt që e kishte rregulluar im shoq. Kontakti na shpuri me makinë tek një shtëpi ku pronari na dha roba të pastra dhe na udhëzoi që të hiqnim gjithçka prej xhepave tanë. Arsyeja ishte se, po të kapeshim edhe me një copë të vogël letre me shkrim koreanoverior në të, menjëherë do të ekspozoheshim si dezertorë që iknin ilegalisht përmes Kinës. Kjo është arsyeja përse kishim nevojë për roba të reja—që të dukeshim më shumë si koreanokinezë, jo si koreanoveriorë në arrati. Sa për ne, nuk kishim nevojë për asnjë shpjegim. Ne thjesht ishim të kënaqur që ishim në një shtëpi të ngrohtë në Kinë, me roba të pastra e të thata. Ne kishim sasinë e barasvlershme me 55 lekë shqiptare [60 cent të dollarëve amerikanë] në xhepat tanë dhe ua dhamë të gjitha atyre. Por ata nuk dinin gjë për lekët që i kishim qepur nëpër rrobat e tim biri.

Përpara se të mund t'i drejtoheshim qytetit, ne duhej të merreshim në pyetje me hollësi prej drejtuesve që do të na ndihmonin ne dhe dezertorët e tjerë koreanoveriorë për të kaluar përmes Kinës. Ata duhej të siguroheshin se ne nuk kishim të ngjarë të shkaktonim ndjekjen nga policia ose të ngrinin dyshime ndërkohë që udhëtonim.

Por ne kishim një plan të ndryshëm: ne morëm me qera një makinë policie! Bashkëshorti im e kishte rregulluar që një makinë e tillë të na merrte pas pesë ditësh. Me urtësi, ai e dinte që makinat e zakonshme ndaloheshin vazhdimisht për shkak se ato përdorreshin shpesh për të transportuar koreanoveriorët që arratiseshin. Kurse makinat e policisë? Askush nuk mendonte se këto makina përdorreshin për ndonjë gjë tjetër përveç kthimit të dezertorëve mbrapsht për në errësirë. Duhej të kishte qenë urtësia e Perëndisë, dhe plani funksionoi me përsosuri.

Mikpritësit tanë koreanokinezë na thanë se Perëndia do të na ndihmonte, pavarësisht faktit se ata vetë as nuk ishin besimtarë.

Këta janë brezat

Kur më në fund erdhi për të na marrë makina e policisë, mikpritësit tanë na këshilluan që të bënim sikur po flinim kur të mbërrinim te postblloku. Por ndodhi që gjatë rrugës mua më zuri keq fare makina dhe për pak sa nuk më ra të fikët, kështu që nuk m'u desh të shtiresha fare. Ata na lanë të kalonim.

Në qytetin e parë kinez ku u futëm, ne qëndruam me një grua të moshuar. Tani që po stabilizoheshim, unë nuk e mbaja dot më veten. Më doli befas nga goja kërkesa që e kisha pasur në zemrën time që kur kisha dëgjuar prej vjehrrës sime për grupet e mëdha të të krishterëve që mblidhen bashkë për të kënduar, për t'u lutur e për të adhuruar në mes të ditës—në ndërtesa që janë specifike vetëm për atë qëllim, e për asnjë gjë tjetër. E pyeta nëse mund të shkonim në kishë.

Ka disa kisha shumë të mëdha koreanokineze në verilindje të Kinës, me bashkësi që kanë pa e tepruar mijëra persona. Vende të tilla janë të mirënjohura për koreanoveriorët që arratisen, të cilëve u thuhet se nëse shkojnë tek një ndërtesë që ka kryq mbi të, ata do të marrin ndihmë. Problemi është, më shpjegoi mikpritësi ynë, se dezertorët koreanoveriorë janë kapur nëpër kisha, ngaqë autoritetet e dinë se koreanoveriorët shkojnë atje gjithë kohës.

Por për mua, ia vlente rreziku. Unë kisha pritur për kaq shumë kohë të isha me familjen e Perëndisë në shtëpinë e Perëndisë. Unë nuk mund ta imagjinoja sesi do të dukej një “kishë”, por siç doli, unë dija më shumë nga sa mendoja se dija. Ajo që dua të them është se kisha dukej tamam si ajo që ndodh në Korenë e Veriut kurdoherë që Kim Il Sungu ose Kim Jong Ili vjen në qytet. Të gjithë mblidhen së bashku dhe ofrojnë lavdërime, adhurim dhe lutje. Por në Korenë e Veriut “perëndia” është i dukshëm dhe rri ulur përpara (ose është i pranishëm përmes portretit të tij në takimet e detyrueshme javore të autokritikës).

Kurse në kishë, nuk kishte asnjë që të rrinte ulur përpara. Dhe ndryshe nga pjesëmarrja ime në takimet e autokritikës, këtu unë ndjeva paqe, gëzim, ngushëllim—dhe shenjtërinë e Perëndisë. Atë

natë titulli i shërbesës ishte: “Në Fund të Botës, Do të Vijë Dhim-bja,” gjë që pati kuptim të plotë për mua në mes të udhëtimit që po bënim. Kisha ishte aq e madhe dhe me aq shumë njerëz. Kudo vezullonin dritat. Njerëzit këndonin nga librat e himneve. Këngët e lavdërimit ishin me zë të lartë dhe të fuqishme. Unë thjesht bëja siç bënin të tjerët, krejtësisht me një ndjenjë respekti të thellë. Dukej sikur kisha hyrë në parajsë.

Gruaja në shtëpinë e së cilës po rrinim, ishte pjesë e një familjeje të krishterë. Njerëzit koreanokinezë nuk duhet t’i ndihmojnë koreanoveriorët—në fakt është një krim serioz. Qeveria kineze ofron shpërblime për koreanokinezët që raportojnë koreanoveriorët dhe ndihmojnë për kapjen e tyre. Kudo janë ngjitur fletushka që shpjegojnë ligjin. Por kjo grua bëri një përjashtim për ne, dhe na mbajti për më tepër sesa thjesht një natë. Një ndërmjetës (një udhërrëfyes i paguar që i ndihmon dezertorët koreanoveriorë të kalojnë përmes Kinës në një vend të tretë) fillon të punojë vetëm nëse ka të paktën dhjetë koreanoveriorë që janë gati për të bërë udhëtimin. Kurse ne ishim vetëm tre—vajza ime, djali im dhe unë—për nëntëmbëdhjetë ditë. Jo vetëm që ajo gruaja e krishterë nuk u ankua, por ajo dhe familja e saj rrinin zgjuar vonë netëve duke na shfaqur filma të krishterë. Një ditë ajo madje na mori mua dhe vajzën time në kishë për të dredhur flokët. Teksa i ndaj këto gjëra me ju, më lind dëshira që të mund të shkoj ta vizitoj sërish atë grua. Mendoj për të më tepër nga sa mendoj për vetë prindërit e mi.

Pastaj, në ditën e nëntëmbëdhjetë të qëndrimit në shtëpinë e asaj gruas, me udhëzimin e tim shoqi, unë dhe fëmijët e mi morëm një varkë për në një qytet tjetër në Kinë ku ishin mbledhur mjaftueshëm koreanoveriorë të tjerë që të mund ta punësonim një ndërmjetës për të kaluar përmes Kinës. Kur mbërritëm atje, grupi ishte bërë gati për t’u nisur. Një grua nga Koreja e Veriut përktheu për ne. Ata na informuan se do të na bënin kontroll në trupat tanë. Kur më udhëzuan që t’i nxirrja të gjitha paratë nga

çanta e dorës, unë veprova ashtu. Për shkak se nuk kisha shumë para, më thanë që t'i fusja prapë në çantë.

Çdo gjë u kontrollua, përfshirë edhe trupat tanë. Edhe pse kontrolluesit na i preknin trupat tanë duke pretenduar se po kërkonin këtë ose atë gjë, ne thjesht ndenjëm gojëkyçur dhe nuk u ankuam. Ne na kishin paralajmëruar se gratë duhet të rrinë gjithmonë bashkë ngaqë ndërmjetësit (që rrallë janë të krishterë, ose më keq akoma, janë të krishterë vetëm me emër) kanë namin se sillen në mënyrë të pahijshme me dezertoret femra. Kjo gjë, natyrisht më bëri të shqetësohesha për time bijë. Gjithsesi, ndërmjetësit ishin të vetmit njerëz të cilëve mund t'u besonim, kështu që gjithçka që mund të bënim ishte të mblidheshim bashkë dhe të luteshim që ata të na transportonin në rregull.

I lashë ta merrnin krejt valixhen time, duke mbajtur me vete vetëm disa palë të mbathura. Por ata i gjetën trajtimet mjekësore shtëpiake që kishte përgatitur vajza ime. Perëndia i kishte dhënë asaj dhuntinë e shërimit. Kur im shoq punonte në tregtinë ndërkombëtare, ai ia sillte përbërësit natyrorë asaj, dhe ajo i përdorte për të prodhuar ilaçe. Kontrolluesit i morën të gjitha ato: brirët e buallit të ujit, ekstraktet e opiumit, gjilpërat për akupunkturë, dhe të gjitha veglat e tjera për akupunkturën. Për perëndimorët, këto gjëra mund të duken si mjekësi e pazakontë, por në Korenë e Veriut ato mund të nënkuptojnë ndryshimin mes jetës e vdekjes. Për shembull, një ditë në udhëtimin tonë përpara se të na i merrnin mjekimet tona, ishte një djalë në një familje me të cilën ishim miqësuar. Vajza ime i përgatiti një mjekim atij, ngaqë këmbën e kishte lënduar shumë keq. Një shaman (prift mjekës) u kishte thënë se nëse djali do të shërohej prej kësaj plage, i ati i tij do të vdiste herët. Prandaj, e ëma nuk ia dha mjekimin djalit dhe ai vdiq.

Por madje edhe këto mjekime nuk kishin shumë dobi pa një libër mjekësor—na ishin dashur tre vjet që ta hartonim, teksa i mësuam traditat që na u pasuan prej të tjerëve. Në fund, edhe ai libër na u hoq nga duart. Në fakt, deri kur mbërrita në Korenë e

Jugut, të vetmet gjëra që më kishin mbetur prej jetës së shkuar ishin ora që ma kishte blerë im shoq dhe disa rroba nga Koreja e Veriut. Edhe pse nuk janë rroba aq të mira, unë ende mund të ndiej aromën e qytetit tim të lindjes në to.

Për fat të keq, udhëtimi ynë përmes Kinës pothuajse na ktheu në qytetin tim të lindjes përpara se të niseshim. Kjo ndodhi ngaqë, kur ne u futëm në tren, një nga vajzat dezertore nisi të ankohej në gjuhën koreanoveriore se donte bukë. Gjuha ishte një zbulim i sigurt i identitetit tonë dhe i arratisjes sonë. Sytë e njëzet e shtatë njerëzve në vagonin e trenit u kthyen kah saj. Im bir më nxiti të lutesha për të. Kur u luta, ajo fjeti dhe vagoni ra në qetësi. Por pasi u zgjua, ajo nisi të qante sërish, dhe ne përfundimisht na kontrolluan. Një grua e fshehu vajzën pas vetes dhe i tha rojes në kinezçe se vajza nuk kishte nisur të fliste mirë akoma. Ajo i dha atij ca para për të kompensuar për shqetësimin, dhe prej mëshirës, rreziku kaloi.

Ne ndenjëm në shtratin e sipërm në tren. Pas dy ditësh, ndër-mjetësi më në fund na dha diçka për të ngrënë. Ndoshta ai pati mëshirë për ne, ose ndoshta e kuptoi se do të ishte më pak e kush-tueshme blerja e ushqimit sesa dhënia e ryshfetit rojave, nëse ne ankoheshim. Sa për mua, edhe kur mbërriti ushqimi, unë nuk isha në gjendje ta haja atë për shkak të asaj trazire që më shkaktonte gjithmonë udhëtimi. Kështu që më kaluan nga treni në një kamion me disa burra të tjerë. Ajri përjashta më bëri të ndihesha pak më mirë. Dhe pas gjithë asaj përpjekjeje që bëmë për ta përshkuar Korenë e Veriut më këmbë, përshkimi i një distance tejet të madhe në Kinë me kamion ndërkohë që më zinte makina ishte gjithsesi një sfidë shumë më e lehtë për t'u përballuar.

Më në fund, ne mbërritëm te lumi Mekong, atje ku Kina kufizohet me Laosin. Kur mbërritëm atje, gjetëm trupin e një njeriu pranë lumit—një dëshmi që nuk donte fjalë për realitetin se rreziku ishte përsëri i kudondodhur. Ata që e panë skenën u mbushën me frikë, por përvoja na afroi të gjithëve bashkë. Skuadra veproi me

Këta janë brezat

një zemër e mendje duke ndihmuar njëri-tjetrin, ngaqë kostoja e veprimit individualisht na ishte ngulitur në mendje në mënyrë të pashlyeshme.

Mbërriti një varkë dhe familja jonë duhej të ndahej, ngaqë pjesa jonë e grupit kishte ardhur e fundit fare. Im bir dhe unë u shpëmë në një varkë, kurse vajza ime u dërgua tek një tjetër. Ne u lutëm fort që Perëndia ta mbante të sigurt atë dhe të na ndihmonte të lundronim të sigurt në lumë gjatë gjithë rrugës për në Tajlandë, ku pastaj do të shkonim në ambasadën e Koresë së Jugut.

Pas gjashtë orësh në lumë, ne ndaluan të pushonim, të hanim dhe të kalonim nga varkat kineze në ato të Laosit. Më në fund mbërritëm në destinacionin tonë, një port në Tajlandë. Unë e pashë veten të zgjidhesha si drejtuesi faktik i njëzet e shtatë dezertorëve, e ngarkuar me detyrën që të sigurohesha se ne do të rrinim të gjithë bashkë. Ngaqë nuk e dinim se ku do ta gjenim ambasadën, ne vendosëm të shkojmë të dorëzohemi në polici. Ndonëse në Kinë do të na kishin dërguar mbrapsht për në Korenë e Veriut, këtu në Tajlandë, ne e dinim se do të na mbanin në burg, por pastaj do të na dërgonin nën kujdestarinë e Koresë së Jugut.

Në burg, ne takuam koreanojugorët tanë të parë, përfaqësuesit e qeverisë që u dërguan për të na takuar. Në atë kohë, unë kisha një karficë zbukurimi me formën e një kryqi, të cilën e kisha mbajtur të fshehur kur isha në Korenë e Veriut, por tani gëzohesha që mund ta mbaja haptas. Përkthyesi i Koresë së Jugut, një i krishterë, e pa atë dhe më përshëndeti me gëzim. Ndërkohë që shumë koreanoveriorë vijnë në njohjen e Krishtit gjatë udhëtimit të dezertimit, karfica ime zbukuruese sinjalizonte se unë isha bërë e krishterë që përpara dezertimit tim. Më vonë ne do ta zbulonim sesa e rrallë ishte kjo gjë, duke mësuar nga shumë koreanojugorë se ne ishim të vetmit koreanoveriorë që ata kishin takuar, të cilët ishin të krishterë praktikantë përbrenda Koresë së Veriut përpara se të vizitonin Kinën. Kjo ndodh ngaqë shumica e të krishterëve praktikantë në Korenë e Veriut përfundojnë në kampet e përquen-

drimit ose në burgje, siç i ndodhi tim shoqi. Sërish u kujtova se vetëm Perëndia—që duhej të kishte pasur një qëllim për dezertimin tonë—mund ta kishte bërë të suksesshëm udhëtimin tonë.

Ne qëndruam në burgun tajlandez atë natë, siç është e zakonshme për të gjithë dezertorët koreanoveriorë. Qeveria e Koresë së Jugut duhet t'i spastrojë spiunët prej Koresë së Veriut, për të mos përmendur koreanët kinezë që pretendojnë se janë koreanoveriorë, në përpjekje për t'u rivendosur në Korenë e Jugut. Kështu që procesi i marrjes nën hetim ishte mjaft intensiv dhe, siç do ta zbuloja, edhe mjaft i shtrenjtë.

Unë mendova se ne do të ishim në burg vetëm për atë natë. Por kur shkuam në gjyq, një polic erdhi afër meje dhe më tregoi një dokument e më tha: “Ju po qëndronit ilegalisht në Tajlandë. Paganani gjobën.” Kështu që ne përgatitëm pothuajse njëqind dollarë secili. Për fat të keq, ne nuk mund ta kuptonim sesi, kur dhe kujt t'ia paguanim atë “gjobën,” kështu që përfunduam në burg edhe për pesë ditë të tjera, gjë që kushtonte dy dollarë të tjerë për person në ditë. Prapëseprapë ne nuk u ankuam. Burgu kishte batanije të mira dhe dysHEME të mira, dhe ne mund të bënim dush me ujë të pastër. Sa për ushqimin, nuk na pëlqente shumë era e tij, kështu që prisnim për të ngrënë deri në darkë, kur mund ta mbulonim gjithë ushqimin me salcë piperi të kuq, pa fyer askënd. Im bir nisi të shtonte në peshë, ngaqë po ushqeheshim kaq mirë. Koreanoveriorët do të ishin të gatshëm të jetonin përgjithnjë në atë burg, po t'ua kërkoje atë gjë.

Megjithatë, nuk i kishim hedhur pas krahëve të gjitha vësh-tirësitë. Ne u transportuam në një burg të dytë, që ishte më i ngjashëm me një burg prej vërteti. Siç dukej, atje shumë koreanoveriorë vdisnin urie prej mungesës së parave dhe të ndihmës. Dezertorët e përkujdesshëm, që kishin qenë atje përpara nesh, kishin skalitur mesazhe në mur për të na treguar sesi të mbijetonim dhe të dilnim gjallë prej atij vendi—kë të paguanim, sa ta paguanim, ku të shkonim dhe ku të mos shkonim. Rrëqethja më

e madhe ishte kur im bir gjeti një mesazh atje që ishte gdhendur prej tim shoqi në përpjekje për t'i ndihmuar ata që do ta pasonin atë—ndoshta specifikisht ne. Shkruhej: “Duhet para për të ardhur në burgun tjetër[.] Duhet 650 uon për biletën e autobusit. Nëse nuk e paguani, do të vdisni urie.”

Ngaqë ne i kishim paratë, duhej të rrinim vetëm një ditë atje, përpara se të na dërgonin në Bangkok. Nëse e gjitha kjo tingëllon si një vorbull e paorganizuar, është për vetë faktin se ashtu ishte vërtet—dhe ende ashtu është, për secilin dezertor koreanoverior që e bën atë udhëtim. Në një çast ata do të na shpinin në një restorant në Bangkok dhe do të na shërbenin një vakt mjaft të mirë, dhe minutën tjetër, do të na shpinin në një “kamp” për dezertorët koreanoveriorë, ku jeta ishte e tmerrshme. Pastaj na dërgonin në një ndërtesë ku mbaheshin të gjithë llojet e të huajve—lypësit dhe pleqtë që nuk kishin asgjë, por që dalëngadalë lundronin teposhtë deltës së Mekongut për në Bangkok duke kërkuar diçka. Vendi ishte i tejmbushur me njerëz, përtej të kuptuarit, dhe ne nuk kishim asnjë ide për sa kohë do të duhej të qëndronim atje. Orë? Ditë?

Kur je dezertor, askush nuk ka përse të të tregojë asgjë. Ti thjesht shkon atje ku të detyrojnë të shkosh, rri më këmbë atje ku të detyrojnë të rrih më këmbë, nuk e vret mendjen kur të kontrollojnë vazhdimisht, dhe lutesh që Emanueli të qëndrojë më ty dhe ta mbajë bashkë familjen tënde. Dhe lutesh duke ndenjtur realisht mbi një rën këmbë, sepse qelia është tepër e stërmbushur me njerëz e nuk ka vend ku t'i vësh të dyja këmbët për tokë. Më në fund, unë u dorëzova dhe pagova dy dollarë për të hyrë tek një zonë posaçërisht e rezervuar, kur mund të ulëshim më në fund.

Përfundimisht, pas afro tre orësh, një person nga ambasada e Koresë së Jugut erdhi e na shpuri në një vend ku mund të rrinë vetëm dezertorët e Koresë së Veriut. Ata na ulën në rreshta. Drejtuesi i Koresë së Jugut atje kishte një qëndrim arrogant. Ai më udhëzoi që të shkruaja një rezymë, që unë e shkrova. Duke qenë se vajza ime ishte shtatzënë, unë e ndihmova atë të rehatohej, që

të mund të çlodhej, por m'u desh të isha pak e pasjellshme ndaj të tjerëve, që të merrnim më shumë vend për veten tonë. Një nënë është mama edhe në burg, siç e dini.

U gëzova kur mora vesh se atje kishte të krishterë të tjerë. Ata po mbanin një shërbesë adhurimi, kështu që ne iu bashkuam atyre. U duk se e kuptuan se unë kisha qenë e krishterë për ca kohë, kështu që më kërkuan ta drejtoja shërbesën. Unë nuk pranova dhe thjesht mora pjesë në shërbesë. Ditë pas dite, kjo ishte mënyra sesi e kalonim kohën. Kush tjetër kishte më tepër arsye për të qenë falënderues sesa ne? Dhe kush kishte më tepër gjëra në mendje—domethënë, ata që kishim lënë prapa, dhe ata që do t'i shihnim sërish—sesa ne?

Pas njëzet ditësh na futën në një aeroplan. Ndodhi fiks në kohën e duhur: Në Tajlandë, dezertorët mësojnë shpejt se është e rëndësishme të jesh ndër të parët që largohen. Neve ndoshta na e dhanë atë mundësi ngaqë vajza ime ishte shtatzënë. Në një çast gjatë qëndrimit tonë, dikush ia shpoi barkun një gruaje tjetër shtatzënë, duke ia vrrarë beben. Siç dukej, edhe ky person donte të ishte ndër të parët që largoheshin.

Neve u paralajmëruam që të mos gënjenim e të mos merrnim telefon celular me vete. Ne bëmë ashtu si na thanë, duke u ulur në aeroplan dhe duke zgjatur kokat për të parë përjashta dritares së këtij avioni që do të na shpinte, pas udhëtimit prej disa mijëra kilometrash, në një botë të re, vetëm një distancë të shkurtër larg vendit ku kishim dalë prej derës së përparme të shtëpisë sonë, jo shumë muaj më parë.

Mbërritja në Korenë e Jugut ishte një lloj tjetër çorientimi krahasuar me mbërritjen në Kinë. Gjuha nuk është identike—ka afro 40 përqind ndryshim mes dialektit të Koresë së Veriut dhe atij të Koresë së Jugut—por dialekti i Koresë së Jugut është gjithsesi më i kuptueshëm sesa gjuha kineze. Dhe ushqimi korean është ushqim korean, pavarësisht nëse ndodhesh në veri apo në jug të ZDM-së. Ndryshimi më i madh mes Koresë së Veriut e të Jugut

është numri i makinave dhe pastërtia shumë më e madhe nëpër qytetet. Unë kisha dëgjuar se jeta në Korenë e Jugut ishte shumë më e mirë sesa jeta jonë, dhe tani mund ta shihja atë me sytë e mi. Duke e parë gjithë atë trafik për herë të parë, mendova se duhej të ishte ndonjë konferencë e madhe ku po shkonin që të gjithë. Shumë shpejt mësova se njerëzit në Korenë e Jugut mund të shkojnë kudo që të duan, kurdoherë që të duan—krejtësisht në kontrast me rastin tonë që na u desh t'u drejtoheshim kodrave ngaqë nuk kishim lejen e udhëtimit që kërkohej me detyrim prej qeverisë së Koresë së Veriut.

Kur mbërritëm në aeroport, ne patëm një përshtypje të parë shumë të mirë për Korenë e Jugut, meqë nuk na kërkuan dokumentacion dhe leje. Ndërkohë që ata që po vinin prej Kinës për një udhëtim duhej të merrnin një kartë identiteti, ne ishim nënshjetas: Të gjithë koreanoveriorët janë me përkufizim nënshjetas të Koresë së Jugut ngaqë Lufta e Koresë nuk përfundoi kurrë formalisht. Kështu që ne nuk kishim nevojë fare për asnjë leje, autorizim ose dokumentacion a ndonjë gjë tjetër. Ne jemi një familje. Vetëm koreanoveriorët dhe koreanojugorët e tjerë e kuptojnë këtë. Kjo më lumturoi. Edhe tani, jam falënderuese për këtë. Unë isha aq mirënjohëse në atë çast te dogana, sa ç'isha kur pashë për herë të parë dritat e Krishtlindjes në Kinë.

Ka plot gjëra që mund t'ju befasojnë ose t'ju vënë në mëdyshje për mënyrën sesi prezantohen dezertorët koreanoveriorë me jetën në Korenë e Jugut. Burrat e gratë mbahen në ndërtesa të ndara, për shembull, dhe nuk lejohen të komunikojnë—as bashkëshortët me bashkëshortet, ose prindërit me fëmijët. Masa të tilla paraprake lidhen me numrin në rritje të spiunëve që prezantohen si dezertorë, që dërgohen prej qeverisë së Koresë së Veriut për t'u infiltruar në shoqërinë koreanojugore. Ashtu si në Korenë e Veriut, kurdoherë që mblidhen bashkë tre njerëz, njëri prej tyre ka të ngjarë të jetë spiun. Jeta për koreanoveriorët që futen në Korenë e Jugut nuk është shumë e ndryshme—kudo ka spiunë. Prandaj

ka edhe shqyrtime dhe hetime që përbëjnë rutinën e përditshme të dezertorëve për muaj të tërë. Ne shqyrtohemi, hetohemi dhe gjithashtu orientohemi për jetën në Korenë e Jugut, së pari për tre muaj në një ndërtesë qeveritare të Koresë së Jugut dhe pastaj për tre muaj të tjerë në një ndërtesë tjetër. Vajza ime u lejua të largohej më herët për shkak të shtatzënisë së saj.

Sa për mua, në ndërtesat e natyralizimit kishte shërbesa kish-tare, dhe unë kisha shumë për të mësuar dhe një udhëtim të gjatë prej të cilit duhej të merrja veten. Ka koreanoveriorë që jetojnë ilegalisht në Kinë për disa vjet, përpara se të ndërmarrin udhëtimin rraskapitës për në Korenë e Jugut, dhe ata dezertorë shpesh martohen disa herë, bëjnë shumë fëmijë andej-këndej, nganjëherë bëjnë gjëra që do të donin t'i fshihnin, dhe nuk e shmangin dot të pasurit e shumë të metave të atij lloji për të cilat interesohen hetuesit qeveritarë. Për krahasim, ne ishim të mërzitshëm, por të këndshëm. Stafi i Koresë së Jugut na trajtoi mirë, ngaqë ne ishim në Kinë vetëm për disa javë. Prapëseprapë, unë nuk mundja dot ta takoja tim bir ose tim shoq atje, ngaqë edhe ata po hetoheshin njëllor si unë në ndërtesën përkatëse për burrat. Kështu që unë pyesja veten sesi do të ishte ta takoja sërish tim shoq pas kaq shumë kohe. Rezultoi se ishte pothuajse identike me rastin kur e takova për herë të parë në kolegjin e Koresë së Veriut, para shumë vjetësh.

Ju e mbani mend sesi në atë kohë ne kalonim pranë njëri-tjetrit duke këmbyer fjalët më të pakta mes nesh. Tani, në fund të shkurtit 2010, unë takova rastësisht tim shoq, teksa ne të gjithë ishim në një udhëtim, duke ngrënë një vakt në një restorant të Koresë së Jugut. Ne nuk lejoheshim as t'i thoshim "Ç'kemi!" njëri-tjetrit në atë kohë, por ia dolëm ta përshëndesnim njëri-tjetrin me një tundje koke. Dhe ky takim ishte pak më romantik sesa takimi i parë fare që patëm mes nesh: Kur po ngjisja shkallët, ai bëri një shenjë të vogël zemre me duart e veta për të më thënë se më donte. Dhe unë iu përgjigja po njësoj.

Këta janë brezat

Dalëngadalë, ne të gjithë e plotësuam kohën tonë në ndërtesën e natyralizimit dhe u liruam njëri pas tjetrit. Kur doli përjashta im shoq, atë po e priste vajza jonë me beben e saj të sapolindur mbi shpinën e vet. Sapo im shoq e pa vajzën tonë, ai nuk e përqafoi atë si nëpër dramën e televizorit, por ata prekën lehtë njëri-tjetrin në sup dhe shkuan në shtëpi me autobus. Disa prekje e udhëtime me autobus janë më të mira dhe më të thella sesa përqaqimet ose shfaqjet televizive.

Kur dola prej qendrës së strehimit qeveritar bashkë me tim bir, ne shkua tek vendi ku jetonte vajza jonë. Udhëtimi për atje ishte i dhimbshëm, ngaqë mua përsëri më zuri makina. Por kur mbërritëm atje, unë akoma e mbaj mend skenën: im shoq, vajza dhe mbesa po na shihnin nga lart prej dritares. Këta janë brezat...

Me gëzim të madh, im shoq zbriti shkallët që të na përshëndeste. Ju mund të pyesni veten se çfarë gjëje të ngrohtë e romantike më tha ai në atë çast, por në fakt, ajo që ai bëri ishte të na shpjegonte sesi ta përdornim ashensorin. Në fund të fundit, nuk kishim mbaruar punë akoma me udhëtimin tonë—ne të gjithë po qëndronim në korridor, të pushtuar nga emocionet—dhe ai synonte të kujdesej për ne në çdo hap që hidhnim rrugës, njëlloj siç kishte bërë që nga fillimi, madje deri tek dhoma e ndenjes së vajzës sonë. Unë nuk mundem dot ta shpjegoj sesa e lumtur isha në atë çast. Ndonëse kisha mundur ta shihja vajzën dhe mbesën time kur më vizitonin tek ndërtesa e natyralizimit, unë nuk rrija dot pa qarë kur i pashë ato sërish. Mendoj se ne duhet të qajmë kur ndihemi tejet të lumtur që takojmë dikë.

Ne vazhdonim ta përkëdhelnim njëra-tjetrën, duke folur tërë natën. Në fund të fundit, kishte kaluar një vit që kur ne kishim qenë të gjithë së bashku. Im bir tani ishte një vit më i gjatë—dhe më i mbushur në trup gjithashtu!—dhe vajza ime kishte lindur një bebe. Ne mësuam sesi im shoq e kishte bërë rrugën për në Korenë e Jugut, dhe për të gjitha gjërat që ai kishte bërë që të na e përgatiste rrugën edhe neve. Nuk i mbaja dot lotët teksa për-

piqesha t'i kuptoja të gjitha këto. Ne thjesht vazhduam të flisnim deri në 5:00 të mëngjesit; edhe atëherë nuk mundëm dot të flinim. E mbushëm frigoriferin me mish, peshk dhe fruta. Im shoq ishte shumë i lumtur, duke na thënë: "Televizori punon mirë dhe ne kemi ujë të rrjedhshëm! Vazhdoni të lani!"

Mund të shkruanim një libër të tërë vetëm për kohën tonë në Korenë e Jugut deri tani—të gjitha zbulimet dhe ribashkimet dhe çastet e mrekullueshme që kemi pasur në kishë dhe nëpër dyqanet e ushqimeve, dhe duke u treguar njerëzve kudo nëpër Korenë e Jugut dhe madje anembanë botës për kohën tonë në Korenë e Veriut. Por nuk ishte ai libri që Zoti na drejtoi për ta shkruar.

Libri që Zoti na drejtoi për ta shkruar nisi me një gjysh që hapi krahët përmes derës së një ndërtese kishe në Kinë pothuajse një shekull më parë. Dhe tani është koha që ai libër të përfundojë në të njëjtën mënyrë siç edhe filloi, ngaqë këta janë brezat e familjes Bae, dhe dëshmia që na u dha neve për ta marrë e për t'ju pasuar juve është historia e Emanuelit, Perëndisë së eksodit tonë. Dhe të eksodit tuaj gjithashtu.

Në 9 janar 2011, në orën 1:00 të natës, prindërit e tim shoqi duhej të merreshin me një makinë që e kishim rregulluar ne që t'i shpinte përtej kufirit në Kinë, ku pastaj do të shoqëroheshin gjithë rrugës deri në Korenë e Jugut. Tani ata ishin në të tetëdhjetat, dhe ne donim që të kishin udhëtimin më të lehtë të mundshëm.

Në orën 5:00 të mëngjesit, ne ende nuk kishim dëgjuar gjë prej ndërmjetësit që supozohej se do t'i takonte ata në anën kineze të kufirit. E morëm në telefon. "Nuk ka asnjë lajm", - tha ai. Ata nuk kishin mbërritur ende.

Siç rezultoi, ata nuk do të mbërrinin kurrë.

Pas disa ditësh, im shoq mori në telefon miqtë e prindërve të tij. "Prindërit tuaj u kapën. Po të vazhdosh të më marrësh mua në telefon, do të më arrestojnë edhe mua. Mos i bjer më numrit tim", - erdhi pëshpërimita urgjente nga ana tjetër e linjës së telefonit.

Këta janë brezat

Në korrik 2011, ne mësuam se prindërit e tim shoqi ishin shpënë në një kamp përqendrimi. Ungjillëzimi në Korenë e Veriut gjithmonë do të të shpjerë atje, herët a vonë.

Dhe ma ha mendja se, sa më shumë që arrij ta njoh botën jashtë Koresë së Veriut, të jetuarit me guxim për ungjillin do të të nxjerrë probleme pak a shumë kudo që të jetosh. “Në fakt”, - i shkruan apostulli Pal Timoteut tek 2 Timoteut 3:12, - “kushdo që dëshiron të jetojë një jetë të perëndishme në Krishtin Jezus do të përndiqet.”

Kampet e përqendrimit në Korenë e Veriut janë vende me errësirë të paimagjinueshme. Pothuajse askush nuk arratiset dot prej një kampi përqendrimi dhe sigurisht që askush nuk lirohet ndonjëherë. Në vend të këtyre gjërave, secilit të burgosur i jepet një racion i vogël qulli, i llogaritur me kujdes që ta mbajë gjallë të burgosurin, derisa të sillet një i burgosur tjetër që t’ia zërë vendin atij ose asaj. Këtu u dërguan prindërit e tim shoqi. Atje ata janë duke jetuar fundin e ditëve të tyre mbi tokë. Në të tetëdhjetat, ata janë hallka pa emër e pa fytyrë në rrjetin më të madh të kampeve të përqendrimit që ka vepruar ndonjëherë në historinë njerëzore. Çdo ditë për ta duhet të jetë një makth që ta thyen shpinën.

Kështu që ndoshta ju po trishtoheni që po i vjen fundi këtij librit që Perëndia na urdhëroi për ta shkruar. Nëse është kështu, më lejoni të ndaj me ju diçka që shpresoj se do t’ju inkurajojë: ky mund të jetë çasti kur përfundon libri, por historia e brezave do të vazhdojë derisa të kthehet Emanueli.

Kur im shoq ishte i vogël, e ëma e tim shoqi pyeti gjyshin e tim shoqi: “Baba, a e dëgjove me të vërtetë ti zërin e Perëndisë?” Kur ai i tha asaj “po”, ajo i kërkoi atij të gjitha detajet. Ai i tregoi sesi zëri i Perëndisë kishte qenë sidomos i qartë për të, kur ai kishte qenë duke agjëruar, duke u lutur ose kur ishte në gjumë. Vjehrra ime i tha atij se ajo donte ta dëgjonte Perëndinë ashtu siç e kishte dëgjuar ai. Ajo u trishtua që nuk mundi ta dëgjonte Perëndinë, dhe ajo u lut për një besim aq të thellë sa i tiji.

Kur im shoq ishte i vogël, ai dhe familja e tij u internuan në një zonë shterpë në fshat, kur e ëma e tij nuk pranoi ta kthente mbrapsht as edhe një kriminele që kishte nevojë për ndihmë. Dhe kur i shoqi ia kujtoi asaj se ishte pikërisht kjo mirësi që e kishte dërguar krejt familjen në një vend të tillë, ajo iu përgjigj: “Ne duhet ta jetojmë gjithmonë besimin tonë në çdo çast, dhe kurrë nuk duhet ta lemë atë të lëkundet.”

Kur gjërat u përkeqësuan, ajo e pyeti familjen e saj me prakticitet: “Pse duhet të kem frikë nga ndonjë gjë? Perëndia është në anën time, dhe ai do të hapë një rrugë për ne. Edhe në kohët e vështira, ai do t’i zgjidhë të gjitha problemet tona. Pse duhet të përqendrohemi tek vështirësitë?”

Diku në një kamp përqendrimi në Korenë e Veriut, sot një i burgosur po dëgjon për herë të parë për Arkën e Noeut, Sodomën e Gomorrën, dhe për mënyrën sesi u krijuan njerëzit, e gjitha kjo sepse Perëndia i do njerëzit kaq shumë, saqë ai madje do ta dërgojë lajmëtarin e tij tetëdhjetë vjeçar me supe të kërrusura në një kamp përqendrimi për t’u treguar atyre lajmin e mirë.

Drita shkëlqen në errësirë, dhe errësira nuk e ka mposhtur—nuk mund ta mposhtë—atë (Gjoni 1:5).

Brezat vazhdojnë dhe gjithmonë do të vazhdojnë. Dhe shërbesa më e mirë e vjehrrës sime dhe besimi më i thellë, ashtu si imi—dhe yti gjithashtu—po na presin.

Pasthënia

Nga i Përndershmi Erik Folei

Pak më shumë se njëqind vjet më parë, Pjongiangu—që sot është kryeqyteti i Koresë së Veriut—ishte vendi ku ndodhi një rizgjim frymëror kaq i madh, saqë qyteti u bë i njohur si “Jeruzalemi i Lindjes.”^{xix} Rizgjimi frymëror ndodhi në janar 1907 gjatë një takimi lutjeje në atë që atëherë ishte kisha më e madhe në Kore, Kisha e Parë e Pjongiangut. Uilliam Bler (William Blair), një misionar që ishte në atë takim lutjeje, e quajti atë “Rrëshaja e Koresë.” Ai tha: “Lutja më tingëlloi si rënia e shumë ujërave, një oqean lutjesh që përplasej te froni i Perëndisë.”^{xx}

Ajo histori për Rizgjinin e Madh Frymëror të Pjongiangut në vitin 1907 është e mirënjohur. Megjithatë, është edhe një histori më e errët që ndodhi në ditën e dytë të rizgjimit frymëror. Teksa gjithsecili po gëzohej për këtë derdhje të mrekullueshme të Frymës, Perëndia dërgoi një shenjë të fuqishme për ato gjëra që do të ndodhnin më pas.

[Pastorit] Çu (Choo)... njërit nga drejtuesve e parë koreanë që u diplomuan nga Kolegji Presbiterian dhe Seminari Teologjik e më vonë u bë pastori i Kishës së Parë të Pjongiangut, iu kërkua të predikonte [gjatë ditës së dytë të rilindjes frymërore]... Ai “e kishte lidhur veten krejtësisht dhe po mendohej për t’u liruar. Ai tha: “Kjo është ajo gjë që bën rilindja frymërore. I heq tutje mëkatet tuaja dhe ju liron.”^{xxi}

Rilindja frymërore kishte mbërritur dhe njerëzit ishin të mahnitur. Ata bërtisnin: “Kjo është liria e vërtetë!” Por përmes Pastorit Çu, Perëndia donte t’i jepte kishës një të kuptuar të ri të lirisë: jo liri në

atë mënyrë siç e jep bota ose siç e kupton bota, por liri në Krishtin, e cila zakonisht i duket botës si skllavëri. Gjatë shërbesës së tij, Pastori Çu nuk u shkëput prej asaj me të cilën ishte lidhur. Në vend të kësaj, ai shpalli besnikërisht prej përbrenda saj—siç ka vepruar kisha koreanoveriore për më shumë se njëqind vjet të ekzistencës së saj.

Kim Il Sungu drejtoi një shfarosje sistematike të të krishterëve përgjatë njëzet vjetëve të parë të regjimit të tij. Ai qe aq i suksesshëm, saqë deri më sot historianët nuk kanë thujse fare dëshmi se të krishterët ekzistonin në Korenë e Veriut nga fundi i viteve 1960 deri në fillim të viteve 1990. Historia e familjes Bae është një verifikim historik i asaj që e mësojmë teologjikisht prej 1 Mbretërve 19:18: Perëndia gjithmonë ruan një mbetje që as nuk u përulet përëndive të rreme e as nuk i puth ato.

Koreja e Veriut mund të jetë kombi i parë në botë ku kisha është rimbjellë kryesisht prej martirëve. Njëqind mijë besimtarët e tanishëm në Korenë e Veriut u rritën prej gjakut të shumë dëshmitarëve besnikë—ashtu siç bënë shumë koreanoveriorë të tjerë që i besuan Krishtit dhe u vranë për rrëfimin e besimit të tyre.

Vlerësohet se tridhjetë mijë nga të krishterët e sotëm koreanoveriorë—me nënën e babain e Z. Bae mes tyre—janë duke e jetuar besimin e tyre nëpër kampet e përqendrimit. Instinkti ynë i parë është që të punojmë papushim për t'i liruar ata. Por instinkti ynë i dytë duhet të jetë për t'u kujtuar se Perëndia nuk e sheh lirinë në të njëjtën mënyrë që e shohim ne. Vlerësohet se afro njëqind e pesëdhjetë mijë deri në dyqind mijë koreanoveriorë janë të burgosur në ato kampe.^{xxii} Shumë do t'i mbyllin atje jetët e tyre. Si mundet që një Perëndi i dashurisë së pakufishme të mos orvatet t'i ngushëllojë personalisht ata njerëz, duke i siguruar sërish ata se nuk janë harruar? Dhe, nëse ai vërtet orvatet t'i arrijë ata, pse të mos veprojë ai në të njëjtën mënyrë që ka vepruar gjithnjë—përmes njerëzve që i ka trajnuar specifikisht për atë detyrë, në fushat shterpe dhe në mërgimet e përkohshme, së bashku me të cilët ka ecur përditë dhe të cilëve ai u flet si miqve të tij?

Këta janë brezat

“Kujtoni ata që janë në burg”, - na thuhet si këshillë paralajmëruese tek Hebrenjve 13:3, - “sikur të ishit në burg bashkë me ta.” Nëse nuk jemi të kujdesshëm, do ta lexonim keq këtë varg, si një thirrje për të ndier keqardhje për të krishterë si prindërit e Z. Bae. Por nëse jemi të kujdesshëm, do ta lexojmë atë varg si një thirrje për t’i imituar ata. Kjo nuk do të thotë se ne duhet të marshojmë për tek dera e kampit të përqendrimit, të trokasim në të dhe të kërkojmë të na fusin brenda, sepse nuk i ndodhi ashtu familjes Bae ose të krishterëve të parë. Përkundrazi, vargu nënkupton se kur e gjejmë veten në vende të errëta, në vend që t’i fokusojmë mendimet tona tek shpëtimi prej atje, ne do të kërkojmë të rrezatojmë dritë. Ose, siç tha dikur mamaja e Z. Bae: “Pse duhet të kem frikë nga ndonjë gjë? Perëndia është në anën time, dhe ai do të hapë një rrugë për ne. Edhe në kohët e vështira, ai do t’i zgjidhë të gjitha problemet tona. Po pse duhet që të fokusohemi tek vështirësitë?”

Është i njëjti mesazh që Jezusi i ringjallur i dha apostullit Pjetër teksa ata ecnin bashkë në bregun e detit. “Kur ishe më i ri, visheshe dhe shkoje ku të doje, - i tha Jezusi tek Gjoni 21:18, - por kur të plakesh, do t’i hapësh krahët e dikush tjetër do të të veshë e do të të shpjerë atje ku nuk do të doje të shkoje.” Dhe me të drejtë, ne mund të shtojmë, kur ta gjesh veten atje, rrezato dritë.

Zoti ia realizoi lutjen mamasë së Z. Bae për një besim aq të thellë sa ai i të atit. Ka pak shtigje që janë të ndriçuar e komodë për në një vend të tillë. Perëndia i fuqishëm i familjes Bae i bekoftë ata me një shërbim të vazhdueshëm besnik përmes të gjithë brezave të tyre deri sa ai të rikthehet. Dhe i imitofshim ne ata, teksa ata vazhdojnë ta imitojnë atë, madje edhe në vendet më të errëta në vendin më të errët të botës.

Çfarë është “Zëri i Martirëve”

Zëri i Martirëve (ZIM) është një organizatë misionesh jofitim-prurëse, ndërdenominacionale, e cila iu shërben të krishterëve të përndjekur anembanë botës. E themeluar në vitin 1967 nga Riçard e Sabina Vurmbrand, ZIM-i është përkushtuar ndaj frymëzimit të besimtarëve, që ta thellojnë përkushtimin e tyre ndaj Krishtit dhe ta përmbushin Porosinë e Tij të Madhe—pavarësisht nga kostoja.

Shënimet

- i International Institute for Strategic Studies; Hackett, James (ed.) (3 February 2010). *The Military Balance 2010*. London: Routledge, 411-413.
- ii Defence Forum India, “*New Threat from N.Korea’s ‘Asymmetrical’ Warfare*,” April 29, 2010, <http://defenceforumindia.com/showthread.php?t=9887&page=1>.
- iii “The Underground Economy,” January 8, 2011, <http://www.offshore-advisors.com/the-underground-economy.html>.
- iv Bill Powell and Adam Zagorin, “*The Tony Soprano of North Korea*,” Time, July 12, 2007, <http://www.time.com/time/magazine/article/0,9171,1642898,00.html>.
- v “*Discussion of Why Juche Is Classified as a Major World Religion*,” April 23, 2005, <http://www.adherents.com/largecom/Juche.html>.
- vi Andrei Lankov, *North of the DMZ: Essays on Daily Life in North Korea* (Jefferson, NC: McFarland & Company, 2007), 33-37. See also Kondgan Oh, “*North Korea: The Nadir of Freedom*,” Foreign Policy Research Institute, May 2007, <http://www.fpri.org/footnotes/1216.200705.oh.northkorea.html>.
- vii World Center for North Korea Missions, “*A Look at Christianity in North Korea*,” April 15, 2002, <http://www.crosswalk.com/1135128/>.
- viii The Voice of the Martyrs, “*This Is Our Victory*,” October 2008, http://www.persecution.com/uploads/media/downloads/117_ThisOurVictory-October2008.pdf.
- ix SatBytes, “*Did North Korea Launch a Satellite?*,” 2006, <http://www.spacetoday.org/Satellites/SatBytes/NoKoreaSat.html>
- x “*North Korea Religion*,” 2009, <http://www.northkoreanchristians.com/religion-north-korea.html>.
- xi “*North Korea Religion*,” 2009, <http://www.northkoreanchristians.com/religion-north-korea.html>.
- xii Michael Bristow, “*North Korea: Life in Cultural Isolation*,” BBC News Magazine, December 20, 2011, <http://www.bbc.co.uk/news/magazine-16243995>. See also Sunny Lee, “*God Forbid, Religion in North Korea?*,” Asia Times Online, May 12, 2007, <http://www.atimes.com/atimes/Korea/IE12Dg01.html>.
- xiii Anne Penketh, “*God Is Dead. Long Live Kim Il Sung*,” The Independent (UK), September 17, 2004, <http://www.rickross.com/reference/nkorea/nkorea27.html>.
- xiv Information from here through the end of the chapter comes from Seoul USA, “*The History of the North Korean Underground Church*,” 2012, <http://www.seoulusa.org/mediafiles/2012-03-susa-knewsletter.pdf>.
- xv Park Hyun Min, “*Believers at Pyongyang Bongsu Church are Members of Chosun Workers Party*,” Daily NK, June 8, 2007, <http://www.dailynk.com/english/read.php?catId=nk01600&num=2194>.
- xvi Chosunilbo, “*More N.Korean Workers to Earn Valuta for Kim Jongun*,” english.chosun.com, April 27, 2012, http://english.chosun.com/site/data/html_dir/2012/04/27/2012042701255.html.

- xvii Paula Hancocks, "North Korean defector stands for South Korean election," CNN U.S., April 10, 2012, http://articles.cnn.com/2012-04-10/asia/world_asia_north-korea-defector_1_cho-north-koreadefector-s?s=PM:ASIA.
- xviii Shihni 1 Kings 19:18.
- xix George Thomas, "The Pyongyang Revival 100 Years Later," CBN.com, June 29, 2007, <http://www.cbn.com/CBNnews/188123.aspx>.
- xx C. Hope Flinchbaugh, "A Century After North Korean Revival, Dreams of an Encore," Christianity Today, January 31, 2007, <http://www.christianitytoday.com/ct/2007/januaryweb-only/105-32.0.html>.
- xxi Flinchbaugh, "A Century After North Korean Revival."
- xxii Blaine Harden, *Escape from Camp 14: One Man's Remarkable Odyssey from North Korea to Freedom in the West* (New York: Viking, 2012), 4.

KËTA JANË BREZAT

Në vitin 1907, Rilindja në Pjongiang solli një përhapje të fuqishme të krishterimit në Korenë e Veriut. Misionari Uilliam Bler (William Blair) shpalli se “oqeanë të mëdhenj lutjesh përplaseshin me fronin e Perëndisë.” Pesëdhjetë vjet më vonë ata oqeanë avulluan nën përndjekjen përcëlluese të Koresë së Veriut, por disa përrën timer të vegjël fare vazhduan të rridhnin. Kjo është historia sesi një familje nga Korea e Veriut e mori dhe e pasoi ungjillin nga një brez në tjetrin, përmes kampeve të punës, burgjeve, marrjeve në pyetje, dhe sfidës më të madhe nga të gjitha - jetës së përditshme në Korenë e Veriut.

“Një përmbledhje tërheqëse rreth përpjekjeve të gjithanshme të Koresë së Veriut për t’i izoluar njerëzit e saj ndaj ungjillit. Perëndia në mënyrë të mrekullueshme i ka përdorur brezat e familjes Bae që ta mbanin ndezur si qiri i zbehtë dritën e ungjillit në Korenë e Veriut.”

*Xhim Dau (Jim Dau),
President, Zëri i Martirëve – SHBA*

“Një udhëtim i rrallë besimi ndër breza – një lexim i domosdoshëm për studentët seriozë të historisë së krishterë dhe të kishës që vuan!”

*Gari Lejn (Gary Lane),
Korrespondent Ndërkombëtar i Lartë, CBN News*

“Duhet të jetë lexim i detyruar në çdo shkollë të së dielës, grup të rinjsh, grup lutjeje dhe komitet misionesh.”

*Hjun S. Song (Hyun S. Song),
Bordi i Drejtorëve, Refugjatët e Koresë së Veriut në SHBA*